Kosovë

Korniza për Barazi Gjinore

SWEDEN

Financuar nga: Suedia

Profili Gjinor i Vendit

ANALIZË E DALLIMEVE GJINORE NË TË GJITHA NIVELET NË KOSOVË

Autorë:

Ulf Färnsveden
Ariana Qosaj - Mustafa
Nicole Farnsworth

Përgjegjëse për cilësinë:

Anja Taarup Nordlund

CALL OFF NUMBER: GE 16
APRIL / 2014

ORGUT Consulting AB
Svartmangatan 9, 111 29 Stockholm, Sweden
Tel +46 8 406 7620, Fax +46 8 21 02 69
E-mail: framework@orgut.se
Registration No: 556177-9538

ORGUT

FALËNDERIMET

Ekipi hulumtues dëshiron të falënderojë të gjitha institucionet, zyrtarët, përfaqësuesit e shoqërisë civile, bizneset dhe akterët ndërkombëtarë që kontribuuan për ketë raport. Po ashtu falënderojmë Ambasadën e Suedisë, Agjencinë për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Zyrën e Bashkimit Evropian dhe agjencitë e OKB-së për udhëzimet dhe përkrahjen e tyre. Ne e çmojmë kontributin dhe idetë e tyre dhe të të tjerëve për këto gjetje preliminare dhe për draftin e raportit. Në mënyrë të veçantë falënderojmë Anja Taarup Nordlund për kontrollimin e cilësisë dhe Nertila Qarri-Gërgurin për mbështetjen thelbësore logjistike dhe në përkthim.

Pikëpamjet e shprehura në ketë dokument janë të autorit dhe nuk paraqesin domosdoshmërish pikëpamjet e Ambasadës së Suedisë ose të Orgut Consulting.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 1
HYRJE 4
METODOLOGJIA 4
GJETJET 5
1) Korniza kombëtare: Politikat, strategjitë dhe iniciativat 5
Iniciativat dhe strategjitë e tjera 6
Sfidat dhe mundësitë 6
2) Identifikimi i akterëve kyç 8
Institucionet qeveritare dhe nëpunësit civilë 8
Shoqëria civile 11
Akterët ndërkombëtarë 12
Sektori privat 13
Sfidat dhe mundësitë 13
3) Sundimi i ligjit, drejtësia dhe të drejtat e njeriut 13
Krimi, sundimi i ligjit dhe masat korrektuese 14
Të drejtat pronësore dhe trashëgimore 14
Ligji i Punës 15
Të drejtat e njeriut, kthimet e detyrueshme dhe ri-integrimi 15
Të drejtat e pakicave 15
Të drejtat e personave më aftësi të kufizuara 15
Të drejtat e personave LGBT 15
Sfidat dhe mundësitë 16
4) Situata politike 16
Korniza ligjore 16
Barazia gjinore në nivel kombëtar 17
Barazia gjinore në nivel komunal 17
Barazia gjinore në partitë kryesore politike 18
Barazia gjinore në shërbimet publike 19
Sfidat dhe mundësitë 20
5) Situata socio-ekonomike 20
Rolet e gjinive në ekonominë formale 20
Rolet e grave dhe burrave në ekonominë joformale 21
Situata e varfërisë nga perspektiva gjinore 21
Përfshirja në tregun e punës përmes punësimit dhe bizneseve fillestare 22
Marrëdhëniet brenda familjeve 22
Arsimimi 22
Shëndeti 23
Sfidat dhe mundësitë 23
6) Dhuna në bazë gjinore dhe siguria 24
Dhuna në emër të [mbrojtjes së] nderit 24
Dhuna në bazë gjinore gjatë konfliktit 24
Dhuna seksuale, përfshirë dhunimin 24
Gjinicidi 24
Dhuna në familje përfshirë martesën e hershme 25
Trafikimi i qenieve njerëzore për shfrytëzim seksual 26
Ngacmimi seksual 26

Siguria 26
Dhuna për shkak të orientimit seksual 27
Dhuna kundër personave me aftësi të kufizuara 27
Dhuna kundër fëmijëve brenda institucioneve 27
Parandalimi 27
Mbrojtja, rehabilitimi dhe ri-integrimi 27
Sfidat dhe mundësitë 28
7) Sektorët 28
Ekonomia e barazisë gjinore 28
Mjedisi dhe zhvillimi rural 29
Bujqësia 29
Uji dhe higjiena 29
Siguria e ushqimit dhe të ushqyerit 29
Transporti dhe infrastruktura 30
Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit (TIK) 30
Energjia 30
Sporti 31
Gjinia dhe mediat 31
Sfidat dhe mundësitë 31
Shtojca 1. Statistikat 32
Akterët kyç 32
Policia e Kosovës 32
Prokuroria 32
Media 35
Banka Qendrore e Kosovës 36
Të drejtat e njeriut dhe drejtësia 36
Shtetësia, azilkërkuesit dhe kthimi 36
Pjesëmarrja në politikë dhe vendimmarrje 37
Akterët ndërkombëtarë 37
Kuvendi i Kosovës 37
Qeveria 38
Balanca gjinore sipas partive politike 46
Balanca gjinore sipas komunës 47
Dhuna në bazë gjinore 49
Trafikimi 49
Dhuna në familje 50
Format e tjera të mundshme të dhunës në bazë gjinore 53
Aspektet socio-ekonomike 53
Puna joformale 53
Arsimi 55
Sektorët 59
Shtojca 2. Pjesëmarrësit në hulumtim 60
Bibliografia 66
Shënime në fund 71

AKRONIMET

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimi kundër Grave
CEO	Kryeshef Ekzekutiv
QHDP	Qendra për Hulumtim, Dokumentacion dhe Publikim
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
QPS	Qendra për Punë Sociale
D4D	Demokracia për Zhvillim
KNZH	Komisioni për Ndihmë në Zhvillim
DASHC	Departamenti i Administratës së Shërbimit Civil
DPS	Departamenti i Punës Sociale
DHF	Dhuna në Familje
NJHDHF	Njësia për Hetimin e Dhunës në Familje (Policia e Kosovës)
KE	Komisioni Evropian
ECMI	Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave në Kosovë
ZNEP	Zyra Ndërlidhëse Evropiane për Ndërtimin e Paqes
BE	Bashkimi Evropian
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
ZÇGJ	Zyrtarët për Çështje Gjinore (në ministri)
DHBGJ	Dhuna në Bazë Gjinore
GABGJ	Grupet e Avokimit për Barazi Gjinore
GGD	Grupi i Grave Deputete
GRB	Buxhetimi që i përgjigjet gjinive
NJDNJ	Njësia për të Drejtat e Njeriut
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
IKS	Iniciativa Kosovare për Stabilitet
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës (ish Enti i Statistikës së Kosovës, ESK)
QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
QKSGJ	Qendra Kosovare për Studime Gjinore
KIPRED	Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
PK	Policia e Kosovës
PKBGJ	Programi i Kosovës për Barazi Gjinore
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
KtK	Kvinna till Kvinna
RRGGK	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
ZNJ	Zyra për Ndihmë Juridike
LBDHF	Ligji për Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje
LGBT	Lesbiket, homoseksualët, biseksualët, transgjinorët
LBGJ	Ligji për Barazinë Gjinore
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
QNDSP	Qendra Ndërkombëtare për të Drejtat e të Sëmurëve Psikik
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
ZKBGJ	Zyrtari Komunal për Barazi Gjinore
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
MAP	Ministria e Administratës Publike

NAAC	Këshilli Kombëtar Shqiptaro-Amerikan
NDI	Instituti Kombëtar Demokratik
OJQ	Organizatë Joqeveritare
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
ZKM	Zyra e Kryeministrit
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MVPT	Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit
Sida	Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
RROGRAEK	Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane në Kosovë
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFPA	Fondi i Popullsisë i Kombeve të Bashkuara
UNHCR	Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovës
RKSKB	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
FEG	Fuqizimi Ekonomik i Grave
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky Profil Gjinor i Kosovës në mënyrë ambicioze synon të analizojë dallimet gjinore në të gjitha nivelet sa i përket kornizës kombëtare, akterëve kyç, sundimit të ligjit, drejtësisë, të drejtave të njeriut, politikës, situatës sociale dhe ekonomike, dhunës në bazë gjinore, dhe sektorëve të tjerë. Ky hulumtim, që zhvillua prej janarit deri në prill 2014, përfshinë intervista me informatorët kryesor, grupet e fokusuara dhe intervistat grupore me 197 përfaqësues të ndryshëm të institucioneve qeveritare të nivelit komunal dhe nacional, me organizatat e shoqërisë civile (OSHC), me akterët ndërkombëtarë, me akademinë, me mediat dhe me sektorin privat. Hulumtimi nga zyra nxori informata nga të dhënat (statistikat) sasiore dhe cilësore. Një kufizim kyç ishte koha e shkurtër, veçanërisht duke pasur parasysh numrin e madh të fushave që i ishte kërkuar ekipit t'i studiojë.

Korniza shtetërore dhe akterët kyç

Kosova ka një kornizë ligjore mjaft gjithëpërfshirëse si dhe ka krijuar disa mekanizma për barazi gjinore. Por zbatimi i tyre vazhdon të mbetet sfidë. Ka shumë strategji për specifikimin dhe zbatimin e obligimeve ligjore. Megjithatë, planet e veprimit rrallë verifikohen duke i krahasuar me planet e tjera të veprimit, duke lejuar dyfishimin e tyre potencial. Rrallë alokohen fonde të mjaftueshme për zbatimin e këtyre strategjive. Institucionet qeveritare në të gjitha nivelet zakonisht nuk e kuptojnë se si duhet të përfshijnë çështjet gjinore në punën e tyre. Zyrtarët për barazi gjinore nëpër ministri dhe komuna janë të margjinalizuar; disa prej tyre nuk përfshihen kurrë në planifikimin e programeve, në buxhetim, në vlerësimin e ndikimit dhe/ose në analizimin e projektligjeve ose politikave nga perspektiva gjinore. Akterë të tjerë, si OSHC-të, shumë rrallë konsultohen nga mekanizmat ndërkombëtarë aktivë në Kosovë gjatë përcaktimit të prioriteteve. Për zbatimin e shumë ligjeve, strategjive dhe planeve të veprimit të Kosovës, si dhe për forcimin e mekanizmave aktualë, qeveria duhet të alokojë një mbështetje më të madhe financiare. Proceset e integrimit në BE mund të kushtëzojnë qeverine e Kosovës duke e inkurajuar atë të zbatojë ligjet dhe politikat ekzistuese.

Sundimi i ligjit, drejtësia dhe të drejtat e njeriut

Treguesit e të drejtave të njeriut	Femrat	Meshkujt
Të miturit e dyshuar për krime	2-4%	96-8%
Pronarë të pasurisë	7.9%	83.4%
Persona të riatdhesuar (2010)	22%	78%

Kosova përballet me sfidat më të mëdha që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, duke filluar nga korrupsioni në sektorin publik dhe privat, zbatimin e dobët të vendimeve të gjykatave, ekzekutimi i dobët i kontratave e deri te zbatimi i dobët i ligjeve, duke përfshirë dhe kompensimin për shkeljet e të drejtave të viktimave. Përkundër barazisë *de jure* në mes të burrave dhe grave, ende është duke vazhduar diskriminimi *de facto* kundër grave. Gratë kanë më pak qasje në drejtësi, në realizimin e mjeteve juridike të garantuara me ligj, dhe në kompensim për krimet e bëra kundër tyre. Edhe pse vërehet më pak, situatë e ngjashme duket se ekziston edhe për lesbiket, homoseksualët, biseksualët dhe transgjinorët (LGBT), të cilët përballen me diskriminim në të gjitha nivelet: në nivel të shoqërisë, të familjes dhe të shtetit. Personat me aftësi të kufizuara dhe romët, ashkalitë dhe egjiptianët (në mënyrë të veçantë gratë) përballen me shumë shkelje të të drejtave të tyre. Në ushtrimin efektiv të të drejtave të grave deri në një farë mase ndikojnë zakonet dhe traditat patriarkale, por ato po ashtu lehtësohen si rezultat i sundimit të dobët të ligjit. Edhe këtu, proceset e integrimit në BE janë një mundësi e mirë për të kushtëzuar institucionet e Kosovës që të mbrojnë gëzimin e të gjitha të drejtave.

Situata politike

LBGJ bën thirrje që si meshkujt ashtu edhe femrat të mbajnë të paktën 40% të pozitave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes. Megjithatë, një gjë e tillë nuk është harmonizuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe me Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Kosovë, të cilët, që të dy, bëjnë thirrje për një pjesëmarrje prej 30%. Përkundër përmirësimeve të bëra, gratë vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuara në proceset e vendimmarrjes në të gjitha nivelet, Kjo është veçanërisht e vërtetë për gratë nga grupet etnike pakicë dhe ato me aftësi të kufizuara. Shumica e vendimeve merren nga udhëheqësit meshkuj të partive politike dhe në shumicën e partive nuk ka procese demokratike të

vendimmarrjes. Përderisa disa parti i marrin në konsideratë gratë më shumë në platformën e tyre se partitë e tjera, të gjitha kanë mundësi të përfshijnë më shumë përfaqësimin gjinor. Partitë nuk kanë mekanizma për tu konsultuar me, dhe për të marrë informata nga votueset dhe votuesit. Prioritetet e qeverisë që kanë të bëjnë me investimet në infrastrukturë mund të dëmtojnë qasjen në shërbime publike cilësore, veçanërisht për gratë.

Pjesëmarrja në politikë	Gratë	Burrat
President/e (ndonjëherë)	1	5
Kryeministra/e (ndonjëherë)	0	6
Zëvendëskryeministra/e	1	4
Ministra/e	1	17
Zëvendësministra/e	1	34
Misionet jashtë vendit	6	16
Anëtarët/et e Kuvendit të Kosovës	40	80
Kryesues/e të Komisioneve të Kuvendit	1	8
Kryetar/e i/e komunës	1	32
Drejtor/esha i Drejtorisë Komunale	4.4%	94.6%
Anëtarë/e të Kuvendeve Komunale	34%	66%
Shërbim Civil	38%	60%

Situata socio-ekonomike

Situata socio-ekonomike është e rëndë. Asnjë vend në Evropë nuk ka kaq pak gra në tregun formal të punës (gratë marrin pjesë me 18% krahasuar me meshkujt që marrin pjesë me 55%). Shumë të rinj as nuk studiojnë e as nuk punojnë. Ato pak gra që punojnë nuk arrijnë të jenë në pozita udhëheqëse në të njëjtën shkallë sa burrat; shumica mbesin në nivelin administrativ. Më pak se 10% e bizneseve udhëhiqen nga gratë ose janë biznese në pronësi të grave, dhe vetëm 3% e të gjitha kredive u jepen grave. Shumë pak prona janë në pronësi të grave (8%). Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nuk ka ndonjë plan të mirë për punësim dhe Plani për Fuqizimin Ekonomik të Grave 2011-2013 nuk ka sjell rezultate të dukshme për shkak të financimit të pamjaftueshëm. Kur shikojmë përpara, Kosova ka mundësi për progres ekonomik: ka popullsinë më të re në Evropë dhe ka potencial për zhvillim. Megjithatë, më shumë njerëz duhet të hyjnë në tregun e punës, duke përfshirë edhe gratë dhe burrat nga grupet e pakicave. Në arsim gjithnjë e më shumë femra janë duke u bërë pjesë e të gjitha niveleve të arsimit, edhe pse përzgjedhjet për arsimimin e femrave dhe meshkujve ende mbeten të stereotipizuar. 30 % e popullsisë në Kosovë jetojnë në varfëri dhe 10% e tyre në varfëri të skajshme, e veçanërisht të prekur nga kjo janë familjet me gra kryefamiljare (38%) dhe burrat dhe gratë në zonat rurale (65%).

Statistikat socio-ekonomike	Mesh.	Femra
Regjistrimi në arsimin fillor	95%	96%
Regjistrimi në arsimin e mesëm të lartë	96%	88%
Braktisja e shkollës së mesme të lartë	71%	29%
Regjistrimi i përgjithshëm në arsimin terciar (femrat dominojnë në drejtimet: edukim, filozofik, filologjik; meshkujt dominojnë në ndërtimtari, arkitekturë, inxhinieri mekanike; ka një balancë gjinor në juridik, ekonomik dhe mjekësi)	19000 (55%)	17000 (45%)
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore 2012	55%	17.8%
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore 2009	68%	29%
Papunësia	28%	40%
Papunësia tek të rinjtë	52%	63.8%
Të rinjtë që nuk janë as në punë, as në shkollë e as në trajnime (NEET) 15-24 vjeçar	31%	40%
Pronarë biznesi	91.8%	8.2%
Të ardhurat neto nga biznesi vetanak	92%	8%
Dallimi i pagesës mes gjinive	N.A.	N.A.
Llogaritë në institucionet zyrtare financiare	57%	31%

Dhuna në bazë gjinore

Në Kosovë ekzistojnë disa forma të ndryshme të dhunës në bazë gjinore (DHBGJ), përfshirë edhe dhunën kundër civilëve gjatë konfliktit, dhunën seksuale, gjinicidin, dhunën në familje, trafikimin e qenieve njerëzore për t'i detyruar në prostitucion, ngacmimin seksual dhe të tjera që lidhen me sigurinë e njeriut. Disa forma të dhunës në bazë gjinore i prekin femrat ndryshe nga meshkujt, sipas moshës së tyre, aftësisë, përkatësisë etnike, lokacionit gjeografik dhe/ose orientimit seksual. Dhuna në të cilën përdoren armët dhe vetëvrasjet i prekin më shumë meshkujt se sa femrat. Forma më e shpeshtë e dhunës në bazë gjinore duket se është dhuna në familje, veçanërisht për gratë. Korniza ligjore e Kosovës që ka të bëj me dhunën në bazë gjinore është mjaft gjithëpërfshirëse, dhe koordinimi në mes të institucioneve është përmirësuar viteve të fundit, përfshirë edhe emërimin e Koordinatorit Nacional. Ende kanë mbetur disa sfida në zbatim, veçanërisht ato që lidhen me drejtësinë, rehabilitimin dhe ri-integrimin. Institucionet, akterët ndërkombëtarë dhe OSHC-të kanë ndërmarrë disa përpjekje parandaluese, duke përfshirë edhe strategjitë e punës me burra dhe djem, për transformimin e roleve të gjinive.

Treguesit e dhunës në bazë gjinore	F	M	Të gjithë
% e femrave dhe meshkujve që pësojnë nga dhuna në familje gjatë jetës së tyre (2008)	46.4%	39.6%	43%
Nr. dhe % e viktimave të dhunës në familje (raportuar në polici, 2013)	869 *80%*	220 *20%*	1089
Viktimat e trafikimit (2013)			52

Sektorët

Statistikat sipas sektorëve *(% e të gjithë M/ F që punojnë)*	E të gjithë M	E të gjitha F
Bujqësi, pylltari & peshkatari	4%	5%
Arsim	10%	21%
Shëndetësi dhe punë sociale	5%	17%
Tregti me shumicë dhe pakicë	13%	14%
Prodhimtari	16%	8%
Ndërtimtari	12%	0.4%

Ndonëse ishte e pamundur të mbuloheshin të gjithë sektorët, në të gjithë ata që u analizuan u pa se kanë potencial të madh për përmirësim. Barazia gjinore është e rëndësishme për të gjithë sektorët, megjithatë në shumë pak prej tyre janë bërë analiza të mjaftueshme nga perspektiva gjinore. Rezultatet janë më të mira nëse edhe gratë edhe burrat përfshihen në zhvillimin e të gjithë sektorëve, përfshirë edhe në planifikim, inovacion dhe vendimmarrje. Por deri më sot gratë kanë qenë të përfaqësuara shumë më pak. Kjo nuk është vetëm çështje e të drejtave të njeriut; hulumtimet kanë treguar se një vend i punës ku ka balancë gjinore në të gjitha nivelet sjell shumë përfitime. Të gjithë klientët, furnizuesit, komunat, etj., duhet të përfshijnë si gratë ashtu edhe burrat. Në klientë hyjnë edhe vajzat dhe djemtë, dhe është me rëndësi të merren parasysh të gjitha nevojat e tyre specifike.

HYRJE

Ky profil gjinor i Kosovës në mënyrë ambicioze synon të analizojë dallimet gjinore në të gjitha nivelet sa i përket kornizës kombëtare, akterëve kyç, sundimit të ligjit, drejtësisë, politikës, situatës socio-ekonomike, dhunës në bazë gjinore dhe sektorëve të tjerë (p.sh, ujit, higjienës, bujqësisë, mjedisit, zhvillimit rural, sigurisë së ushqimit, të ushqyerit, transportit, infrastrukturës, TIK, dhe energjisë). Është e qartë se disa prej këtyre fushave janë të ndërlidhura mes vete (p.sh, të drejtat e njeriut, dhuna dhe situata socio-ekonomike). Prandaj, vlerësimi i barazisë gjinore në të gjitha fushat e lartcekura, siç kërkohej me kushtet e referencës, brenda një kohe të shkurtër dhe në një raport të kufizuar ishte e meta kryesore.

METODOLOGJIA

Një ekip tre-anëtarësh ka bashkëpunuar prej janarit deri në prill 2014 për të hulumtuar dhe shkruar Profilin Gjinor të Kosovës. Hulumtimi është bërë me metoda të përziera, duke filluar prej intervistave me informatorët kyç, grupeve të fokusuara dhe intervistave grupore me 197 përfaqësues të ndryshëm të institucioneve qeveritare të nivelit komunal dhe nacional, organizatave joqeveritare (OJQ), mekanizmave ndërkombëtarë, akademisë, mediave dhe sektorit privat (Shtojca 2). Kjo përfshinte pjesëmarrësit në hulumtim nga radhët e grupeve lesbike, homoseksuale, biseksuale dhe transgjinore (LGBT), personat me aftësi të kufizuara, ata nga grupet etnike dhe moshat e ndryshme, dhe ata nga zonat rurale dhe urbane. Edhe pse u përpoqëm të mblidhnim informata nga e tërë Kosovë, për shkak të kohës së kufizuar, hulumtimi në nivelin komunal u fokusua në Prishtinë, Gjilan, Mitrovicën Veriore, Mitrovicën Jugore, Gjakovë dhe Prizren. Hulumtimi në zyrë nxori informata nga të dhënat (statistikat) sasiore dhe cilësore, kur ato ishin në dispozicion. Ekipi hulumtues u përpoq të përmirësojë vlefshmërinë dhe besueshmërinë e të dhënave duke i përdorur hulumtuesit (ekipe të ndryshme me nga tre anëtarë), metodat (hulumtim në zyre, analiza statistikore, intervista dhe grupe të fokusuara), burimet e të dhënave (tekste të ndryshme dhe pjesëmarrës në hulumtim nga të gjithë sektorët) dhe verifikime të pjesëmarrësve në prill.

Kufizimet dhe sfidat përfshinin kohën shumë të shkurtër që ishte caktuar për një studim të tillë të gjerë të pothuaj të gjithë sektorëve në Kosovë nga perspektiva gjinore; udhëtimi i zyrtarëve qeveritarë gjatë periudhës së hulumtimit në terren, i cili e bëri të vështirë caktimin e disa intervistave; dhe ndryshimet e kohëve të fundit në radhët e zyrtarëve në nivelet komunale pas zgjedhjeve të nëntorit 2013, që nënkuptonte se disa nuk konsideronin se janë kompetent të flasin për punën e paraardhësve të tyre.

GJETJET

1) Korniza kombëtare: Politikat, strategjitë dhe iniciativat

Ligjet dhe politikat

Janë disa mekanizma ligjorë dhe institucionalë që kanë bërë përpjekje të sigurojnë barazinë gjinore në Kosovë. Sipas Kushtetutës së Kosovës, barazia gjinore mbrohet nga shteti.[1] Kushtetuta thekson se konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë edhe CEDAW dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), janë mbi legjislacionin e vendit.[2] Megjithatë, zbatimi i kësaj dispozite përdoret rrallë. Gjykata Kushtetuese e Kosovës kohëve të fundit iu referua CEDAW-it në vendimin e rëndësishëm në rastin e Diana Kastratit, në të cilin gjykata ishte vonuar në lëshimin e urdhrit për mbrojtje, siç parashihet me ligj.[3] Gjykata Kushtetuese vendosi se kjo ishte shkelje e të drejtave të personit për jetë dhe në mjete juridike efektive që garantohet me konventat ndërkombëtare.

Ligji për Barazinë Gjinore (LBGJ) i ndalon të gjitha format e diskriminimit gjinor të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.[4] Ligji për Zgjedhjet përcakton kuotën prej 30% për pjesëmarrjen e grave dhe burrave në nivelin kombëtar dhe komunal (shih seksionin 4). Ligji për Vetëqeverisjen në Kosovë është në harmoni me Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale e cila bën thirrje për pjesëmarrje të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes. Ligji Kundër Diskriminimit (LKD) i ndalon të gjitha format e diskriminimit, përfshirë edhe diskriminimin në bazë gjinore. Që prej miratimit të tij në vitin 2014, procedurat e paqarta dhe të dobëta kanë bërë që pothuaj të mos ekzistojë praktika gjyqësore për LKD-në.[5] Për shkak të zbatimit të dobët, qeveria ka filluar hartimin e një LKD-je të ri.[6] Janë miratuar shumë udhëzime administrative për zbatimin e legjislacionit për barazi gjinore.[7]

Kodi Penal i Kosovës, Ligji për Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje, Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Personave dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, dhe Ligji për Familjen dhe Shërbimet Sociale sigurojnë mbrojtje për viktimat e dhunës në bazë gjinore. Ligjet përcaktojnë disa mekanizma për zbatimin e tyre (shih seksionet 2 dhe 6).

Ekzistojnë strategji për specifikimin dhe zbatimin e obligimeve ligjore të institucioneve. Një çështje që është cekur vazhdimisht nga palët e interesit në të gjithë sektorët është se Kosova ka një kornizë ligjore mjaft gjithëpërfshirëse porse koordinimi ndërmjet institucioneve është i pamjaftueshëm[8] dhe planet e reja të veprimit rrallë verifikohen duke i krahasuar me planet ekzistuese të veprimit.[9] Në përgjithësi, ligjet dhe politikat zbatohen dobët.[10]

Programi për Barazinë Gjinore në Kosovë (2008)[11] përcakton kornizën e përgjithshme për integrimin e barazisë gjinore në ligje, politika dhe shërbime publike. Programi i Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit (2011-2014)[12] detajon rolet e të gjithë akterëve sa i përket parandalimit, mbrojtjes, rehabilitimit/ri-integrimit dhe koordinimit në rastet e dhunës në familje. Në vitin 2010, qeveria miratoi Strategjinë e dytë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2011-2014). Tani ajo është duke e hartuar Strategjinë e tretë, të koordinuar nga Zëvendësministri i Punëve të Brendshme i cili vepron në cilësinë e Koordinatorit Nacional.[13] Koordinatori kundër Dhunës në Familje ka përgatitur një raport progresi në vitin 2013 dhe ka udhëhequr hartimin ndër-sektorial të Procedurave Standarde të Operacionit për të ndihmuar viktimat.[14] Pengesat kryesore të identifikuara përfshijnë zbatimin joadekuat të ligjeve, koordinimin e dobët ndërmjet institucioneve përgjegjëse, banimin e pamjaftueshëm social ose trajnimin e pamjaftueshëm profesional për viktimat dhe praktikat e përbashkëta ligjore. Zyra e Koordinatorit ka vetëm një pozitë e cila financohet nga buxheti i Kosovës, pasi që financimi nga donatorët ka përfunduar. Zyra ka bërë përpjekje që të sigurojë burime të mjaftueshme për zbatimin e mandatit të saj.[15]

Në janar 2014, qeveria e miratoi Planin Kombëtar të Veprimit (PKV) për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (RKSKB 1325).[16] Nga viti 2000, OJQ-të e grave avokuan për PKV.[17] PKV-ja bën thirrje për pjesëmarrje të grave në proceset e vendimmarrjes dhe në misionet diplomatike dhe për drejtësi për dhunën seksuale të ushtruar gjatë luftës dhe për format tjera të dhunës. Mbetet të shihet se a do të ketë burime të mjaftueshme njerëzore dhe buxhetore për zbatimin e PKV-së, sfidë kjo me të cilën përballen shumë plane të veprimit në

Kosovë. Qeveria ka zotuar 51% të financimit të nevojshëm për zbatimin e këtij plani.

Rishikimi dhe strategjia e sektorit të sigurisë së brendshme të miratuar nga qeveria pas pavarësisë u kritikuan se ishin 'të verbra' sa i përket nevojave që kanë të bëjnë me sigurinë e grave, pasi që adresonin vetëm trafikimin e njerëzve.[18] Qeveria po ashtu udhëhiqet nga Plani i Veprimit për Partneritet Evropian, kornizë e strategjisë afatmesme e Kosovës për proceset e integrimit në BE. Plani gërshetohet me disa aktivitete të planeve ekzistuese të veprimit, duke promovuar dhe mbrojtur barazinë gjinore e në mënyrë specifike të drejtat e grave, i shoqëruar me kornizën financiare.[19] Megjithatë, zotimet financiare të buxhetit të Kosovës për planin e veprimit në vitin 2012 ishin nën 100,000 euro; financimi për vitet e ardhshme mbetet i paspecifikuar.[20]

Iniciativat dhe strategjitë e tjera

Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës (RRGGK), i cili në mesin e 77 anëtarëve përfshinë shumicën dërrmuese të organizatave të grave në Kosovë, e ka *Planin Strategjik* për periudhën *2011-2014* dhe është duke zhvilluar një strategji të re për periudhën 2015-2018. Strategjia e tanishme përfshinë dhunën në bazë gjinore, qasjen në kujdes shëndetësor, pjesëmarrjen e grave në politikë, fuqizimin ekonomik të grave dhe ndërtimin e kapaciteteve të rrjetit. RRGGK po ashtu është i përfshirë në përpjekjet për përmirësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave LGBT. Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane po ashtu e ka planin e vet.[21] Donatorët dhe organizatat ndërkombëtare rrallë konsultohen me gratë dhe me OJQ-të që punojnë në çështje gjinore kur vendosin për prioritetet e misioneve të tyre ose për mbështetjen e ardhshme.[22] Me disa përjashtime, donatorët zakonisht e kuptojnë rëndësinë që ka financimi i organizatave të grave dhe financimi kryesisht ka në fokus organizatat me bazë në Prishtinë.[23] Në kundërshtim me Deklaratën e Parisit, koordinimi ndërmjet qeverisë, donatorëve dhe OJQ-ve është i dobët.[24]

Bashkimi Evropian (BE) çdo vit monitoron dhe vlerëson nivelin e zbatimit të një numri kriteresh të Kopenhagës nga institucionet e Kosovës, përfshirë ato politike, ekonomike dhe të drejtat e njeriut në Kosovë, që paraqiten në raportet e progresit. Studimi i Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asocimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së në mënyrë sporadike i përmend shkeljet e të drejtave të njeriut të grave, d.m.th, duke i kërkuar Kosovës që të adresojë në mënyrë më efektive çështjen e hartimit të legjislacionit kundër trafikimit dhe të përmirësojë besueshmërinë e statistikave të saj.[25] Komisioni Evropian nuk e ka *përfshirë sa duhet* çështjen gjinore në raportet e progresit ose në studimin e fizibilitetit për Kosovën, si instrumenti kryesor i BE-së për monitorimin dhe kushtëzimin e procesit të integrimit evropian të Kosovës. Raportet e progresit rregullisht përmbajnë seksione ku ju referohen vetëm pjesëmarrjes së grave në politikë dhe dhunës kundër grave. Perspektiva gjinore mund të përfshihet në secilin seksion të Raportit të Progresit, duke inkurajuar Qeverinë e Kosovës që të përfshijë gjininë. Planet e BE-së duhet të fokusohen në mënyrë më proaktive në përfshirjen e gjinive në projektet e tyre.[26] Në vitin 2012, USAID në Kosovë bëri një auditim gjinor, i cili është pasqyruar në fushat kyçe të planit katërvjeçar të USAID-it për zhvillimin e vendit.[27] GIZ dhe ambasada e Suedisë apo ashtu bënë studime gjinore për të informuar strategjitë.[28]

> "Gjinia duhet të jetë në fokus por nuk ka qenë problem në procesin e integrimit në BE. Ajo duhet të përfshihet në ketë proces".
> - Një i anketuar

Sfidat dhe mundësitë

Zbatimi i kornizës ligjore mjaft gjithëpërfshirëse të Kosovës dhe mekanizmave për barazinë gjinore ende mbeten sfidë. Qeveria duhet të alokojë përkrahje të mjaftueshme financiare për zbatimin e ligjeve, strategjive dhe planeve të shumta të saj të veprimit, si dhe për fuqizimin e mekanizmave ekzistues. Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë zbatimin e ligjeve dhe politikave. Një trysni e fokusuar e BE-së ndaj institucioneve të Kosovës mund të përmirësojë zbatimin duke kërkuar nga institucionet që të zbatojnë ligjet, politikat dhe strategjitë. Për ketë qëllim, raportet e progresit për Kosovën mund të përfshijnë çështjet gjinore në të gjitha kriteret që kanë të bëjnë me proceset e integrimit të Kosovës në BE, përfshirë edhe në kriteret ekonomike, politike dhe ligjore. Kushtet e BE-së mund të jenë të orientuara kah treguesit dhe të jenë të matshme, duke kërkuar raportimin e numrit të rasteve, hetimin e tyre, dënimin dhe kompensimin në pajtim me ligjin në fuqi. Kjo përfshin edhe sigurimin e mbledhjes dhe mirëmbajtjes së të dhënave të veçanta gjinore dhe analizën e rregullt të ndikimit në përputhje me legjislacionin e BE-së. Për të zhvilluar më tej mënyrat e zbatimit të ligjeve dhe politikave konsultimet e rregullta me grupet e grave do ta bënin qeverinë dhe misionet ndërkombëtare më të vetëdijshme për

çështjet gjinore. OJQ-të mund të përkrahen në monitorimin e zbatimit të ligjeve, politikave dhe strategjive (gjithmonë me perspektivë gjinore), dhe kjo do të mund të informonte përpjekjet e tyre të ankimit bazuar në dëshmi.

2) Identifikimi i akterëve kyç

Ky seksion identifikon akterët kyç lokalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë të përcaktuar në kornizën kombëtare dhe të identifikuar gjatë hulumtimit në terren. Ai deri diku trajton perspektivën e disa akterëve për barazi gjinore dhe mundësitë për përmirësim. Seksionet e tjera dhe Shtojca 2 përmbajnë informata të mëtejshme.

Institucionet qeveritare dhe nëpunësit civilë

Të gjitha institucionet kanë përgjegjësi që të avancojnë barazinë gjinore në Kosovë si pjesë e planifikimit, buxhetimit, procedurave, proceseve dhe ofrimit të shërbimeve të tyre.[1] Kjo përfshin të gjithë ministrat, sekretarët e përgjithshëm, zyrtarët e zgjedhur, zyrtarët e emëruar, nëpunësit civilë. Në vitin 2012, Presidentja Atifete Jahjaga organizoi një konferencë e cila rezultoi me *Parimet e Prishtinës*;[2] ndihmoi në krijimin e qendrës gjinore në Universitetin e Prishtinës dhe ngriti në mënyrë publike disa çështje që kanë të bëjnë me barazinë gjinore.

Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) në Zyrën e Kryeministrit (ZKM) e ka mandatin të zbatojë dhe monitorojë zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore (LBGJ). ABGJ-ja duhet të shqyrtojë të gjitha projektligjet dhe politikat nga perspektiva e të drejtave të njeriut dhe ajo gjinore, duke propozuar ndryshimet e nevojshme. ABGJ-ja përballet me disa sfida, përfshirë edhe moskuptimin e qartë nga institucionet se termi "gjini" i referohet edhe grave dhe burrave, dhe se si duhet të përfshihen gjinitë në punën e tyre; stafi i pamjaftueshëm në divizionin ligjor;[3] buxheti jo i mjaftueshëm për përmbushjen e mandatit të saj, veçanërisht për hulumtime;[4] dhe ministritë nuk marrin sa duhet seriozisht përgjegjësitë për raportim, përfshirë edhe të dhënat e ndara sipas gjinive.

> "Ne jemi shumë të margjinalizuara."
> "Ne jemi si kukulla në ministri."
> - Zyrtarët për Barazi Gjinore

Zyrtarët për Barazi Gjinore (ZBGJ) në ministri dhe Zyrtarët Komunalë për Barazi Gjinore (ZKBGJ) janë përgjegjës për avancuar barazinë gjinore në ministri dhe komuna, përkatësisht. Meshkujt nuk janë të përfaqësuar sa duhet në mesin e ZBGJ-ve dhe ZKBGJ-ve. Në praktikë, mandatet e tyre përziheshin (ndërthureshin) me atë të Njësive për të Drejtat e Njeriut (NJDNJ) në nivelet komunale dhe të ministrive.[5] Në vitin 2008, disa komuna themeluan njësitë për të drejtat e njeriut në kuadër të departamenteve të administratës dhe i vendosën ZKBGJ-në në kuadër të këtyre departamenteve.[6] Vendosja e zyrtarëve gjinorë në këto njësi, në vend se ato të jenë si zyre të pavarura në nivelet më të larta të vendimmarrjes, mund të dëmtojë punën e tyre.[7] Lëvizja e kohëve të fundit e ZBGJ-ve nga NJDNJ-të në Departamentet për Burime Njerëzore në disa ministri u arsyetua me Reformën e Administratës Publike.[8] Megjithatë, ndryshimet e bëra me Udhëzimin Administrativ të Ministrisë për Administratën Publike është në kundërshtim me rekomandimet për fuqizimin e rolit të zyrtarëve gjinorë në nivelet e larta vendimmarrëse.[9] Më herët, zyrtarët emëroheshin, por tani ata punësohen në bazë procedurave standarde të punësimit të nëpunësve civilë. Në sfidat kyçe hyjnë mandati i tyre i dobët,[10] ndërhyrja politike (përfshirë mospërfshirjen e tyre në hartimin e politikave,[11] caktimin e buxhetit ose në proceset e vendimmarrjes), burimet e pamjaftueshme financiare, ndikimi i pamjaftueshëm politik, keqinterpretimi nga vendimmarrësit se termi "gjini" nënkupton vetëm gratë, burimet e kufizuara njerëzore, dhe njohuritë e pamjaftueshme për proceset.[12] Disa vendimmarrës po ashtu u ankuan për mungesën e kapaciteteve profesionale të ZKBGJ-ve.[13] Shumica e aktiviteteve të ZKBGJ-ve janë *ad hoc*, duke u fokusuar në projekte në vend se çështjet gjinore të përfshihen në politikat, aktivitetet dhe buxhetet komunale.[14] Disa ZKBGJ zhvilluan strategji komunale për barazinë gjinore (në Prizren, Obiliq, Rahovec, Skenderaj); disa kanë siguruar mbështetje minimale financiare. Pesë kuvende komunale kanë linjë të veçantë buxhetore për barazinë gjinore.[15]

> "Roli i ZBGJ-ve shpesh keqinterpretohet. Fatkeqësisht ZBGJ-ja nuk i kryen detyrat e veta, por mendon vetëm për gratë."
> - Zyrtari për financa

> "Ka tre muaj që jam duke punuar në këtë vend si person kontaktues për barazi gjinore. Por sot ishte hera ime e parë që mu kërkua të marrë pjesë në takim." – një ZKBGJ *(të cilit iu kërkua të marrë pjesë në këtë hulumtim)*

Zyra Ligjore e ZKM-së duhet të bazohet në komentet e ABGJ-së kur i paraqet projektligjet në Këshillin e Ministrave për miratim. Megjithatë, deri më tani bashkëpunimi ka qenë i dobët. Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore (ZÇM) e ZKM-së,

drejtori i të cilës po ashtu mban pozitën e Koordinatorit Nacional për të Drejta të Njeriut, është përgjegjëse që të raportojë se sa i ka përmbushur Kosova obligimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me barazinë gjinore. Disa ngjashmëri në mandatin ligjor të ZÇM-së dhe ABGJ-së kanë rezultuar në dyfishim.[16] ZÇM është duke krijuar një Grup Këshillues dhe Koordinues për të drejtat e komunitetit LGBT.[17]

Si pjesë e negociatave që po vazhdojnë në mes të Kosovës dhe Serbisë, Zëvendëskryeministrja dhe udhëheqësja e dialogut (një grua, Edita Tahiri) është përgjegjëse për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB 1325), e cila bën thirrje për pjesëmarrje të grave në dialog, paqe dhe siguri.[18] Megjithatë, gratë nuk kanë qenë sa duhet të përfshira në dialog dhe nevojat dhe prioritetet e grave nuk janë marrë sa duhet parasysh.[19]

Ministria e Financave dhe zyrtarët e buxhetit në të gjitha nivelet janë përgjegjës që të sigurojnë ndarjen e fondeve adekuate për të avancuar barazinë gjinore në pajtim me legjislacionin ekzistues, si dhe të shikojnë se si vendimet buxhetore kanë ndikimi të ndryshëm te gratë dhe te burrat. Buxhetet nuk janë të harmonizuara me prioritetet e programeve që kanë të bëjnë me barazinë gjinore.[20] Kanë munguar vlerësimet e ndikimit, përfshirë edhe atë se si zgjedhjet buxhetore kanë ndikuar te gratë dhe burrat ndryshe.[21] Disa zyrtarë financiarë pas trajnimeve të kohëve të fundit kanë demonstruar se kanë njohuri dhe se e kuptojnë buxhetimin që i përgjigjet gjinive.[22]

Në hartimin, shqyrtimin dhe aprovimin e të gjitha ligjeve dhe politikave kombëtare, Kuvendi është përgjegjës që të marrë parasysh se a i përmbushin ato kushtet e Kushtetutës dhe ligjeve ekzistuese që kanë të bëjnë me barazinë gjinore. Gratë parlamentare kanë formuar Grupin e Grave Deputete, i cili avokon për politika që çojnë drejt barazisë gjinore. Ky grup ka një Strategji të veprimit,[23] dhe bordi i tij shqyrton ligjet në aspektin e perspektivës gjinore. Ai është duke mbështetur formimin e grupeve të grave deputete në të gjitha komunat. Sfidat me të cilat përballet ky grup janë mungesa e buxhetit, bazimi i tij në përkrahjen e donatorëve dhe nevoja për të tejkaluar dallimet mes partive politike dhe moshës së anëtareve të këtij grupi.[24] Komisioni i Kuvendit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione mbikëqyr ekzekutivin, duke shqyrtuar ligjet dhe politikat nga perspektiva gjinore dhe duke monitoruar zbatimin e tyre. Ai e ka monitoruar zbatimin e LBGJ-së.[25]

Në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Departamenti për Mirëqenie Sociale (DMS) e mbikëqyr punën e qendrave komunale për punë sociale (QPS), të cilat menaxhojnë rastet e dhunës në familje, përkujdesen për të drejtat e fëmijëve dhe ndihmojnë në shpërndarjen e ndihmës sociale. Intervistat sugjerojnë se këto institucione në planifikimin ose zbatimin e përgjegjësive të tyre nuk i marrin parasysh nevojat potenciale unike të grave dhe burrave.[26] DMS-të kontraktojnë strehimore joqeveritare të cilat i mbrojnë gratë dhe fëmijët që kanë përjetuar dhunën në bazë gjinore. Po ashtu në kuadër të MPMS-së, Qendrat Rajonale të Punësimit (QRP) dhe qendrat e trajnimit profesional duhet të mbështesin gratë dhe burrat që nuk janë të punësuar.[27] Instituti për Politika Sociale është përgjegjës për zhvillimin dhe promovimin e njohurive, aftësive dhe standardeve profesionale lidhur me Shërbimet Sociale dhe Familjare.[28] Ai duhet të bëj hulumtime, duke përfshirë edhe hulumtime nga perspektiva gjinore dhe të ofrojë trajnime, por ka bërë shumë pak për të përmbushur ketë mandat.

Ministria e Integrimit Evropian është përgjegjëse për Ndihmën për Zhvillim të Jashtëm, duke bashkëpunuar me Bashkimin Evropian në përzgjedhjen e prioriteteve për financim. Analiza gjinore konsiderohet e rëndësishme, por nuk është bërë.[29] Në vitin 2013, Ministria bashkëpunoi me ABGJ-në dhe Ambasadën e Suedisë, duke organizuar një takim koordinues të donatorëve për programet e financimit që çojnë drejt barazisë gjinore.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është përgjegjëse që të sigurojë qasje të barabartë të vajzave dhe djemve në arsimin e obligueshëm. Drejtoritë Komunale të Arsimit e kanë mandatin qw të ndajnë fonde të mjaftueshme për transport falas, duke u mundësuar nxënësve që të vijojnë shkollimin. MASHT është përgjegjëse që të sigurojë që programi dhe praktikat mësimore të tregojnë ndjeshmëri në aspektin gjinor, si dhe të zhvillojnë programe që kanë të bëjnë me barazinë gjinore. Shkollat dhe mësimdhënësit luajnë një rol të rëndësishëm në përkujdesjen për nevojat ndryshme mësimore, të cilat janë unike për vajzat dhe djemtë.

Ministria e Shëndetësisë (MSH) duhet të krijojë praktika që sigurojnë që qasja e personelit të jetë për të ndihmuar gratë dhe burrat. Reformat mund të përmirësojnë kujdesin e tanishëm të dobët shëndetësor.[30]

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik duhet të sigurohen që gratë dhe burrat të kenë qasje të barabartë në përkrahjen që ofrohet dhe në resurset për zhvillim. Ato kanë filluar të adresojnë mangësitë e mëhershme në këtë aspekt.[31]

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) mbikëqyr komunat dhe monitoron procesin e decentralizimit të shëndetësisë, shërbimeve sociale dhe arsimit në nivelin komunal. MAPL dhe Ministria e Administratës Publike (MAP) duhet të sigurojnë që shërbimet publike tu përgjigjen nevojave të grave dhe burrave. MAP-ja mbikëqyr zbatimin e ligjeve për nëpunësit civilë bazuar në meritokraci, duke siguruar perspektivën gjinore. Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) ofron trajnime për nëpunësit publikë, përfshirë edhe në temat që kanë të bëjnë me barazinë gjinore.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) duhet të sigurojë që të gjitha planet hapësinore të marrin parasysh nevojat e ndryshme të grave dhe burrave (p.sh., rampat e qasjes për prindër me karroca fëmijësh, për të moshuarit me aftësi të kufizuara). Ajo po ashtu është përgjegjëse që të marrë parasysh ndikimin potencialisht të ndryshëm të çështjeve mjedisore te gratë dhe burrat (p.sh., qasja në ujë dhe energji të pastër).

Ministria e Drejtësisë duhet të përfshijë perspektivën gjinore në hartimin e legjislacionit për çështje ligjore dhe gjyqësore, duke mbikëqyr punën e shërbimeve korrektuese, dhe duke përfaqësuar institucionet publike në gjykata dhe në arbitrazh.[32] Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) mbikëqyr gjykatat dhe heton pretendimet për sjellje të pahijshme të gjyqtarëve, përfshirë edhe ato për diskriminim gjinor. Gjykatat nuk mbledhin të dhëna të ndara sipas gjinive lidhur me viktimat, kryesit e veprave dhe dënimet, gjë që e vështirëson vlerësimin e diskriminimit në baza gjinore në kuadër të sistemit gjyqësor. KGJK po ashtu e menaxhon Objektin e Sigurisë së Brendshme (OSB), një shtëpi e sigurt për viktimat e trafikimit 'me rrezik të lartë".[33] Ajo po ashtu koordinon ndihmën lidhur me dhunën në familje. Instituti Gjyqësor i Kosovës ofron trajnime për gjyqtarët, përfshirë edhe trajnimet për barazi gjinore.

Këshilli Prokurorial i Kosovës është përgjegjës për mbikëqyrjen e punës së prokurorëve (35.5% e të cilëve janë gra).[34] Ai nuk ka zyrtarë për barazi gjinore dhe nuk merr parasysh çështjen gjinore në punën e vet.[35] Pas nënshkrimit të një Memorandumi të Mirëkuptimit me MD-në në vitin 2012, ai e mbikëqyr edhe punën e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave të Krimit.[36] Zyra ka në funksion një linjë të hapur kontakti pa pagesë kundër trafikimit dhe për dhunën në familje. Zyrat për Ndihmë Juridike kanë një mandat më të gjerë se sa vetëm si avokat të viktimave, duke u ofruar ndihmë juridike grave dhe burrave që nuk mund ta përballojnë atë në rastet penale dhe civile.[37] Oda e Avokatëve të Kosovës e ka një komision për çështje gjinore dhe komunitete, i cili e ka miratuar planin e veprimit 2014 me qëllim të fuqizimit dhe mbrojtjes së pozitës së grave dhe komuniteteve në sistemin gjyqësor.[38]

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) koordinon përpjekjet kundër trafikimit. Ajo duhet të sigurojë perspektivën gjinore në shërbimet e saj për personat e riatdhesuar. Megjithatë, ajo nuk ka zyrtar për barazi gjinore dhe nuk e merr parasysh perspektivën gjinore në buxhetim. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, përgjegjëse për politikat dhe Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) janë përgjegjëse që të sigurojnë që politika e tyre të jetë në përputhje me RKSKB 1325 dhe duhet të zbatojnë këtë Rezolutë. Kjo përfshinë sigurimin e balancës gjinore në kuadër të forcës (gratë momentalisht përbëjnë 8.1% të saj), dhe qasjes së ndjeshme gjinore në shërbimet e saj.[39] FSK e ka një pikë kontaktuese për çështje gjinore.

Policia e Kosovës ka përgjegjësi që tu përgjigjet nevojave unike të grave dhe burrave në zbatimin e ligjeve të Kosovës. Ajo e ka një pikë kontaktuese, një plan të veprimit për përfshirjen gjinore, politika për rritjen e pjesëmarrjes së grave në të gjitha nivelet, një këshilltare për çështje gjinore në administratën e vet,[40] dhe një bord këshillues për barazi gjinore me 100 hetues rajonalë të trajnuar për dhunën në bazë gjinore.[41] Policia mban të dhëna të ndara sipas gjinisë.[42] Akademia e Kosovës për Siguri Publike kërkon nga të gjithë policët që të vijojnë modulet e obligueshme të trajnimit për "Konceptet gjinore themelore" dhe për "Legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar"; të gjitha trajnimet e tjera bazike dhe të avancuara përfshijnë perspektivën gjinore.[43] Ligji për Policinë bën thirrje për pjesëmarrje prej 25% të secilës gjini, por gratë përbëjnë 14.5% të forcës.[44] FSK dhe policia ndërmarrin masa afirmative për të siguruar punësimin dhe mbajtjen [në punë] e grave. Megjithatë, policia ballafaqohet me problemin e mbajtjes së grave [në punë] për shkak të të ardhurave të ulëta, ndryshimeve në statusin martesor, kushteve të punës dhe roleve tradicionale të gjinive që nënkupton se gratë kanë më shumë përgjegjësi në shtëpi se sa burrat.[45] Policia zbaton politika për lehtësimin e

përgjegjësive gjatë shtatzënisë, dhe për inkurajimin e konkurrueseve (femra). Policet në vitin 2013 themeluan Shoqatën e Grave të Policisë së Kosovës.[46] Njësitë Hetimore Rajonale të Dhunës në Familje përfshijnë nga një police dhe një polic të trajnuar në mënyrë të veçantë. Policia po ashtu ka njësi të trajnuara kundër trafikimit. Ekzistojnë edhe procedura speciale unike të operacionit për t'iu përgjigjur raportimeve të dhunës në familje dhe trafikimit.[47] Ekzistojnë dy lloje të këshillave të sigurisë në komunitet. Njëri që udhëhiqet nga kryetarët e komunave, i cili përfshinë policinë dhe akterët e tjerë. Rregullorja e policisë parasheh që këshilli tjetër të përfshijë akterë të ndryshëm në diskutimin e çështjeve të sigurisë së paku dy herë në vit. Meshkujt marrin pjesë në këto takime më shumë se sa gratë, përveç nëse diskutohen çështje të cilat gratë i konsiderojnë të rëndësishme.[48] Policia nuk ka strategji të komunikimit për të sensibilizuar gratë dhe burrat përmes mjeteve të ndryshme potenciale. Të drejtat e komunitetit LGBT diskutohen shumë pak në polici dhe në forcën e sigurisë.

Institucioni i pavarur i Avokatit të Popullit mbikëqyr se a i respektojnë institucionet standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Vendimet e tij nuk janë detyruese. Ky institucion e ka një Seksion kundër Diskriminimit, i cili përbëhet nga juristë të cilët trajtojnë çështjet e barazisë gjinore.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbledh të dhëna të ndara sipas gjinive dhe publikon dy herë në vit raporte statistikore që fokusohen në raportet gjinore. Ekspertiza e saj gjinore në masë të madhe bazohet në mbështetjen e donatorëve.[49]

Banka Qendrore e Kosovës mbikëqyr bankat komerciale dhe grupet e tjera të interesit, duke përcaktuar politika që rregullojnë punën e bankave në Kosovë. "Gjinia nuk diskutohet fare" në bërjen e politikave.[50]

Universiteti i Prishtinës ka një zyrë për barazi gjinore në rektorat, e cila për momentin nuk ka staf të mjaftueshëm dhe raportohet se nuk është aktive.[51] Universiteti ka gjashtë lëndë që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, kryesisht në shkencat shoqërore.[52] Instituti për Studime Shoqërore ka krijuar Programin Universitar për Studime dhe Kërkime Gjinore në vitin 2013.[53] Vetëm 32.3% e 1,060 profesorëve janë gra. Nuk ka ndonjë strategji për avancimin e barazisë gjinore në universitet.[54] Universiteti nuk ka as politika të ndjeshme në aspektin gjinor.[55] Ekziston një politikë në Kodin e Etikës kundër ngacmimit seksual por përkufizimi i ngacmimit dhe mekanizmat e raportimit mbesin të paqartë.[56] Ngacmimi seksual raportohet se është mjaft i përhapur në universitet por raportimet e tyre kanë mbetur pa u trajtuar.[57] Jashtë universitetit, profesorët kanë marrë pjesë në hartimin dhe ndryshimin e ligjeve dhe politikave që kanë të bëjnë me barazinë gjinore në Kosovë.

Në nivelin komunal, kryetarët e komunave, drejtoritë, zyrtarët e financave dhe të gjithë shërbyesit civilë janë përgjegjës për përmirësimin e barazisë gjinore.

Shoqëria civile

Shumë organizata të ndryshme të shoqërisë civile (OSHC) të udhëhequra nga gratë veprojnë në nivelin komunal dhe kombëtar. Shumica (77) janë organizata anëtare të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RRGGK). Ky është një rrjet ndëretnik i organizatave të ndryshme për nga shpërndarja gjeografike dhe i 20 anëtarëve individualë me mision të përbashkët, me plan strategjik dhe me grupe punuese të fokusuara në prioritetet strategjike të rrjetit. Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane në Kosovë përfshinë 13 organizata dhe 15 aktiviste. Shtatë gra udhëheqëse afariste në vitin 2013 themeluan grupin G-7, dhe që nga atëherë kanë krijuar Odën Ekonomike të Gruas për fuqizimin ekonomik të grave.[58] Koalicioni i Strehimoreve përfshinë tetë strehimore që gjenden gjithandej Kosovës me procedura të përbashkëta, koordinim dhe avokim për përkrahje më të madhe financiare. Organizatat e grave kanë avokuar për një kornizë ligjore e cila avancon të drejtat e grave dhe për zbatimin e asaj kornize.[59] Ato kanë organizuar disa iniciativa për ngritjen e vetëdijes për transformimin e normave gjinore dhe informimin e qytetarëve për të drejtat e tyre. Ato po ashtu ofrojnë disa shërbime në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës (p.sh., strehim). OSHC-të e tjera kanë bashkëpunuar me organizatat e grave në avokimin lidhur me barazinë gjinore dhe /ose kanë bërë hulumtime të rëndësishme.[60] Megjithatë, shumica e forumeve rrallë marrin parasysh perspektivën gjinore në raportet e tyre.[61] Disa organizata kanë punuar me meshkujt e rinj për ndryshimin e normave gjinore.[62]

> "Ne i respektojmë gratë, vetëm se jo në letër."
> - Një përfaqësues i një forumi

Asociacioni i Komunave të Kosovës nuk ka komision për barazinë gjinore e as strategji gjinore. [63] Dhjetë komuna kanë grupe të avokimit për barazi gjinore të cilat i bëjnë bashkë gratë në shoqërinë civile dhe në politikë në mbështetjen e përpjekjeve avokuese të njëra tjetrës për

përmirësimin e politikave drejt barazisë gjinore.[64] Puna e tyre ka çuar në krijimin e planeve për barazisë gjinore në nivelin komunal, mes politikash tjera.

Partitë politike duhet të sigurojnë përfaqësimin e grave dhe burrave në të gjitha nivelet, si dhe të marrin parasysh nevojat e ndryshme potenciale të grave dhe burrave në planifikim, buxhetim dhe në vlerësimin e ndikimit. LDK, AAK, dhe AKR kanë forume të grave, por atyre u ndahen shumë pak ose nuk u ndahen fare resurse.[65] PDK nuk ka forum të grave.[66] E as *Vetëvendosje*, sepse ata synojnë të përfshijnë gratë në të gjitha nivelet, e jo t'i ndajnë ato në një forum të veçantë, thanë përfaqësuesit e tyre.[67]

Mediat e shtypura dhe elektronike luajnë rol shumë të rëndësishëm lidhur me barazinë gjinore (shih seksionin 5).[68]

Institucionet fetare po ashtu ndikojnë në (pa)barazinë gjinore. Njerëzit fetarë të moderuar mund të inkurajojnë barazinë gjinore dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Ekstremistët mund të inkurajojnë kthimin në rolet tradicionale të gjinive ose të pengojnë të drejtat e grave për pjesëmarrje publike dhe angazhimin e barabartë të burrave në shtëpi.[69] Duhet të hulumtohet më tej rreth ndikimit që ka feja në barazinë gjinore në Kosovë.

Akterët ndërkombëtarë

Disa akterë ndërkombëtarë mbështesin përpjekjet për përmirësimin e barazisë gjinore dhe/ose përpiqen të sigurojnë përfshirjen e gjinive në punën e tyre.[70] Megjithatë, vetëm pak sish përfshijnë analizën gjinore në vlerësimin e nevojave dhe ndikimit të grave dhe burrave në planifikim, zbatim *dhe* monitorim dhe vlerësim.

Bashkimi Evropian (BE) nuk e ka marrë parasysh sa duhet çështjen gjinore, dhe është duke punuar që të përmirësojë ketë gjë.[71] Komisioni Evropian hap konkurse për financimin e OSHC-ve përmes Instrumentit të tij Evropian për të Drejtat e Njeriut (EIDHR), mes instrumentesh të tjera, të cilat kërkojnë përfshirjen e gjinive në të gjitha programet. Ai mbështet disa programe të fokusuara në avancimin e barazisë gjinore. Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) ka dy këshilltare për çështje gjinore në nivel të [zyrës së] Zëvendës Shefit të Misionit.[72]

Forca e Kosovës (KFOR) e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) e ka një këshilltare gjinore e cila i edukon dhe trajnon stafin për përfshirjen gjinore, si dhe inkurajon punësimin e grave në KFOR, veçanërisht në ekipet ndërlidhëse dhe monitoruese që punojnë me qytetarët.[73]

Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT) përpiqet të përfshijë gjinitë në të gjitha programet e veta, duke përdorur një indikator për gjinitë.[74] Agjencitë e OKB-së janë të përfshira në disa përpjekje për të avancuar barazinë gjinore që kanë të bëjnë me politikat, strategjitë dhe iniciativat kombëtare; sundimin e ligjit, drejtësinë dhe të drejtat e njeriut, politikën, situatën socio-ekonomike të Kosovës, dhe dhunën në bazë gjinore. Organizata Gratë e OKB-së (UN Women) është e fokusuar në gra, paqe dhe siguri që nga viti 2002. UNFPA punon në përmirësimin e shëndetit riprodhues dhe maskulinitetit përmes punës me të rinjtë dhe me udhëheqësit fetarë. UNDP mes tjerash ka programe për Drejtësinë Gjinore.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) përpiqet të avancojë demokratizimin në Kosovë, të promovojë qeverisjen e mirë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe mbështetjen e sundimit të ligjit. Ajo ka një Politikë dhe Plan të Veprimit për Çështjet Gjinore (2013-2015), këshilltare gjinore dhe pika kontakti për çështje gjinore në secilin departament dhe në pesë qendrat rajonale të saj. Ato përpiqen të përfshijnë çështjet gjinore në të gjitha programet e tyre dhe ndërmarrin veprime specifike drejt barazisë gjinore dhe të drejtave të grave.[75] Vëllimi i madh i punës dhe udhëzimet e pamjaftueshme për përfshirjen e gjinive mund të ndikojnë në cilësinë e përfshirjes gjinore.[76] Raportet e OSBE-së mbështesin, mes programesh tjera, edhe buxhetimin komunal që i përgjigjet gjinive dhe grupet e grave deputete.

Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar përmes praktikave të tyre të huadhënies ndikojnë në politikat financiare, përfshirë edhe në planifikimin dhe zbatimin afatshkurtër të buxhetit në Kosovë. Politikat që ato promovojnë mund të ndikojnë ndryshe te gratë dhe burrat. Banka Botërore ka udhëhequr punën analitike për gjinitë dhe ka një program për promovimin e qasjes së grave në mundësitë ekonomike.[77]

Disa qeveri përpiqen të avancojnë barazinë gjinore përmes mbështetjes së zhvillimit të Kosovës. USAID-i planifikon të përfshijë gjinitë në realizimin e tri objektivave zhvillimore: përmirësimin e sundimit të ligjit dhe qeverisjes, rritjen e investimeve dhe punësimit në sektorin privat,

dhe përmirësimin e kapitalit njerëzor.[78] Suedia mbështet organizatat e grave përmes organizatës Kvinna till Kvinna dhe Mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut. Agjencia Austriake për Zhvillim mbështet RRGGK-në dhe përfshinë gjinitë në programet e saj për zhvillimin e mikro-ndërmarrjeve dhe bujqësisë. Ambasada e Finlandës mbështet programin e UNKT për dhunën në bazë gjinore. Organizata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) përpiqet të përfshijë gjinitë në programet e saj në arsim, zhvillim ekonomik dhe qeverisje të mirë.[79] Organizata Zviceran për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SDC) përfshinë gjinitë si "temë transversale" në të gjitha programet e veta. Ajo ka mbështetur trajnimin e Helvetas në integrimin e gjinive në planifikimin e buxhetit komunal dhe hartimin e doracakut për buxhetin që i përgjigjet gjinive.[80] Grupi Joformal për Siguri dhe Çështje Gjinore i bashkon akterët që punojnë në dimensionin e sigurisë për shkëmbimin e informatave dhe koordinim. Ai ka nëngrupe të fokusuara në buxhetim që i përgjigjet gjinive lidhur me dhunën seksuale gjatë konfliktit dhe dhunën në familje. CfD, ambasada e Norvegjisë, ambasada e Finlandës dhe ambasada e Mbretërisë së Holandës, Fondi Global për Gratë, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, Fondi i RRGGK-së për Gratë e Kosovës, Friedrich Erbert Stiftung, Fondacioni Mott, Mama Cash, Fondi i Vëllezërve Rockefeller, Fondi për Veprim Urgjent dhe Ambasada e SHBA-së japin fonde të vogla për organizatat e grave.[81] Në Kosovë veprojnë dhjetëra organizata ndërkombëtare. Shumica e tyre theksojnë se i kanë të përfshira gjinitë në programet e tyre, por pak prej tyre e trajtojnë barazinë gjinore si të tillë.[82]

Sektori privat

Bizneset janë të obliguara të zbatojnë ligjet që avancojnë barazinë gjinore në vendin e punës. MPMS duhet të mbikëqyr zbatimin e Ligjit të Punës ndërsa ABGJ-ja zbatimin e LBGJ-së. Vetëdijesimi i pamjaftueshëm për kushtet ligjore (p.sh., 41.2% e bizneseve nuk kanë njohuri për Ligjin e ri të Punës) si duket e pengon zbatimin e tij.[83] Duhet të bëhen hulumtime të mëtejshme lidhur me sektorin privat dhe barazinë gjinore.

Sfidat dhe mundësitë

> "Pse mendojnë se barazia gjinore ka të bëj vetëm me gratë? Ajo ka të bëj edhe me burrat."
> – Zyrtari për barazi gjinore

Të kuptuarit e barazisë gjinore është përmirësuar dukshëm në dekadën e fundit,[84] edhe pse ende ka keqkuptime, veçanërisht tendenca për të konsideruar se termi 'gjini' i referohet vetëm grave.[85] Në caktimin e buxhetit dhe në planifikim, akterët nuk e përdorin sa duhet analizën e nevojave të ndryshme të grave dhe burrave. Akterëve zakonisht u mungojnë njohuritë dhe instrumentet për të siguruar qasjen gjinore. Madje, shumica e akterëve janë të interesuar që të mësojnë më shumë për barazinë gjinore dhe për strategjitë për përmirësimin e saj. Ekzistojnë disa mundësi për mbështetjen e ABGJ-së.[86] ZBGJ-të dhe ZKBGJ-të mund të mësojnë teknikat për aplikimin e buxhetit që i përgjigjet gjinive, avokimin në institucione për perspektivën gjinore, dhe aftësitë e tjera specifike për sektorët përmes vizitave studimore dhe mentorimit. Qeveria bashkë me donatorët dhe ekspertët gjinorë të OSHC-ve mund të japin udhëzime dhe instrumente të qarta konkrete të shoqëruara me mentorim ditor për atë se si të përfshihen në mënyrë praktike çështjet gjinore në të gjitha nivelet. Qarkorja buxhetore mund të ndryshohet dhe mund të hartohen udhëzimet në mënyrë që proceset buxhetore në të gjitha nivelet të sigurojnë edhe perspektivën gjinore. Të gjitha institucionet duhet që së paku të plotësojnë kushtet e EUROSTAT-it për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinive. Forumet dhe avokatët për çështje gjinore mund të ndajnë më shumë ekspertizën e tyre. Mediat dhe udhëheqësit fetarë mund të ndihmojnë në ripërkufizimin e roleve të gjinive.[87] Akterët ndërkombëtarë mund të vazhdojnë përkrahjen si për institucionet ashtu edhe për avokatët e shoqërisë civile, duke siguruar perspektivën gjinore. Ekzistojnë mundësi për analiza të ndryshme të sektorit privat nga perspektiva gjinore dhe të zhvillojnë aktivitetet e mëpastajme duke u bazuar në gjetjet e këtyre analizave.

3) Sundimi i ligjit, drejtësia dhe të drejtat e njeriut

Ky seksion trajton kornizën ligjore dhe zbatimin e saj nga perspektiva gjinore, përfshirë edhe informatat për pluralizmin e sistemeve të së drejtës (e drejta zakonore, e drejta fetare dhe e

Treguesit e të drejtave të njeriut	Femra	Meshkuj
Të mitur të dyshuar për krime	2-4%	96-8%
Pronarë të pronave[1]	7.9%	83.4%
Persona të riatdhesuar (2010)	22%	78%

drejta civile). Ai fokusohet në Kushtetutë, në ligjet për trashëgiminë, kundër diskriminimit, për banimin, për familjen dhe në ligjin e punës.[2] Analiza trajton çështjet më relevante lidhur me realizimin *de jure* të të drejtave të garantuara dhe zbatimin *de facto* të këtyre të drejtave.

Krimi, sundimi i ligjit dhe masat korrektuese

Meshkujt janë të prirë të bëjnë më shumë krime. Djemtë e kryejnë shumicën e krimeve të të miturve (96% e veprave të dyshuara të bëra nga fëmijët nën moshën 14 vjeçare dhe 98% nga fëmijët 14-18 vjeç).[3] Djemtë romë, ashkali dhe egjiptianë nën moshën 14 vjeçare duket se janë në mënyre proporcionale të dyshuar për kryerjen e krimeve. Burrat dhe djemtë e burgosur mbahen të ndarë, ndërsa vajzat dhe gratë nuk janë, gjë që mund të ketë ndikim negativ në mirëqenien e vajzave.

Të drejtat pronësore dhe trashëgimore

Kushtetuta e Kosovës, në pajtim me të drejtat e garantuara me CEDAW, si dhe me ligjet për trashëgiminë dhe për familjen ofrojnë barazi për burrat dhe gratë në gëzimin e të drejtave në pronë. Megjithatë, në vitin 2014 gratë janë pronare të vetëm 15,2% të pronave, përfshirë edhe pronësinë mbi tokën (gjinia e 10% të pronarëve nuk dihet).[4] Prandaj, pronësia e grave vlerësohet në 8%.[5]

> "Kur babai im ua ndau pronën dy vëllezërve të mi, ai nuk më llogariti mua fare. Unë nuk dua të kundërshtoj vullnetin e tim ati."
> - Një e anketuar

Ndonëse legjislacioni siguron të drejta të barabarta trashëgimore për fëmijët martesor dhe jashtëmartesor, gjatë prishjes së martesës në gjykata gratë shpesh heqin dorë nga e drejta e tyre në trashëgimi, duke ua dhënë pjesën e tyre të pronës familjare vëllezërve të tyre.[6] Në vitin 2011, OJQ Norma raportoi se nga 4,994 rastet e monitoruara në gjykata në pesë rajonet e Kosovës, vetëm në 487 raste (9.75%) gratë dhe burrat kishin trashëguar pronën në mënyrë të barabartë.[7] Gratë nganjëherë e humbin të drejtën në trashëgimi për të vazhduar që të gëzojnë mbrojtjen e vëllezërve ose të familjes së tyre.[8] Më tej, anëtarët meshkuj të familjes shpesh nuk japin informata të plota lidhur me numrin e anëtarëve të familjes, duke raportuar në mënyrë të rrejshme anëtarët femra që ekzistojnë. Gjykatat rrallë ose kurrë nuk i verifikojnë këto pretendime ose certifikatat e vdekjes, të lëshuara nga autoritetet komunale, edhe pse ka raste të certifikatave të rrejshme të vdekjes.[9] Këto vepra penale[10] janë çështje që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit sepse grave u mohohen të drejtat e tyre. Shumica e rasteve nuk janë iniciuar *ex officio*, por nga anëtarët meshkuj të familjes, që është e kundërta e asaj që kërkohet me ligj.[11] Vetëm kohëve të fundit transaksionet dhe marrëveshjet ndërmjet bashkëshortëve që kanë të bëjnë me marrëdhëniet pronësore duhet të legalizohen nga shërbimi i noterisë.[12] Kjo, *de jure*, ka përmirësuar statusin e ndarjes së pronës martesore. Megjithatë, *de facto*, kjo rrallë zbatohet për shkak të procedurave të gjata të gjykatës. Një moszhvillim i mjaftueshëm i gjyqësorit, të cilit i mungojnë resurset e mjaftueshme njerëzore dhe buxhetore, korrupsioni, përmbarimi joadekuat i kontratave dhe fakti se mund të bëhen deri në 20 kërkesa për një pronë të vetme (pasi që regjimi serb i ka marrë të gjithë librat zyrtar kadastral në periudhën 1998-1999), të gjitha e pengojnë shpërndarjen e barabartë të pronës.[13] Kthimi i kohëve të fundit i kopjeve të librave kadastralë nga Serbia në Kosovë ofron një mundësi të mirë për verifikimin e pronësisë.

> "Ne si gjykata duhet të kujdesemi për zbatimin e plotë të ligjit. Unë vetëm mund tu rekomandoj të gjithë gjyqtarëve që ta bëjnë ketë."
> – Kryetari i Gjykatës Themelore

Në të kaluarën, *Kanuni i Lekë Dukagjinit* ka ndikuar në familjet kosovare, si përmbledhje kryesore e të drejtës zakonore shqiptare.[14] Kanuni i përjashtonte gratë nga trashëgimia, duke i njohur vetëm djemtë (bijtë) si trashëgimtarë; rregulla të ngjashme janë aplikuar edhe për bashkëshortet (gratë e martuara).[15] Për dallim nga kjo, *sipas* fesë kryesore tradicionale islame, rregulla të tilla nuk aplikohen pasi që vajzat mund të jenë trashëgimtare.

> "Në familjet e vogla, gratë bëhen dominuese sepse familjet kanë nevojë për gra. Ato kanë nevojë për sundim të ligjit. Ato nuk mund të bazohen në mbrojtjen e 30 vëllezërve me kallashnikovë. Lulëzimi i ndërtimeve në Prishtinë është shenjë se familjet po lëvizin nga ekonomitë familjare me shumë familje në banesa më të vogla."
> – Përfaqësuesi i një partie politike

Një koment që u përsërit nga të intervistuarit ishte se Kosova ka kaluar nëpër një periudhë tranzicioni: nga mentaliteti tradicional i jetës së përbashkët të shumë familjeve (të drejtat grupore) drejt atij (të drejtave) individual. Kjo mund të ofrojë një mundësi për përmirësimin e qasjes së grave në të drejtat pronësore dhe në trashëgiminë sipas ligjit.

Ligji i Punës

Ligji i Punës garanton të drejtën e grave për punë, duke u ofruar grave 6+3+3 muaj pushim të lehonisë. Punëdhënësit kanë përgjegjësi ligjore që të paguajnë për gjashtë muajt e parë, ndërsa shteti mbulon tre muajt e tjerë dhe tre muaj mund të merren pa pagesë.[16] Sektori privat e ka kritikuar ligjin se i ka kontribuar diskriminimit të grave në praktikat e punësimit dhe punëdhënësit përdorin kontrata afatshkurtra për t'iu ikur përgjegjësive lidhur me pushimin e lehonisë.[17] MPMS është duke e rishikuar ligjin, duke diskutuar për shkurtimin e pushimit të lehonisë. Shkurtimi i pushimit të lehonisë pa masa shtesë për përkujdesje për fëmijët mund të diskriminojë gratë sa i përket mundësive të punësimit sepse në Kosovë fëmijët mund të gëzojnë përkujdesje në çerdhe fëmijësh vetëm pasi të kenë mbushur një vit. Hapësira ndërmjet pushimit të lehonisë dhe një viti i detyron gratë të zgjedhin në mes të familjes dhe punës. Burrat nuk janë të detyruar të marrin një vendim të tillë, edhe pse pabarazia në pushimin e atësisë mund të thuhet se është diskriminim kundër burrave. Ligji i Punës parasheh vetëm dy javë e dy ditë pushim të atësisë pasi të ketë lindur foshnja dhe deri sa fëmija të mbush tri vjet.[18]

Të drejtat e njeriut, kthimet e detyrueshme dhe ri-integrimi

Duke marrë parasysh papunësinë e lartë dhe shkallën e varfërisë në Kosovë (shih seksionin 5), mund të argumentohet se shtetet që bëjnë kthimin e detyrueshëm shkelin marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe shkelin Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit duke i shtyrë njerëzit në varfëri. Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit ka një program të ri-sistemimit për personat që kthehen në mënyrë vullnetare, edhe pse akoma nuk është vlerësuar ndikimi i këtij programi, përfshirë edhe vlerësimin nga perspektiva gjinore.[19] Në vitin 2013, përafërsisht 1,330 persona janë riatdhesuar në Kosovë. Të dhënat nga viti 2010 ilustrojnë se janë riatdhesuar shumë më shumë meshkuj (78%) se sa femra (22%).[20] Femrat e pamartuara, fëmijët, romët, ashkalitë, egjiptianët, dhe personat me aftësi të kufizuara mund të përballen me vështirësi sipas qasjes që parashihet në Planin e Veprimit të Qeverisë për Ri-integrim.[21] Femrat kryefamiljare të riatdhesuara janë përjashtuar nga programet e ndihmës.[22] Kosovës i mungon një analizë gjinore që vlerëson ndikimin e kthimit vullnetar dhe kthimit të detyrueshëm te gratë, vajzat, burrat dhe djemtë.

Të drejtat e pakicave

Është e qartë se Komisioni i Kuvendit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim është fokusuar më shumë në pakicën serbe se në grupet e tjera etnike.[23] Grupet e pakicave jo-serbe kanë shprehur shqetësimin se nevojat e tyre merren më pak parasysh nga institucionet dhe akterët ndërkombëtarë.[24] Ekziston një Strategji dhe Plan Veprimi për Integrimin e Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve, por ai nuk i kushton vëmendje të mjaftueshme pabarazive gjinore dhe mbetet për tu zbatuar.[25] Sipas aktivistëve, gratë rome, ashkali dhe egjiptiane ballafaqohen me "diskriminim të trefishtë": nga familjet e tyre, nga komunitetet dhe nga institucionet e nivelit qendror.[26] Derisa nuk ka ndonjë dallim të madh ndërmjet këtyre tri grupeve etnike sa i përket përmasës së diskriminimit me të cilin përballen, ekzistojnë dallime varësisht se a janë ato nga zonat rurale apo urbane, nga niveli i shkollimit të familjeve të tyre dhe traditat që i respekton "*mahalla*" (lagjja) e tyre, thonë aktivistët.[27]

Të drejtat e personave më aftësi të kufizuara

> "Duhet shkuar në dy ose tri vende për një kontroll të thjeshtë dhe rëntgen, që është e vështirë për ne."
> - Aktiviste për të drejtat e grave në karrocë invalidësh

Personat me aftësi të kufizuara (përfshirë fizike, mendore, të verbrit, të shurdhrit) përballen me diskriminim. Institucionet nuk i kanë zbatuar sa duhet ligjet që sigurojnë qasjen në arsim, shërbime sociale dhe shërbime të tjera.[28] Intervistat tregojnë se gratë mund të përballen me vështirësi shtesë edhe pse ekzistojnë shumë pak hulumtime për ketë.[29]

Të drejtat e personave LGBT

Një studim i kohëve të fundit nga Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR), më shumë se 40% e 88 personave LGBT të intervistuar theksuan se ata janë ngacmuar me fjalë në publik; përafërsisht 10% e tyre janë rrahur, therë me thikë, pështyrë ose kërcënuar. Pavarësisht se a janë homoseksualë haptazi, gjysma e tyre jetojnë në frikë nga homofobia dhe keqtrajtimi i përhapur.[30] Një 10% tjetër frikësohen nga rritja e grupeve fetare radikal.[31] Rreth gjysma e të anketuarve kanë frikë "që të dalin hapur" para familjeve të tyre për shkak të përvojës së të tjerëve që ishin lëçitur.

Korniza ligjore e Kosovës ofron mbrojtje të të drejtave të njeriut për personat LGBT në Kushtetutë.[32] Kushtetuta e thekson edhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikën e saj gjyqësore si drejtpërdrejtë të zbatueshme në legjislacionin e Kosovës. Megjithatë, Kushtetuta nuk e njeh të drejtat e personave transgjinorë e as nuk u ofron mbrojtje atyre. Kushtetuta nuk e thekson se martesa duhet të bëhet ndërmjet mashkullit dhe femrës, por i referohet gjerësisht të drejtës së secilit që të martohet dhe të krijojë familje. Megjithatë, Ligji për Familjen e definon martesën si bashkim i burrit dhe gruas. Jo-kushtetutshmëria e kësaj dispozite të Ligjit për Familjen nuk është kontestuar akoma nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Ligji kundër Diskriminimit ndalon diskriminimin në bazë të orientimit seksual.[33] Megjithatë, legjislacioni është zbatuar dobët dhe nuk ekziston ndonjë shënim për rastet kur gjykatat e kanë përdorur ketë ligj.

Pothuaj 67% e prokurorëve të intervistuar nga YIHR nuk mendonin se ka dhunë kundër personave LGBT.[34] Ekzistonte një hezitim për hetimin dhe ndjekjen penale të sulmuesve në manifestimin *Kosova 2.0* në vitin 2013, manifestim i një OJQ-je lokale për promovimin e të drejtave të personave LGBT; rasti ka filluar të trajtohet vetëm pas presionit të akterëve ndërkombëtarë dhe EULEX-it. Policia e Kosovës nuk është proaktive në hetimin e raporteve për ngacmime dhe sulme kundër personave LGBT.[35] Në përgjithësi, grupet e rrezikuara kanë më pak qasje në drejtësi dhe në shfrytëzimin e plotë të mjeteve juridike dhe kompensimit për krimet që i përjetojnë, siç dëshmohet në rastet e ndjekjes penale dhe dënimeve lidhur me dhunën në bazë gjinore (shih seksionin 6). Edhe pse më pak e dukshme, siç tregon analiza më lartë, diçka e ngjashme ndodh edhe lidhur me personat LGBT, të cilët përballen me diskriminim në të gjitha nivelet: shoqërisë, familjes, shtetit.

Sfidat dhe mundësitë

Gëzimi efektiv i të drejtave të grave në pronë ndikohet deri diku nga zakonet dhe traditat patriarkale, por edhe nga sundimi i dobët ligjit që bëhet nga institucionet e përfshira. Kosova vazhdon të përballet me sfida të mëdha në lidhje me sundimin e ligjit të cilat përkeqësohen edhe më shumë për shkak të korrupsionit, vendimeve të dobëta të gjykatave, ekzekutimit të dobët të kontratave dhe në përgjithësi zbatimin të dobët të ligjeve. Proceset e integrimit në BE duhet të shihen si një mundësi për t'i kushtëzuar institucionet e Kosovës që të mbrojnë plotësisht gëzimin e të drejtave në pronë dhe të drejtave të tjera si të drejta themelore të garantuara me ligjet e Kosovës. Po ashtu për të mbështetur balancimin e punës dhe familjes për gratë, shteti duhet të mendoj për krijimin dhe bërjen të obligueshëm pushimin e atësisë i cili mund të mënjanojë diskriminimin në bazë gjinore. Kjo do të avancojë sundimin e ligjit dhe do të ndikojë në zhvillimin ekonomik. Në përputhje me rekomandimet e YIHR-së, shteti duhet të ketë një rol më proaktiv në promovimin e trajtimit të barabartë dhe në rritjen e vetëdijes, përfshirë edhe atë lidhur me detyrat e zyrtarëve publikë për zbatimin e legjislacionit përkatës i cili mbron të drejtat e personave LGBT.

4) Situata politike

Ky seksion trajton përfaqësimin e grave, pjesëmarrjen dhe mundësitë për të ndikuar në proceset e vendimmarrjes në nivel kombëtar, komunal dhe të partive politike. Ky po ashtu vlerëson kapacitetin e qeverisë për të krijuar një ambient më të mirë për pjesëmarrjen e grave në politikë dhe për ofrimin e shërbimeve pa diskriminim gjinor.

Korniza ligjore

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligji për Zgjedhjet Lokale në Kosovë përfshijnë kuotën prej 30% të pjesëmarrjes së grave dhe burrave në kuvendin kombëtar, përkatësisht në kuvendet komunale. Kjo nuk është e harmonizuar me LBGJ-në, i cili bën thirrje për një përfaqësim

Treguesit e pjesëmarrjes politike (me 2014 përveç nëse shënohet ndryshe)	F	M
Presidentë/e (ndonjëherë)	1	5
Kryeministra/e (ndonjëherë)	0	6
Zëvendëskryeministra/e	1	4
Ministra/e	1	17
Zëvendësministra/e	1	34
Misione jashtë vendit[1]	6	16
Anëtarë/e të Kuvendit Kombëtar	40	80
Kryesues/e të komisioneve të kuvendit	1	8
Kryetarë/e të komunave	1	32
Drejtorë/esha të drejtorive komunale[2]	14 *4.4%*	301 *94.6%*
Anëtarë/e të kuvendeve komunale[3]	34%	66%
Shërbimi civil[4]	38%	60%

prej 40% të secilës gjini. Ende vazhdon debati lidhur me kuotën. Ka shqetësime se sasia nuk nënkupton edhe cilësi.[5] Gratë jo gjithmonë i përfaqësojnë "interesat e grave" ose punojnë për barazi gjinore. Megjithatë, burrat që janë anëtarë të kuvendeve kanë përgjegjësi për të ngritur në mënyrë të njëjtë prioritetet e votuesve të tyre femra dhe meshkuj. Përkundër diskutimit për ndërprerjen e aplikimit të kuotës, gratë akoma janë të prira ta mbështesin atë.[6] Votimet e deritanishme tregojnë se heqja e kuotës do të rezultonte me një nën-përfaqësim të grave. Kuota duket se kontribuon që gratë të shihen si politikane dhe që të zgjidhen në pozita vendimmarrëse (pa kuotë).

"Kuota po i ndihmon burrat të kuptojnë se ku jetojmë dhe çka po kërkojmë; burrat po edukohen si rezultat i kuotës."
- Përfaqësues partiak (burrë)

Gratë nga grupet etnike pakicë kanë shprehur shqetësimin se kuotat për përfaqësimin e grupeve etnike pakicë në parlamentin e Kosovës nuk e përfshijnë kuotën gjinore. Grupeve të pakicave u garantohen ulëset në parlament,[7] por zakonisht ato plotësohen nga burrat. Gratë e pakicave "në masë të madhe janë lënë anash" në proceset e vendimmarrjes dhe nevojat e tyre merren shumë pak parasysh.[8]

Qarkorja e buxhetit e lëshuar nga Ministria e Financave parasheh pjesëmarrjen e qytetarëve në shqyrtimin e buxheteve komunale dhe të atij kombëtar, edhe pse ka munguar debati demokratik lidhur me buxhetin.[9] Sa i përket LBGJ-së, ABGJ-ja duhet të shqyrtojë buxhetin (si ligj) por asaj i kanë munguar burimet e mjaftueshme njerëzore dhe ekspertiza.

"Burrave me vullnet të mirë u mungon aftësia për të parë çështjet gjinore."
- Përfaqësues i partisë politike

Pjesëmarrja e pabarabartë e grave në politikë mund të jetë pjesërisht për shkak të normave shoqërore, sipas të cilave 49.1% e grave besojnë se "familja është më e rëndësishme se karriera në politikë" dhe 58.2% se burrat janë më të përgatitur për orare të gjata të punës që i kërkon politika.[10] Pothuaj një e pesta e grave në Kosovë nuk kanë njohuri për politikën dhe udhëheqësit politikë (përqindja e meshkujve nuk dihet).[11]

Barazia gjinore në nivel kombëtar

Në vitin 2011, presidentja Atifete Jahjaga u bë gruaja e parë presidente e Kosovës (edhe pse me nominim). Disa mendojnë se ajo paraqet shembull pozitiv për udhëheqëset e ardhshme (femra).[12]Gratë mbeten të nën-përfaqësuara në radhët e ministrave, zëvendësministrave dhe kryesuesve të komisioneve të kuvendit (shih Tabelën).[13] Gratë mbajnë 33.3% të ulëseve në Kuvendin e Kosovës (40 nga 120 ulëse); 14 gra janë zgjedhur, ndërsa kuota ka mundësuar që 24 gra të tjera të fitojnë vendet e tyre.[14] Gratë janë të nën-përfaqësuara në Kryesinë e Kuvendit (0%), në Komisionin për Punë të Jashtme (11%), në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor (23%), në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës (23%), në Komisionin për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës (11%), dhe në Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike (11%). Burrat janë të nën-përfaqësuar në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione (12%).[15] Gratë janë të nën-përfaqësuara në Ministrinë e Infrastrukturës (25%) dhe të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (27%), respektivisht. Nuk janë bërë sa duhet hulumtime që e trajtojnë cilësinë e punës së kuvendit dhe ministrive nga perspektiva gjinore.

"Vajzat e vogla e shohin atë në TV dhe besojnë se një ditë edhe ato mund të bëhen presidente."
- Një e intervistuar

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk jep të dhëna lidhur me numrin e votuesve femra dhe meshkuj. Raportet tregojnë se ka votime familjare.[16] Shumë pak politikanë kanë mekanizma për tu konsultuar dhe për të marrë shqetësimet e zgjedhësve.[17] Disa politikane (F) kanë mbajtur takime në grupe të fokusuara për tema të caktuara (p.sh., për dhunën seksuale gjatë luftës, dhunën në familje, shkollimin).[18]

Barazia gjinore në nivel komunal

Kuota prej 30% për përfaqësimin e grave dhe burrave ka kontribuar për të siguruar që gratë të përbëjnë të paktën 30% të të gjitha kuvendeve komunale.[19] Në aspektin sasior pjesëmarrja e grave është rritur që nga zgjedhjet komunale të nëntorit 2013. Përderisa në zgjedhjet e vitit 2007, 16 gra kanë marrë vota të mjaftueshme për ulëse në kuvendet komunale pa ndihmën e kuotës,[20] përafërsisht 51 gra kanë marrë vota të

"Grave u duhen modele si kryetarja e Gjakovës. Ajo është brilante."
- Një e intervistuar

mjaftueshme në vitin 2013.[21] Si rezultat, pjesëmarrja e grave është rritur nga 30% në përafërsisht 34% të ulëseve.[22] Për më tepër, për herë të parë në Kosovë një grua e fitoi pozitën e kryetares së komunës në Gjakovë. Tani një grua është kryesuese e kuvendit komunal në Gjilan, megjithatë, gratë janë dukshëm të nën-përfaqësuara në pozita vendimmarrëse në komuna, duke udhëhequr vetëm 14 drejtori në tërë Kosovën (4.4%).[23] Gratë po ashtu janë të nën-përfaqësuara në komisionet për politikë dhe financa.[24]

Në zgjedhjet e vitit 2013, vlerësohet se kanë votuar 5% më shumë gra se sa burra.[25] Megjithatë, gratë kishin më shumë mundësi se sa burrat që të mos kishin informata për zgjedhjet, veçanërisht gratë e moshuara dhe gratë në zonat rurale.[26] Gratë zakonisht kishin më pak njohuri për mekanizmat e ankesës dhe ishin të nën-përfaqësuara në radhët e anëtarëve të komisioneve të vendvotimeve dhe administratorëve të zgjedhjeve.[27] Mekanizmat për të konsultuar dhe përfshirë qytetarët në vendimmarrje në komuna duket se janë të kufizuar. Gratë në nivelin komunal thanë se ka mundësi që partitë politike i diskutojnë me to çështjet para zgjedhjeve, por jo pas tyre.[28] Disa komuna i kanë përfshirë gratë dhe burrat më shumë se sa disa komuna të tjera. Ka shembuj se anëtarët e kuvendeve komunale kanë mbajtur takime me gratë.[29] Përfaqësuesit e OSHC-ve zakonisht marrin pjesë në grupet punuese për hartimin e ligjeve dhe politikave në nivele të ndryshme. Ata deri diku kanë pasur ndikim në politikat dhe buxhetin lokal.[30] Disa zyrtarë komunalë janë trajnuar në buxhetimin që i përgjigjet gjinive,[31] por zbatimi i tij duket se është i ndryshëm.

> "Ne ishim dëshmitarë kur zyrtarët u thoshin grave se nuk dinin si të votonin, kështu që duhej të votonin me burrat e tyre."
> - Vëzhgues i zgjedhjeve

Barazia gjinore në partitë kryesore politike

Partitë kryesore politike dallojnë sa i përket përfshirjes së grave në vendimmarrje dhe shkallës me të cilën ato i adresojnë pabarazitë gjinore në kuadër të platformave të tyre partiake.[35] Në Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), duket se gratë janë pak të përfshira në vendimmarrje. Në platformën e saj, PDK përmend gratë dhe burrat vetëm në lidhje me kuotën zgjedhore.[36] Personat e intervistuar theksuan se "kultura" brenda PDK-së është veçanërisht problematike, posaçërisht "rrethi i saj i brendshëm", i cili rrallë i përfshin gratë.

Pozita / Partitë kryesore	PDK[32]		LDK		AAK		AKR		VV	
Gjinia	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M
Kryesues i partisë/Kryetar	0	1	0	1	0	1	0	1	0	1
Zëvendëskryetar i Partisë	0	3[33]	1	2	1	4	1	2	1	0
Sekretarë[34]	0	3	0	1	0	2	3	1		
Zëdhënës							1	0		
Kryesues i grupit parlamentar	0	1	0	1	0	1	1	0	0	1
Kryetarë të degëve			0	37			2	31		
Anëtarë të kryesisë			3	14					3	12

Pasi e përmend përkushtimin e përgjithshëm për barazi gjinore, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në platformën e saj shpesh i referohet "meshkujve dhe femrave" në lidhje me veprimin afirmativ, qasjen në arsimim dhe punë dhe në pozitat vendimmarrëse.[37] Ato krijojnë një standard specifik për përfshirjen e pjesëmarrjes prej 20% të grave dhe të rinjve në të gjitha nivelet e partisë para zgjedhjeve të ardhshme të brendshme më 2014,[38] kryesisht si strategji për rritjen e anëtarësisë dhe për sigurimin e më shumë votave. Ata po ashtu propozojnë eliminimin e pengesave për pjesëmarrjen e grave në tregun e punës dhe besojnë se promovimi i sipërmarrësisë së grave mund të ndihmojë në adresimin e varfërisë, papunësisë dhe varësisë nga ndihma sociale.[39]

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) e ka kuotën prej 20% për pjesëmarrjen e grave në të gjitha strukturat e partisë.[40] Megjithatë, gratë anëtare të partisë thanë se nuk marrin pjesë në mënyrë adekuate në vendimmarrje.[41] Në programin e saj, AAK-ja thekson se "avancimi i statusit të grave në të gjitha sferat e jetës është objektiv i rëndësishëm." Partia premton të zbatojë ligjet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe të avancojë "mekanizmat ligjorë në përputhje me rezolutat evropiane." AAK bën thirrje për "mundësi të barabarta për burrat dhe gratë në familje dhe në vendin e punës" dhe i përmend gratë kur flet për "përfshirjen dhe progresin shoqëror."[42]

Aleanca Kosova e Re (AKR) përfshinë në platformën e saj "Emërimin e një këshilltareje të stafit në kuadër të stafit të ngushtë të Presidentit e cila do të hartojë politikat, projektet dhe do të promovojë të drejtat e grave dhe përmirësimin e rolit të tyre në shoqëri"; "prioritet i veçantë do t'i jepet punësimit të grave, rinisë dhe personave me aftësi të kufizuara"; dhe "një pjesë e madhe e stafit të lartë të komunave, përfshirë edhe udhëheqësit e drejtorive, do të jenë gra dhe të rinj."[43] Kryetarja e vetme e komunës në Kosovë është nga AKR; dy nga njëmbëdhjetë drejtorët e drejtorive që janë

emëruar aktualisht nga ajo janë gra (18%).

Vetëvendosje (VV) është e përkushtuar që të fuqizojë pjesëmarrjen e shoqatave të grave në vendimmarrje, barazinë gjinore në qasjen në arsim, barazinë gjinore si të drejtë të përcaktuar në traktatet ndërkombëtare dhe evropiane, dhe barazinë.[44] VV është përpjekur të decentralizojë vendimmarrjen, por e kupton se mund të bëhet më shumë në këtë aspekt.[45]

> "Sfida ime më e madhe është mungesa e mjeteve financiare. ... Ligjërisht partitë nuk mund të përkrahen [nga donatorët]. Paradoksi i mosekzistimit të rrugëve ligjore për stimulimin financiar të grave udhëheqëse të partive dhe grave në politikë, krijon një paradoks tjetër: si të krijohen politikane ose udhëheqëse partish (F) nëse nuk stimulohen me veprime afirmative?"
> - Zëvendëskryeministrja Edita Tahiri

Politikanet (F) ankohen se partitë politike ofrojnë financim të kufizuar (nëse ofrojnë fare) për fushatat zgjedhore të kandidateve (F), gjë që dëmton mundësinë e tyre për të siguruar vota.[46] Përfaqësuesit e partive theksojnë se të gjithë kandidatët (me përjashtim të kryetarëve të disa partive) marrin shumën e njëjtë. Megjithatë, në disa parti kandidatët individualë mund të kenë burimet e tyre. VV-ja ua ndalon kandidatëve individualë të mbledhin para për vete, pasi që kjo mund t'i kontribuojë pabarazisë.[47]

Një "rrjet i të vjetërve" brenda dhe ndër partitë politike duket se ndikon në shumicën e vendimeve kyçe në Kosovë, gratë rrallë kanë qasje në hapësirat ku merren vendimet.[48] Përafërsisht 32% e grave besojnë se "partitë politike nuk u japin mundësi grave [sic]."[49] Shumica e partive politike janë të prira të marrin vendimet pa respektuar proceset e nevojshme demokratike që i përforcojnë ato vendime.[50] Ndonëse gratë (dhe burrat) shpesh përcjellin vijën partiake, ka disa shembuj të njohur të grave parlamentare që nuk janë pajtuar me partitë e tyre.[51] Ka pasur një progres në atë se të gjitha partitë, përveç PDK-së, e kanë nga një grua si zëvendëskryetare dhe e kanë kuotën për pjesëmarrje të grave.[52]

> "Në parti nuk ka rëndësi nëse je burrë apo grua; krejt ka të bëj me politikë."

Ndonëse partitë politike duket se kanë disa mënyra përmes të cilave qytetarët mund të japin kontributin e tyre (p.sh., takimet e partisë me anëtarët, konsultimet për programet zgjedhore, kongreset), partitë politike e pranojnë se në takime marrin pjesë kryesisht meshkujt.[53] Për dallim, gratë janë ato që zakonisht diskutojnë më shpesh se burrat për çështjet si kujdesi shëndetësor ose mjedisi.[54] Partitë nuk kanë strategji specifike për të komunikuar me gratë dhe burrat (p.sh., duke marrë parasysh mjetet e ndryshme të mundshme të komunikimit) rreth takimeve për rritjen e pjesëmarrjes.[55] As partitë nuk janë të prira të vlerësojnë se si politikat e propozuara ose të zbatuara ndikojnë ndryshe te gratë dhe burrat.[56]

Barazia gjinore në shërbimet publike

Nga 70,326 nëpunës publikë të Kosovës, 38% janë gra.[57] Megjithatë, gratë përbëjnë vetëm 9.5% të nëpunësve në pozita të larta vendimmarrëse (p.sh., në pozitën e sekretarit të përgjithshëm ose kryeshefit ekzekutiv) dhe 23.2% të pozitave të tjera vendimmarrëse.[58] Në komuna, gratë përbëjnë vetëm 15.26% të pozitave vendimmarrëse.[59] Për të njëjtat pozita në administratën publike të Kosovës, gratë duhet të kenë arsimim më të lartë se sa burrat.[60] Gratë janë përballur me diskriminim në praktikat e punësimit dhe largimit nga puna në administratën publike.[61] Qeveria ka bërë përpjekje të adresojë këtë duke ofruar bursa për nëpunëset civile (femra) që të arrijnë nivele më të larta të arsimimit, por shumë pak prej tyre kanë aplikuar ose i kanë përmbushur kriteret minimale, kështu që ato fonde nuk janë shpenzuar.[62] Nën-përfaqësimi i grave në shërbimin civil mund të ndikojë në shkallën në të cilën shërbimet publike i përmbushin nevojat e ndryshme potenciale të grave dhe burrave, edhe pse asnjë nuk dihet se ka ndonjë hulumtim që ka analizuar këtë. Në lidhje me ofrimin e shërbimeve, institucioneve u mungon njohuria se si të përfshihen gjinitë në planifikim, buxhetim, ofrim, monitorim dhe vlerësim të shërbimeve të tyre.

Ofrimi i shërbimeve publike vazhdon të jetë i politizuar, duke u varur në masë të madhe nga prioritetet qeveritare të zbatuara nga MEF. Investimet kapitale (d.m.th, ndërtimi i autostradave) përbën më shumë se 40% të buxhetit vjetor të Kosovës. Duke ju referuar si "politikë e asfaltit", prioritetet aktuale të qeverisë janë kritikuar se kanë dëmtuar nevojat themelore të popullsisë, siç është kujdesi shëndetësor, arsimi dhe mirëqenia sociale.[63] Për shembull, MPMS e ka mandatin ligjor që të ofrojë më shumë shërbime, por buxheti i saj nuk është rritur sa duhet për të financuar këto shërbime. Mungesa e shërbimeve të mjaftueshme shtetërore mund të ndikojë në mungesën jo-proporcionale të qasjes së

grave në shërbime publike.[64] Megjithatë, ka hulumtime të pamjaftueshme që e kanë analizuar qasjen në shërbime publike nga perspektiva gjinore.

Sfidat dhe mundësitë

Gratë vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuara në nivel kombëtar dhe komunal, si dhe në partitë politike. Kjo është veçanërisht e vërtetë për gratë e grupeve të pakicave dhe gratë me aftësi të kufizuara. Shumica e vendimeve merren nga udhëheqësit meshkuj të partive politike dhe në shumicën e partive nuk ekzistojnë procese vendimmarrëse demokratike. Përderisa disa parti e trajtojnë më shumë çështjen gjinore në platformat e tyre, të gjitha mund të përmirësojnë përfshirjen gjinore. Prioritetet e qeverisë që kanë të bëjnë me investimet në infrastrukturë dëmtojnë qasjen në shërbime publike cilësore, veçanërisht për gratë. MEF-i duhet të hartojë udhëzime më të qarta për buxhetimin që i përgjigjet gjinive në kuadër të qarkores buxhetore. Zyrtarët për barazi gjinore mund të japin kontributin e tyre në strategjitë e komunikimit dhe njoftimit për takimet publike për të siguruar pjesëmarrjen e grave dhe burrave. Mund të ketë më shumë iniciativa për të punuar me burrat në parti politike, në kuvende, në ministri dhe në komuna për t'i mbështetur ato në përfshirjen gjinore. Ndryshimi i normave shoqërore në të cilat gratë zakonisht rrinë në shtëpi ndërsa burrat dalin mund të përmirësojë pjesëmarrjen e grave në politikë. Krijimi i qendrave të kujdesit ditor për fëmijët do tu mundësojë grave të hyjnë në jetën publike. Edhe mediat mund të luajnë rol të rëndësishëm në paraqitjen e më shumë grave eksperte në role gjinore jo-stereotipe.[65] Krijimi i aleancave ndërmjet ish anëtareve të kuvendit dhe grave që nuk janë rizgjedhur mund të kontribuojë në mbajtjen e nivelit të njohurive dhe aleancave për politikat me interes të përbashkët (p.sh, përmes mentorimit). Grupet e avokimit për barazi gjinore nëpër komuna mund të vazhdojnë të bëjnë bashkë gratë e politikës dhe të shoqërisë civile në rrjete mbështetëse drejt avancimit të barazisë gjinore. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe forumet që analizojnë zgjedhjet duhet të përfshijnë në raportet e tyre të dhënat e ndara sipas gjinive.

5) Situata socio-ekonomike

Ky seksion trajton varfërinë, ekonominë (formale dhe joformale), marrëdhëniet brenda ekonomisë familjare dhe ofrimin, qasjen dhe shfrytëzimin e shërbimeve dhe resurseve nga perspektiva gjinore. Ai po ashtu përfshin një analizë të shkurtër të shërbimeve sociale (p.sh., shëndetësia dhe arsimi).

Statistikat socio-ekonomike	Burra	Gra
Regjistrimi në arsimin fillor[1]	95%	96%
Regjistrimi në arsimin mesëm të lartë[2]	96%	88%
Braktisja e shkollës së mesme	71%	29%
Regjistrimi në arsimin terciar (femrat dominojnë në drejtimet: edukim, filozofi, filologji; meshkujt dominojnë në ndërtimtari, arkitekturë, inxhinieri mekanike; balancë gjinore ka në juridik, ekonomik dhe mjekësi)[3]	19000 (55%)	17000 (45%)
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore 2012[4]	55%	17.8%
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore 2009[5]	68%	29%
Papunësia[6]	28%	40%
Papunësia tek të rinjtë[7]	52%	63.8%
Të rinjtë që nuk janë as në punë, as në shkollë e as në trajnime (NEET) 15-24 vjeç[8]	31%	40%
Pronarë të bizneseve[9]	91.8%	8.2%
Të ardhurat neto nga biznesi vetanak[10]	92%	8%
Dallimi i pagës sipas gjinive	N/A	N/A
Llogaritë në institucionet financiare formale[11]	57%	31%

Rolet e gjinive në ekonominë formale

Në ekonominë formale në Kosovë ka një pjesëmarrje më të madhe të burrave se grave. Shkalla e punësimit të grave është përafërsisht 18%, më e ulëta në Evropë, përderisa rreth 55% të meshkujve janë të punësuar.[12] Gratë janë të prira të punojnë në sektorët që paguhen më pak, siç janë shëndetësia dhe arsimi (rreth 40% e të gjitha grave në tregun e punës), ndërsa meshkujt punojnë në energji dhe ndërtimtari, të cilat paguhen më mirë.[13] Burime të ndryshme thonë se gratë janë pronare të 5-11% të bizneseve në Kosovë. Pastaj, 99.9% e bizneseve që janë në pronësi të grave janë mikro-ndërmarrje, që kanë prej 1 – 9 punëtorë; bizneset e grave kanë mesatarisht nga 3.07 punëtorë, krahasuar me bizneset që udhëhiqen nga burrat që kanë nga 5.27 punëtorë.[14] Gratë nuk mund të kenë qasje në kredi dhe hua sikurse burrat, sepse atyre u mungon kolaterali (shih seksionin 3), historia e kreditimit dhe lidhjet.[15] Kështu, burrat kanë rreth 92% të pronës

> "Gratë dhe burrat janë njëjtë për administratën tatimore, përderisa i paguajnë tatimet."
> - Administrata tatimore

që përdoret si kolateral në Kosovë.[16] Vetëm 3% e kredive të bankave komerciale u jepen grave.[17] Gratë po ashtu e kanë përqindjen më të lartë të kredive të refuzuara. Gratë afariste si probleme kyçe i identifikojnë: mungesën e qasjes në financa,[18] rregulloret e pamjaftueshme tatimore, praktikat e këqija bankare, diskriminimi nga klientët, dhe në përgjithësi, klima e dobët e investimeve në Kosovë.[19] Megjithatë, tatimet në Kosovë janë shumë të ulëta krahasuar me vendet e tjera në Evropë; TVSH-ja është 16% dhe tatimi në të ardhura sillet nga 6% deri në 10%.[20]

Ekstremizmi fetar ndikon në ekonominë formale me fonde dhe me tradita që inkurajojnë rolet e grave në kuadër të familjes dhe me fëmijët, e jo në tregun e punës.[21]

Rolet e grave dhe burrave në ekonominë joformale

Përderisa Kosova nuk ka të dhëna lidhur me ketë, në Serbi vlerësohet se 7% e popullsisë punon në sektorin joformal, ndërsa në Moldavi 16%. Kështu, në Kosovë sektori joformal ka mundësi të përbëj përafërsisht 10% të ekonomisë, dhe shumica e njerëzve që janë të përfshirë ka mundësi të jenë gra. Pushimi i lehonisë sipas Ligjit të ri të Punës mund të kontribuojë në mbi-përfaqësimin e grave në punën joformale.[22] Në vendet në zhvillim, vlerësohet se rreth 80% e njerëzve që punojnë në sektorin joformal janë gra.[23] Në Evropë vlerësohet se mbi gjysma e popullsisë në sektorin joformal janë gra dhe me siguri janë rreth 60-65%.[24] Rreth 60% e tyre punojnë me pagë ndërsa rreth 40% janë të vetëpunësuar. Në Kosovë, shumë gra i shesin produktet si specat, ushqimet e përpunuara, dhe produktet artizanale. Gratë po ashtu ofrojnë shërbime si shërbimet shtëpiake, përkujdesje për fëmijët dhe floktari.[25] Burrat janë të mbi-përfaqësuar në mesin e personave të përfshirë në ekonominë joformale të prodhimit dhe trafikimit të drogës, duke përbërë 96.4% të personave të arrestuar për përfshirje në këtë "biznes".[26] Autoriteti tatimor e ka luftuar ekonominë joformale dhe i ka shtyrë shumë biznese të formalizohen, shumica e këtyre bizneseve kanë qenë të udhëhequra nga gratë.[27] Sa i përket punës së fëmijëve, djemtë fillojnë të punojnë në moshë më të re dhe punojnë më shumë orë se sa vajzat, por kanë më shumë gjasa që të kompensohen për punën e tyre.[28] Vajzat që punojnë kanë më pak gjasa të vijojnë shkollimin dhe zakonisht punojnë në kushte më të vështira (p.sh, natën, në rrugë).

Situata e varfërisë nga perspektiva gjinore

Në vitin 2011, është vlerësuar se rreth 30% e njerëzve në Kosovë jetonin në varfëri dhe 10% në varfëri të skajshme; pjesa më e varfër jetonte në zonat rurale (65%).[29] Numri i grave që jetojnë në varfëri (30.3% e grave) është pak më i lartë se sa i burrave (29.2%). Familjet me kryefamiljare (F) duket se kanë shkallë më të lartë të varfërisë se sa familjet me kryefamiljar (M) (39.8% krahasuar me 29%).[30] Megjithatë, fëmijët në familjet me kryefamiljare (F) duket se kanë më pak gjasa të jetojnë në varfëri: familjet e tilla zakonisht mbështeten në paratë e dërguara prej jashtë Kosovës (remitencat).[31]

> "Ne e dimë se ulja e dallimit gjinor në punë mund të sjell përfitime të mëdha në zhvillim: përmirësim të shëndetit dhe arsimimit të fëmijës, ulje të varfërisë, dhe përshpejtim të produktivitetit … Sot, shumë më shumë vajza po shkojnë në shkollë dhe po jetojnë jetë më të gjatë dhe më të shëndoshë se sa para 10 vitesh. Por kjo nuk është përkthyer në përfitime më të gjëra. Shumë grave akoma u mungojnë liritë dhe mundësitë themelore dhe përballen me pabarazi shumë të mëdha në botën e punës." - Kryetari i grupit të BB-së Jim Yong Kim, 2014

Momentalisht nuk ekziston ndonjë Plan për uljen e shkallës së varfërisë në Kosovë, edhe pse shumica e vendeve të rajonit e kanë një plan të tillë. Raporti i ri i Bankës Botërore (BB) thekson nevojën për veprime të koordinuara për avancimin e mundësive të barabarta për gratë në punë, siç është adresimi i paragjykimeve gjinore, përmirësimi i qasjes së grave në pronë dhe financa, dhe rritja e moshës ligjore të pensionimit: gjëra këto që mund të sjellin përfitime të mëdha në adresimin e varfërisë.[32] Globalizimi dhe liberalizimi i tregtisë e rrit qarkullimin mallrave dhe kapitalit në vendet e ndryshme dhe po ashtu i kontribuon zhvillimin ekonomik. Zhvillimi i bujqësisë e zvogëlon varfërinë dhe përmirëson sigurinë e ushqimit. Për dalim nga kjo, rritja e shpejtë e cila e zgjeron pabarazinë në të ardhura, e cila ka ndodhur gjatë dy dekadave të kaluara, më shumë i dëmton të varfrit. Gratë preken në mënyrë jo-proporcionale nga rritja e pabarazisë sepse ato zakonisht fitojnë paga më të ulëta dhe kanë nivel më të ulët të shkollimit, më pak aftësi dhe më pak lëvizshmëri se sa meshkujt.[33]

Gratë përbëjnë 82.2% të njerëzve joaktivë në tregun e punës.[34] Gratë kujdesen për fëmijët, të sëmurët, dhe të moshuarit (39.4%); janë duke u arsimuar ose trajnuar (15.8%); ose nuk besojnë se do të ketë vend pune për to (14.6%).[35] Personat me aftësi të kufizuara marrin vetëm 40 euro në muaj dhe

kanë shumë pak qasje në tregun e punës. Kur është fjala për praktikën, personat me aftësi të kufizuara mendojnë se ata nuk përfshihen sepse punëdhënësve do t'iu duhet të modifikonin vendet e tyre të punës.[36] Pensioni bazë për qytetarët e moshuar është 45 euro dhe ndihma sociale zakonisht është 40 euro; njerëzit e prekur nga lufta dhe dëshmorët marrin shumë më shumë.[37] Personat që janë të varur vetëm nga pensionet zakonisht jetojnë nën kufirin e varfërisë.[38]

Përfshirja në tregun e punës përmes punësimit dhe bizneseve fillestare

Në MPMS nuk ekziston kurrfarë plani për punësim dhe ministria po has në vështirësi që të përmbush mandatin e saj pasi që MEF-ja nuk po e aprovon buxhetin e kërkuar të saj.[39] Zhvillimi i infrastrukturës publike, përfshirë rrugët, hekurudhat, furnizimit me energji dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, kanë qenë aktivitetet kryesore të qeverisë që pritej të ndikonin pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe në punësim, kryesisht të meshkujve, në sektorin e ndërtimtarisë. ABGJ ka krijuar një strategji për Fuqizimin Ekonomik të Grave për 2011-2013, por të cilës nuk i ishte ndarë fare buxhet dhe e cila nuk është zbatuar.[40] ABGJ planifikon të vazhdojë përpjekjet për zbatimin e saj. Aktivitetet nuk janë monitoruar si duhet dhe ministritë përgjegjëse nuk kanë raportuar për to. G-7, një rrjet i grave të suksesshme afariste, ka krijuar një Odë Ekonomike të Grave.

Diaspora është duke bërë ca investime në Kosovë, kryesisht në ndërtime, pasuri të paluajtshme dhe bujqësi. Në dy të tretat e rasteve, remitencat shkojnë nga një burrë te tjetri.[41] Pak mbi 20% e familjeve marrin remitenca. Për shembull zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë përgjatë lumit Ibër, pjesërisht i financuar nga diaspora, do të krijojë vende pune për gratë, ku janë planifikuar të punësohen 4,500 punëtorë. Një fabrikë industriale e kërpudhave e financuar nga Japonia do të punësojë 3,000 persona.

Nuk ka ndonjë shërbim të veçantë për integrimin e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës.[42] Papunësia është shumë e madhe te romët, ashkalitë dhe egjiptianët.[43] Ata do kishin dëshirë të shihnin më shumë konkurse të punës ku ata do të ishin të mirëseardhur të aplikonin si dhe programe të veçanta të praktikës për të fituar përvojë të punës.

Marrëdhëniet brenda familjeve

> "Ne [gratë] gjithmonë i mbrojmë burrat dhe sjelljen e tyre." - Një e intervistuar

Gratë zakonisht marrin shumicën e përgjegjësive për familjen, përfshirë edhe kujdesin për fëmijët, të moshuarit dhe të tjerët që kanë nevoja të veçanta, si dhe për mirëmbajtjen e shtëpisë. Burrat zakonisht punojnë jashtë shtëpisë. Gratë e grupmoshës 25-54 vjeçare e kalojnë 10-20% të kohës së tyre në punë jashtë familjes, dhe 80% të kohës së tyre në punët e shtëpisë. Burrat e kalojnë 50-80% të kohës së tyre në punë jashtë shtëpisë dhe rreth 10-15% në shtëpi.[44] Meqë gratë zakonisht bëjnë më shumë punët e shtëpisë, ato edhe kanë më pak resurse, pasi që kjo punë nuk paguhet.[45]

Arsimimi

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve e qeverisë promovon fuqizimin e kapitalit njerëzor. Shkalla e shkollimit, veçanërisht e të rinjve, është përmirësuar nga viti 2003.[46] Ekziston një perceptim se shkollën e mesme e braktisin më shumë vajzat se sa djemtë.[47] Megjithatë, statistikat tregojnë se gjendja ka ndryshuar, derisa në vitin 2009 shkollimin e kishin braktisur më shumë vajzat, pas kësaj djemtë filluan të braktisnin më shumë shkollimin.[48] Më shumë se 70% e atyre që e braktisin shkollimin janë djem.[49] Shkollat profesionale duken të ndara sipas profesioneve stereotipe për vajzat dhe djemtë, pa ndonjë synim të institucioneve që të thyejnë këto stereotipa. Djemve u ofrohen më shumë kurse në shkollat profesionale (71%) se sa vajzave (29%).[50] Gratë zakonisht nuk marrin pjesë në kështillat e prindërve.[51]

> "'Nëse shkoni në universitet dhe e përfundoni atë, ku shkoni pastaj,' pyesin prindërit. 'Nuk ka vende pune për personat me aftësi të kufizuara.'"
> - Person me aftësi të kufizuar

Vajzat dhe gratë rome, ashkali dhe egjiptiane kanë nivelet më të ulëta të arsimimit, shpesh për shkak të mësimdhënësve jo të mjaftueshëm nga grupi i tyre etnik, mungesës së teksteve shkollore, dhunës dhe diskriminimit në shkollë, shqetësimeve të sigurisë, financave të pamjaftueshme të familjeve, detyrave për tu përkujdesur për shtëpinë dhe martesës së hershme.[52] Përderisa ekziston programi për tri lëndë në gjuhën rome (gjuha rome, historia rome dhe arti dhe kultura rome), qeveria nuk ka fonde për shtypjen e teksteve

shkollore, për punësimin ose trajnimin e mësimdhënësve.[53] Vajzat me aftësi të kufizuara nuk kanë qasje në shkollim, pasi që prindërit zakonisht i izolojnë ato në shtëpi.[54]

Shëndeti

Përderisa për momentin nuk ekziston sigurimi shëndetësor publik, ai është duke u krijuar dhe do të jetë në dispozicion tatimpaguesve brenda vitit.[55] Nuk ekziston asnjë shërbim për njerëzit që vuajnë nga kanceri (qofshin gra ose burra). Lesbiket raportojnë diskriminim në qasjen në kujdesin shëndetësor, përfshirë edhe trajtimin paragjykues nga mjekët ose psikologët të cilëve u mungojnë informacione për lesbianizmin.[56] Meshkujt zakonisht marrin drogën përmes injektimit (85% e përdoruesve), Kanabisin dhe alkoolin më shumë se sa gratë.[57] Të rinjtë (49.1% e meshkujve) kanë më shumë gjasa që të fillojnë pirjen e duhanit se sa të rejat (38%); të rinjtë po ashtu pinë më shumë duhan se sa të rejat (mesatarisht 15.6 cigare në ditë krahasuar me 9.8). Shumë pak hulumtime kanë analizuar qasjen e grave dhe burrave në kujdes shëndetësor cilësor.[58]

Sfidat dhe mundësitë

Duke qenë shtyllë e zhvillimit ekonomik, institucionet që **përkujdesen për fëmijët** u mundësojnë grave të marrin pjesë në tregun e punës. Qendrat e përkujdesjes për fëmijët po ashtu krijojnë vende pune. Qendrat mund të ofrojnë trajnim gjithëpërfshirës për barazinë gjinore për fëmijët e vegjël. **Linjat e kreditimit** për gratë mund të ndihmojnë në ndërkohë në mënjanimin e mungesës së qasjes në kolateral dhe në të drejta pronësore. Institucionet e kreditimit duhet të trajnohen për rëndësinë që kanë bizneset e udhëhequra nga gratë për tregun dhe për zhvillimin shoqëror. **Vetëdijesimi për barazinë gjinore dhe mos-diskriminimin**, si në aspektin sasior brenda kompanisë (horizontal) ashtu edhe në pozitat menaxhuese (vertikal), është me rëndësi në të gjitha institucionet, organizatat dhe kompanitë. Secili vend i punës duhet të vlerësohet individualisht se si e adreson mos-diskriminimin dhe barazinë gjinore. Të gjitha gratë dhe burrat duhet të ndjehen të mirëseardhur dhe çmuar pavarësisht gjinisë, përkatësisë etnike, moshës, orientimit seksual, fesë ose aftësisë së kufizuar. Nevojat specifike të secilit mund të vihen në pah dhe të merren parasysh. Duke marrë parasysh shkallën e papunësisë në Kosovë hartimi dhe përfundimi i një **plani gjithëpërfshirës kombëtar të punësimit** është me rëndësi. Duhet të bëhet një hulumtim i mëtejshëm lidhur me rolet e gjinive në ekonominë joformale në Kosovë.Planet e zhvillimit të biznesit mund të zhvillohen në të gjithë sektorët në secilën komunë ose rajon. Veprimet e koordinuara për avancimin e mundësive të barabarta për gratë në botën e punës, siç është adresimi i hershëm i paragjykimeve gjinore, përmirësimi i qasjes së grave në pronë dhe financa, dhe zgjatja e moshës ligjore të pensionimit, janë masa për **uljen e varfërisë**. Një studim i tregut lokal do të ishte i dobishëm për të mësuar për **nevojat** e tanishme dhe të ardhshme për **punësim**. Trajnimi duhet të bazohet në kërkesë. Kjo u ndihmon punëdhënësve të përshtatin praktikat dhe pritjet e tyre në kontekstin lokal. Sistemi arsimor mund të harmonizojë mundësitë e shkollimit me nevojat e sektorit të biznesit. Sektorët privat, publik, jofitimprurës dhe akademik mund të bashkëpunojnë për të mundësuar hyrjen në treg të grave dhe burrave (përfshirë edhe ata/ato nga grupet e pakicave) duke përdorur lloje të ndryshme të shkollimit dhe trajnimit, përfshirë edhe trajnimin gjatë punës. Aftësitë specifike të punës, shkollimi, numrat, gjuhët, aftësitë profesionale dhe TIK janë të pamjaftueshme. Aftësitë e "buta" janë themelore për të pasur sukses në botën e punës, si aftësia për të ditur se *si* duhet mësuar, si duhet kërkuar vendi i punës, si duhet menaxhuar njerëzit, si duhet punuar si pjesë e ekipit, si duhet folur në publik, si duhet rrjetëzuar dhe si duhet sjellë me vetëbesim. Njerëzit e aftë vendorë e dinë me saktësi se çka i duhet rajonit të tyre; **planet e zhvillimit ekonomik lokal** mund të hartohen në të gjithë sektorët në secilën komunë ose rajon me mbështetjen e sektorit privat, publik, civil ose akademik. Qeveria mund të miratojë vazhdimin e **strategjisë për FEG-në**, përfshirë edhe financimin adekuat. ABGJ duhet të ketë një sistem më të mirë dhe të kompjuterizuar të monitorimit, të lidhur me të gjitha ministritë, për të mundësuar monitorimin e zbatimit të kësaj dhe strategjive të tjera. Sistemet **shëndetësore** duhet të përfshijnë vëmendjen të veçantë për pacientet me kancer, veçanërisht ato me kancer në gji dhe në qafën e mitrës. Kjo mund të zgjerohet për të marrë parasysh edhe skenimin dhe trajtimin për meshkujt (p.sh, kancerin e zorrës së trashë), drejt barazisë gjinore. Kosova ka nevojë për trajtimin e hemoterapisë; për mbështetje psikologjike për personat që vuajnë nga kanceri, për proteza dhe paruke. Personat LGBT, personat me aftësi të kufizuara, ata me sindromën down dhe me autizëm kanë nevojë për trajtim më të mirë duke respektuar të drejtat e tyre të njeriut. Duhet të ofrohet edhe sigurimi shëndetësor.

6) Dhuna në bazë gjinore dhe siguria

Ky seksion identifikon format e dhunës në baza gjinore në Kosovë dhe kornizën ligjore përkatëse (përtej asaj të paraqitur në seksionin 1). Ajo identifikon përpjekjet për parandalimin e dhunës në bazë gjinore, përfshirë edhe vëmendjen në maskulinitetin dhe rolin e meshkujve si partnerë në luftimin e dhunës në bazë gjinore. Ajo po ashtu përshkruan mbrojtjen, ndjekjen penale dhe shërbimet e rehabilitimit/ ri-integrimit që janë në dispozicion.

Treguesit e dhunës në bazë gjinore	F	M	Të gjithë
% e grave dhe burrave që përjetojnë dhunë në familje në jetën e tyre (2008)[1]	46.4%	39.6%	43%
Nr. dhe % e viktimave të dhunës në familje (raportuar në polici, 2013)	869 *80%*	220 *20%*	1089
Viktimat e trafikimit (2013)			52

Dhuna në emër të [mbrojtjes së] nderit

Në raportet e Policisë së Kosovës ka raste të vëllezërve që rrahin motrat për sjellje "të pandershme".[2] Edhe pse janë të rralla, thashethemet tregojnë se vrasjet për mbrojtjen e nderit mund të ndodhin në zonat rurale të Kosovës.[3] Ka informata të pamjaftueshme për ketë temë; kjo mund të jetë një fushë që mund të hulumtohet në të ardhmen.

Dhuna në bazë gjinore gjatë konfliktit

Nuk ka të dhëna të sakta lidhur me numrin e grave dhe burrave që kanë përjetuar dhunë në bazë gjinore gjatë luftës 1998-1999, edhe pse të dhënat cilësore tregojnë se ka pasur dhunë në shkallë të gjerë.[4] Derisa gratë dhe vajzat ishin vënë në shënjestër të dhunës seksuale, burrat dhe djemtë civilë duket se kanë përjetuar forma të tjera të dhunës, përfshirë edhe sulmet dhe vrasjen ("gjinicidin").[5] Dhuna seksuale e shkaktuar kundër burrave dhe djemve mund të ketë ndodhur, por për ketë është diskutuar shumë pak publikisht.[6]

Përkundër udhëzimeve të Kombeve të Bashkuara për rëndësinë e reparacioneve,[7] qeveria e Kosovës ende nuk u ka ofruar reparacione personave që kanë përjetuar një dhunë të tillë. Një raport i kohëve të fundit i OHCHR-së tregon se personat që kanë përjetuar dhunë seksuale vazhdojnë të vuajnë "pasoja të konsiderueshme fizike, psikike, psikologjike, sociale dhe ekonomike" dhe jep rekomandime të qarta për një program të reparacionit.[8] Pas avokimit të shoqërisë civile,[9] kombinuar me përpjekjet e politikanëve (kryesisht gra), Kuvendi kohëve të fundit i miratoi ndryshimet e Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile të Luftës dhe Familjeve të tyre, për të përfshirë edhe gratë që kanë përjetuar dhunën seksuale si mbijetues civilë të luftës.[10] Me mbështetjen e RRGGK-së dhe në konsultim me gratë e mbijetuara, Presidentja e Kosovës e themeloi Këshillin Kombëtar për të adresuar ketë çështje.[11]

Përderisa gratë kishin qasje në disa programe psiko-sociale të shërimit të organizuara nga OJQ-të menjëherë pas luftës, për meshkujt ka pasur shumë pak programe të tilla (një formë kjo e diskriminimit gjinor në programet e pasluftës). Tabutë shoqërore kundër vizitave të psikologëve dhe kufizimet në shërbimet që ishin në dispozicion nënkuptonin se vetëm një pjesë e vogël kishin marrë këshillime për të tejkaluar traumat.[12] Përfshirja e psikologëve meshkuj në punën me meshkujt mund të kontribuojë në uljen e traumave, e ndoshta edhe të shkallës së dhunës në bazë gjinore.[13]

Dhuna seksuale, përfshirë dhunimin

Duka marrë parasysh turpin që lidhet me dhunën seksuale dhe mungesën e njohurive se dhuna seksuale mund të ndodh edhe mes dy bashkëshortëve,[14] përmasa e dhunës seksuale zakonisht është më e madhe se sa numri i rasteve që i raportohen policisë (zero në vitin 2013, dhe një rast i dhunimit). Institucionet janë të trajnuara në mënyrë joadekuate në zbulimin e dhunës seksuale të kryer kundër ish ose bashkëshortëve/eve aktualë.[15] Policia rajonale është përgjegjëse që të hetojë dhunimin dhe të ofrojë menjëherë trajtim mjekësor.[16]

Gjinicidi

Abortimi selektiv, kryesisht i vajzave, është duke vazhduar. Në vitin 2010, djemtë përbënin 53% të lindjeve të gjalla.[17] Burrat kanë më shumë gjasa se gratë që të jenë përdorues dhe/ose të vdesin nga armët e vogla.[18] Ata po ashtu kanë më shumë gjasa që të bëjnë vetëvrasje, edhe pse gratë kanë më

shumë gjasa që të përpiqen të bëjnë vetëvrasje, sipas raporteve të policisë.[19]

Dhuna në familje përfshirë martesën e hershme

Ndonëse ka ardhur koha për një studim tjetër, në anketën për ekonomitë familjare të zhvilluar në tërë Kosovën në vitin 2008, përafërsisht 43% e të intervistuarve kishin përjetuar dhunë në familje në jetën e tyre (46.4% e grave dhe 39.6% e burrave).[20] Gratë, personat në zonat rurale me nivel të ulët të shkollimit, personat që marrin ndihmë sociale, të varfrit, dhe/ose të papunët ka më shumë mundësi që të përjetojnë dhunën.[21] Fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, personat LGBT dhe të moshuarit po ashtu mund të jenë në rrezik më të madh.[22] Prej 1,087 rasteve të dhunës në familje që i janë raportuar policisë në vitin 2013, 80% e viktimave kanë qenë gra. Lëndimet e lehta trupore, sulmet fizike, frikësimi dhe sulmet ishin krimet që u raportuan më së shpeshti në marrëdhëniet në familje. Raportet e policisë tregojnë se 91.1% e kryesve të veprave janë burrat.[23] Shumica e rasteve kanë ndodhur në mes të bashkëshortëve (52.6%) ose prindërit kundër bijve të tyre (12.3%).

Martesa e hershme, e cila i prek në mënyrë jo-proporcionale vajzat, edhe pse rrallë, ende ekziston në Kosovë, veçanërisht duke marrë parasysh regjistrimet e vonuara zyrtare të martesës dhe mekanizmat e dobët institucional për zbatimin e legjislacionit ekzistues.[24] Vajzat në zonat rurale, vajzat e varfra dhe ato nga pakicat mund të jenë më të rrezikuara nga kjo.[25]

Korniza ligjore përkatëse e rishikuar kohëve të fundit, përfshirë këtu Ligjin për Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje, Programin Kombëtar për Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje dhe Procedurat Standarde të Operacioneve (PSO), është mjaft gjithëpërfshirëse dhe cilësia e shërbimeve dhe përgjigja e koordinuar nga institucionet duket se janë përmirësuar viteve të fundit. Ekzistojnë shqetësime lidhur me vendosjen e Koordinatorit Nacional në MD, në vend se të vendoset në MPMS; kjo e fundit ka mundësi të ofrojë një qasje më komplekse, të orientuar kah viktimat" (në vend të qasjes së fokusuar kah aspekti kriminal) për të ndihmuar personat që kanë përjetuar dhunën në familje. Fakti që ky është emërim politik e jo pozitë në shërbimin civil po ashtu e dëmton kapacitetin afatgjatë dhe përgjegjësitë për koordinim. Vullneti i pamjaftueshëm politik, buxheti dhe kapacitetet mbesin sfida për zbatimin e kornizës ligjore. Perceptimet publike, traditat dhe e drejta zakonore e bëjnë të vështirë për gratë që të largohen nga situatave e dhunës në shtëpi ose të ri-integrohen pas një strehimi afatshkurtër (deri në gjashtë muaj me mundësi vazhdimi). Shërbimet e rehabilitimit dhe ri-integrimit mbeten të financuara dobët dhe praktikisht nuk ekzistojnë fare.[26] Strehimi dhe shërbimet për meshkujt që kanë përjetuar dhunën në bazë gjinore janë të pamjaftueshme, edhe pse Qendra e re e përkohshme e sigurisë e ka një seksion për meshkujt të cilët trafikohen.

Strehimoret dhe disa organizata të tjera ofrojnë këshillime për meshkujt që janë shkaktues të dhunës. Megjithatë, asnjë organizatë apo institucion nuk është e specializuar për këto shërbime. MPMS e ka miratuar një udhëzim administrativ për trajtimin e personave që shkaktojnë dhunë në familje, por për momentin nuk ka shërbime të mjaftueshme për ketë.[27] Numri i kufizuar i shërbimeve këshilluese që janë në dispozicion për meshkujt (përfshirë edhe për përdoruesit e drogës dhe alkoolit) nënkuptojnë që gjyqtarët e gjykatave civile në urdhrat për mbrojtje rrallë kërkojnë masa të tilla rehabilituese ose parandaluese. Gjyqtarët theksojnë se shërbimet e tilla nuk ekzistojnë prandaj edhe nuk mund të sanksionohen.[28]

Janë dokumentuar disa probleme lidhur me qasjen në drejtësi, përfshirë vonesat në lëshimin e urdhrave për mbrojtje, dënimet e buta për përsëritësit e veprës dhe për shkelësit e urdhrave për mbrojtje, aplikimi i kufizuar i masës së paraparë në rregulloren (tani ligjin) për dhunën në familje, arsyetimin e dobët të aktgjykimeve me të cilët lëshohet urdhri për mbrojtje, vëmendjen e vogël për të siguruar ekzekutimin e urdhrit për mbrojtje, ndjekjen jo të mjaftueshme penale të veprës 'lëndimi i lehtë trupor', përfundimin e parakohshëm të paligjshëm të ndjekjes penale *ex officio* (automatike) në rastet penale, dhe dënimet e ulëta për autorët e veprës penale të dhunës në familje.[29] Gratë po ashtu kanë frikë të dëshmojnë.[30] Është raportuar se në disa komuna është përmirësuar zbatimi i urdhrave për mbrojtje nga policia.[31] Praktikat përfshijnë emërimin e gjyqtarëve të specializuar në rastet e dhunës në familje për tu fokusuar vetëm në këto raste; dhe sigurimi që QPS-të të kenë resurse të mjaftueshme për t'iu përgjigjur me shpejtësi kërkesave të opinionit.[32] Është raportuar se reformat e sistemit gjyqësor kanë pasur efekt pozitiv në disa komuna.

Koordinimi në radhët e institucioneve për të ndihmuar personat që kanë përjetuar dhunën në familje duket se është përmirësuar me krijimin e pozitës së Koordinatorit Nacional në vitin 2013, hartimin e PSO-ve në vitin 2012, dhe themelimin e grupeve koordinuese lokale. PSO-të duket se kanë

ndikuar pozitivisht në cilësinë e reagimit të policisë, prokurorët dhe gjykatat, si dhe në koordinimin ndërmjet institucioneve në nivelin komunal.[33] Praktikat më të mira përfshijnë edhe atë që Kryetarët e Gjykatave të përzgjedhin gjyqtarët e specializuar dhe me përvojë për tu marrë më rastet e dhunës në familje dhe trajnimin e gjerë të njësive të specializuara të policisë. Koordinatori Kombëtar është duke zhvilluar një bazë të të dhënave për tu ndarë me të gjitha institucionet. Intervistat tregojnë se edhe vetëdija e institucioneve dhe qytetarëve është rritur me kalimin e kohës, edhe pse nevojitet një studim i ri i perceptimeve në tërë Kosovën.

Trafikimi i qenieve njerëzore për shfrytëzim seksual

Trafikimi për shfrytëzim seksual ka pasur rënie që nga viti 2002. Policia e Kosovës ka identifikuar 52 raste në vitin 2013, në të cilat ishin të përfshirë kryesisht kosovaret e trafikuara brenda vendit. Prej tyre, shumica (24) ishin të mitura të moshës 14-17 dhe të reja 18-22 (13). Policia ka arrestuar 91 persona të dyshuar për trafikim, 35 për mundësimin e prostitucionit dhe 26 për prostitucion.

Korniza ligjore është mjaft gjithëpërfshirëse. Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit (2013) është mjaft i ri, kështu që zbatimi i tij nuk është monitoruar akoma. Pasi që strategjia ekzistuese është afër skadimit, kanë filluar aktivitetet për hartimin e Strategjisë së re për 2014-2018.[34] Një pengesë kyçe në zbatimin e strategjisë së tanishme ka qenë alokimi i buxhetit të pamjaftueshëm për planin e saj të veprimit. Parandalimi,[35] ndjekja penale,[36] dhe mbrojtja[37] kanë marrë mbështetje përmes buxheteve ekzistuese të institucioneve dhe/ose përkrahjes së donatorëve. Megjithatë, rehabilitimi dhe ri-integrimi janë financuar shumë pak.[38] Një Grup Punues Ndërministror përfshinë të gjitha institucionet e rëndësishme, OSHC-të dhe policinë.[39] Sekretariati i këtij grupi është i vendosur në MPB dhe përbëhet nga një punonjës dhe një Koordinator Nacional. Ekzistojnë shqetësime lidhur me vendosjen e Koordinatorit Nacional në MPB, i cili mund të promovojë qasjen e fokusuar në aspektin penal e jo qasjen e "fokusuar në viktimën". Meshkujt ende bëjnë disa intervista me gratë që kanë qenë të trafikuara, edhe pse hetueset (F) janë në pozitë më të mirë që t'i bëjnë këto intervista. Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave për Kosovën u bën thirrje institucioneve që të miratojnë dhe zbatojnë legjislacionin për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të trafikimit të qenieve njerëzore; "përmirësimin e parandalimit, zbulimit dhe hetimit të krimeve të rënda ndërkufitare, kryesisht trafikimit të qenieve njerëzore"; dhe ndërtimin e kapaciteteve të autoriteteve përkatëse për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e trafikimit.[40]

Ngacmimi seksual

Ligji për Barazinë Gjinore, Kodi Penal, Ligji i Punës dhe Ligji për Shërbimin Civil përmbajnë dispozita kundër ngacmimit seksual. Disa punëdhënës privatë dhe publikë kanë politika kundër ngacmimit seksual, përfshirë edhe procedura të raportimit.[41] Megjithatë, janë raportuar shumë pak raste.[42] Një studim i QKSGJ-së në vitin 2010 ka konstatuar se 16.6% e shërbyesve civilë të anketuar kishin përjetuar ngacmim seksual të paktën një herë.[43]Marrëdhëniet e pushtetit ndërmjet abuzuesve dhe të abuzuarve, bashkë me "tabutë" kulturore që rrethojnë një temë ua pamundësojnë njerëzve raportimin e rastit.[44] Ngacmimi seksual në Universitetin e Prishtinës duket mjaft i përhapur, por shumë pak i raportuar, dhe i injoruar edhe kur raportohet.[45]

Siguria

Në qasjen e sigurisë së njeriut, ekzistojnë disa fusha të shqetësimit në lidhje me sigurinë ekonomike, të ushqimit, shëndetësore, mjedisore, personale, të komunitetit dhe politike.[46] Infrastruktura e pamjaftueshme, siç është ndriçimi joadekuat i hapësirave publike gjatë natës, mund të krijojë ambient të përshtatshëm për dhunë në bazë gjinore. Grupet lokale të veprimit dhe Këshillat për Sigurinë në Komunitet kanë iniciuar disa projekte për adresimin e këtyre çështjeve. Përpjekjet e fundit kërkojnë të përfshijnë një perspektivë gjinore në planifikimin hapësinor, përfshirë ndriçimin dhe rrugët në kuadër të zhvillimit komunal dhe planeve rregullative. Kjo përfshinë, për shembull, distancën deri në shkollë ose në punë.

Gratë në Kosovën veriore mund të përballen me shqetësime të tjera shtesë të sigurisë për shkak të sundimit veçanërisht të dobët të ligjit, mospajtimeve për kompetencat institucionale (Kosova *apo* Serbia) dhe gjendjes së përgjithshme të pasigurisë atje. Ndonëse RKSKB 1325 bën

> "Gratë mund të jenë kampione në ndërtimin e paqes. Përpjekjet duhet të përfshijnë OJQ-të e grave dhe aktivistet e të drejtave të njeriut nga politika dhe shoqëria civile."
> - Pjesëmarrës në grupin e fokusuar

thirrje për përfshirje të grave, gratë nuk kanë marrë pjesë sa duhet në vendimmarrjen lidhur me veriun e Kosovës.[47]

Dhuna për shkak të orientimit seksual
Kushtetuta dhe Ligji kundër Diskriminimit shprehimisht ndalojnë diskriminimin në bazë të orientimin seksual.[48] Ekzistojnë politikat që dënojnë ngacmimin ose diskriminimin në bazë të orientimit seksual në disa institucione, por mekanizmat e raportimit mbesin të dobët.[49] Brenda marrëdhënieve në familje, personat LGBT raportojnë dhunë në bazë gjinore, e veçanërisht dhunë psikologjike dhe izolim, por edhe dhunë fizike dhe seksuale.[50] Jashtë shtëpisë, personat LGBT kanë përjetuar ngacmim verbal dhe dhunë fizike, posaçërisht përmes mediave sociale dhe nga fundamentalistët fetarë.[51] Perceptimet e përhapura publike negative e ilustrojnë nevojën për ngritjen e mëtejshme të vetëdijes.[52] Reagimi institucional ndaj krimeve të kryera kundër personave LGBT ka qenë e dobët.

Dhuna kundër personave me aftësi të kufizuara
Personat me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike mund të jenë në rrezik më të madh nga dhuna në familje, e në veçanti nga izolimi.[53] Po ashtu është raportuar për abuzim seksual në Institutin e Shëndetit Mendor në Shtime.[54]

Dhuna kundër fëmijëve brenda institucioneve[55]
Dhuna në bazë gjinore në shkolla,[56] duke përfshirë prekjen e vendeve intime të vajzave.[57] Aktivistët shprehën shqetësimin për raportet e fundit në media për të miturit e përfshirë në dhunën në shkolla: "vajzat janë portretizuar si kriminele, e djemtë si viktima."[58] Disa nxënës po ashtu kanë humbur jetën gjatë ecjes deri në shkollë, pjesërisht për shkak të mungesës së trotuareve.[59] Dhunë kundër të miturve është raportuar edhe në qendrën korrektuese.[60]

Parandalimi
Dëshmitë tregojnë se disa prej formave të lartcekura të dhunës në bazë gjinore mbesin gjerësisht, ndonëse jo plotësisht, të pranueshme si norma sociale. Në anketën e bërë me 2008 në mbarë Kosovën me 1,256 njerëz, 40% e të anketuarve konsideruan se "Dhuna është pjesë normale e çdo marrëdhënieje dhe shoqëria në përgjithësi e pranon se dhuna ndodh nganjëherë."[61] Mbajtja dhe përdorimi i armëve të vogla duket se ka të bëj me perceptimet e burrërisë tek meshkujt.[62] Dhuna në bazë gjinore shpesh i atribuohet "sjelljes individuale të disa meshkujve (p.sh, psikopatologjia ose mungesa e kontrollit) ose pabarazive shoqërore (p.sh, patriarkati dhe marrëdhëniet e pabarabarta gjinore)"; megjithatë, ekzistojnë argumente për një të kuptuar më shumëdimensional i cili i merr parasysh raportet reciproke të disa "faktorëve personal, të situatës, dhe socio-kulturor."[63] Nevojitet një qasje ndërdisiplinare që fokusohet në individët, shoqërinë dhe institucionet. Përpjekjet e parandalimit kanë përfshirë zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve; punën me udhëheqësit fetarë për të dhënë mesazhe kundër dhunës në bazë gjinore;[64] ofrimin e edukimit në shkolla për dhunën në bazë gjinore; organizimin e fushatave për ngritjen e vetëdijes në nivel lokal dhe kombëtar që kanë në fokus audienca të ndryshme;[65] dhe punën me meshkujt.[66] QPS-të luajnë rol në parandalim, veçanërisht si pjesë e mandatit të tyre për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe drejt "pajtimit" sipas Ligjit për Familjen.

Mbrojtja, rehabilitimi dhe ri-integrimi
Kosova ka nëntë strehimore për gratë dhe fëmijët që kanë përjetuar dhunën në bazë gjinore. Grupi i pakicës serbe dhe pakicave të tjera etnike nuk kanë shërbime të strehimit në komunat e tyre. Megjithatë, ka pasur disa përpjekje tash së fundi për krijimin e strehimoreve në Mitrovicën Veriore dhe Fushë Kosovë; komuna e Graçanicës e ka ndarë tokën dhe MPMS i ka premtuar fondet për ndërtimin e strehimores aty.[67] Të gjitha strehimoret mund dhe kanë strehuar personat e të gjitha përkatësive etnike. Nuk ekziston asnjë strehimore për djemtë mbi moshën 12 vjeçare ose për burrat që kanë përjetuar dhunën në bazë gjinore. Strehimoret marrin ndihmë nga qeveria.[68] Megjithatë, ajo është e pamjaftueshme që të mbulohen të gjitha shpenzimet, dhe donatorët ndërkombëtarë e japin pjesën tjetër të përkrahjes. Licencimi i strehimoreve dhe individëve për ofrimin e shërbimeve ka filluar në vitin 2013.[69] Tani OSHC-të mund të aplikojnë për licencim dhe financim nga MPMS, duke respektuar procedurat e prokurimit. Madje, financimi dhe kapacitetet e pamjaftueshme e kufizojnë cilësinë e shërbimeve të tyre, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me rehabilitimin dhe ri-integrimin.[70] Kjo pjesërisht

është rezultat i refuzimit të vet strehimoreve për t'ia lejuar qeverisë të mbikëqyr punën e tyre; ata kanë preferuar lirinë dhe mbështetjen financiare më të madhe periodike që vjen nga donatorët ndërkombëtarë.

Qasja në drejtësi mbetet e ngadalshme, pjesërisht për shkak të problemeve të përgjithshme në sistemin e drejtësisë. Mungesa e funksionimit të sistemit për mbrojtjen e dëshmitarëve, veçanërisht duke pasur parasysh kufizimet gjeografike të Kosovës, po ashtu mund të parandalojë viktimat ose dëshmitarët nga raportimi dhe/ose dhënia e dëshmive për rastet që kanë të bëjnë me dhunën në bazë gjinore. Duke marrë parasysh gjendjen e vështirë ekonomike të shumicës së kosovarëve, është me rëndësi që të vazhdohet dhënia e ndihmës juridike pa pagesë, pasi që shumë pak prej tyre mund të përballojnë ndihmën juridike. Personat që jetojnë në veri të Kosovës kanë më pak qasje në mbrojtje nga policia dhe gjykatat. Shërbimet e rehabilitimit dhe ri-integrimit janë të financuara shumë dobët.[71] Mungesa e pronësisë dhe e mundësive për punësim për gratë i bënë ato që të kthehen në situata të dhunshme në shtëpi dhe/ose strehimore.[72] Nuk dihet për ndonjë studim që ka analizuar suksesin e programeve të mëhershme të ri-integrimit.

Sfidat dhe mundësitë

Kosova ka një kornizë ligjore mjaft gjithëpërfshirëse lidhur me dhunën në bazë gjinore, dhe koordinimi ndërmjet institucioneve është përmirësuar viteve të fundit. Megjithatë, mbesin sfida në zbatim. Nevojiten shërbimet për shkaktuesit e dhunës, veçanërisht meshkujt. Programi edukativ mund të inkorporojë mesazhet që shpalosin normat e përgjithshme tradicionale dhe që avancojnë barazinë gjinore. Mund të inkurajohet raportimi i ndjeshëm gjinor i mediave. Institucionet kanë përgjegjësi ligjore të ndajnë resurse të mjaftueshme për shërbimet e rehabilitimit dhe ri-integrimit, drejt një qasjeje të përgjithshme të "bazuar në viktimën" e jo qasje të përqendruar në veprën penale. Gjykatat janë përgjegjëse që të mbajnë statistika të përmirësuara për një monitorim më të mirë të ndonjë diskriminimi në bazë gjinore në qasjen në drejtësi për krimet që kanë të bëjnë me dhunën në bazë gjinore. Policia, spitalet dhe lokalet e tjera të kontaktit të parë kanë nevojë për trajnim shtesë për të njohur shenjat e dhunës seksuale dhe për të kuptuar "mungesës së pëlqimit".[73] Vizitat e rregullta të QPS-ve mund të çojnë në identifikimin e hershëm dhe në parandalimin e dhunës. Instalimi i më shumë psikologëve dhe psikiatërve në kuadër të QPS-ve dhe shkollave do të mund të mundësonte shërbimet këshillimore, përfshirë edhe ato për burrat/djemtë që kanë përjetuar ose që kanë shkaktuar dhunën në baza gjinore, me qëllim të parandalimit.[74] Duhet bërë më shumë hulumtime për shkaktuesit e dhunës dhe për praktikat më të mira të rehabilitimit në Kosovë.

7) Sektorët

Ky seksion identifikon problemet specifike gjinore më të spikatura për sektorin të cilat paraqesin kufizime për zhvillimin (e sektorit). Ai përfshinë mundësitë për adresimin e pabarazive gjinore në një sektor të caktuar. Sektorët e analizuar përfshijnë sektorin e ujit, higjienës, bujqësisë, mjedisit, zhvillimit rural, sigurisë së ushqimit, të ushqyerit, transportit, infrastrukturës, TIK dhe energjisë.

Statistikat e sektorit *(% të gjithë meshkujve/femrave që punojnë)*	E të gjithë M	E të gjitha F
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	4%	5% [1]
Arsimi	10%	21%
Shëndeti i njeriut dhe puna sociale	5%	17%
Tregtia me shumicë dhe pakicë	13%	14%
Prodhimtaria	16%	8%
Ndërtimtaria	12%	0.4%

Në të gjithë sektorët, shumica e akterëve e kanë konceptin e gabuar se gjinia nuk është e rëndësishme. Atyre u mungon analiza e barazisë gjinore dhe statistikat e ndara sipas gjinive. Mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinive në të cilat bazohen shumica e modeleve ekonomike ka kontribuar në lënien anash të kontributit të grave në ekonominë e përgjithshme.

Ekonomia e barazisë gjinore

Përparësia makroekonomike që ka kontributi i grave si edhe i burrave në prodhimin dhe zhvillimin makroekonomik është fakt i dokumentuar mirë. Bruto prodhimi vendor dhe zhvillimi ekonomik do të rriten me gratë në tregun e punës.[2] Gratë në funksione drejtuese, specialiste dhe administrative u japin kompanive dhe institucioneve përparësi konkurruese dhe shumë studime theksojnë përfitimet e prodhimit më të madh, efikasitetit më të mirë dhe kthimit më të lartë të ekuitetit. Shërbimet po ashtu

mund tu përshtaten nevojave të klientëve të ndryshëm (grave, burrave, djemve dhe vajzave) kur është fjala, mes tjerash, për furnizuesit, qytetarët dhe shkollat. Kjo nuk bazohet thjeshtë në perspektivën e të drejtave, por edhe në perspektivën ekonomike. Një shpërndarje e barabartë e grave dhe burrave në kuadër të fuqisë punëtore i kontribuon shkallës më të lartë të kthimit në kapitalin e përgjithshëm, fitimit më të lartë neto, produktivitetit më të lartë dhe efektit sinergjik në kompani.[3] Devijimi nga personeli përfaqësues dhe i balancuar gjinor lidhet me ndikimin gjithnjë e më të madh negativ. Balanca e grave dhe burrave jep rezultatet më të mira.[4]

Mjedisi dhe zhvillimi rural

Turizmi rural paraqet potencial zhvillimor dhe mjedisi do të jetë një faktor me rëndësi për integrimin në BE. Romët, ashkalitë dhe egjiptianët kanë jetuar në kushtet më të këqija mjedisore në Kosovë, ku helmimi nga plumbi mund të ketë pasur ndikim të veçantë negativ tek gratë shtatzëna.[5] Personat që jetojnë afër termocentraleve me linjit në komunën e Obiliqit kanë raportuar numër më të madh të rasteve të kancerit dhe sëmundjeve të kanaleve të frymëmarrjes.[6] Gratë dhe fëmijët që rrinë në shtëpi afër këtyre termocentraleve gjatë ditës mund të jenë në rrezik më të madh nga sëmundjet që lidhen me to se sa burrat që punojnë jashtë kësaj zone.

Bujqësia

Bujqësia është ndër sektorët kryesorë ekonomik në Kosovë dhe Kosova nuk prodhon mjaftueshëm për të plotësuar nevojat e veta.[7] Gratë kanë pasur vështirësi që të hyjnë në shoqatat e bujqve, të cilat përbëhen kryesisht nga burrat.[8] Duke pasur parasysh ndarjen tradicionale të punës sipas gjinive në këtë sektor, gratë përballen me sfida më të shumta për të plasuar produktet e tyre në treg. Atyre shpesh u mungojnë ndërmjetësuesit, edhe pse shoqatat e grave kanë krijuar pika grumbullimi në përpjekje për të tejkaluar këto sfida.[9] Kur është fjala për prodhimin bujqësor, shumica e grave kultivojnë perimet, specat, dhe e bëjnë përpunimin e ushqimit. Rrjetëzimi ndërmjet grave që merren me bujqësi është i domosdoshëm (dhe ndodh, veçanërisht në fshatrat përreth Gjakovës dhe Prizrenit), si mekanizëm i mbrojtjes dhe mësimit. Historikisht, gratë nuk kanë përfituar në mënyrë të barabartë nga programet e zhvillimit të bujqësisë.[10] Megjithatë, në vitin 2013 MBPZHR ka dhënë subvencione në vlerë prej rreth 79,000 eurosh dhe grante për investime në vlerë prej 2.5 milionë eurosh për 88 projekte të grave në bujqësi.[11] Në vitin 2012, 94 gra që merren me bujqësi kanë marrë 40,000 euro subvencione dhe 65 projekte të grave që merren me bujqësi kanë marrë 377,000 euro grante për investime. Në vitin 2011, nëntë gra që merren me bujqësi morën subvencione dhe grante investuese në vlerë prej 50,000 eurosh. Vlerësohet se 201,321 gra merren me bujqësi, duke luajtur kështu një rol të rëndësishëm në zhvillimin e fermave komerciale, gjysmë komerciale dhe familjare.[12]

Uji dhe higjiena

> "Gjendja në Kosovë është e tillë që ne nuk kemi ujë, por rrugë."
>
> "Kur vjen uji, gratë i mbushin enët me uji derisa burrat pushojnë."
>
> - Përfaqësuesit e OSHC-ve

Një prej kompanive të ujit në Kosovë, e cila u shërben tetë komunave, punëson 840 persona, 18% e tyre femra. Burrat punojnë me gypa (të cilës i referohen si "punë më e vështirë"). Dhe gratë punojnë në laboratorë dhe administratë. Ata kanë 5-6 inxhiniere (F). Nuk kanë një politikë për punësimin e grave. Faturat e ujit zakonisht janë në emër të kryefamiljarëve meshkuj, edhe pse kompania beson se gratë, veçanërisht të moshuarat, i paguajnë më shpesh faturat. Gratë duket se dinë më shumë për sëmundjet që transmetohen përmes ujit, e njohin aromën e tij dhe e kontrollojnë cilësinë e ujit; ato po ashtu bëjnë më shumë ankesa se sa meshkujt. Megjithatë, është vështirë të vlerësohet se kush i bën ankesat pasi që gratë nganjëherë e shkruajnë emrin e burrave kryefamiljarë në ankesa dhe në anketën vjetore Raporti i Kënaqshmërisë së Konsumatorit. Shërbimet e higjienës janë joadekuate ose jo-ekzistuese, veçanërisht për ujërat e zeza në zonat rurale.[13] Kanalizimi i hapur mund të ndikojë më shumë te gratë dhe fëmijët në zonat rurale, veçanërisht kur udhëtojnë nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas. Ka probleme me qasje në ujë në tërë vendin, të cilat mund të ndikojnë më shumë te gratë pasi ato zakonisht janë përgjegjëse për të marrë ujë dhe kalojnë më shumë kohë në shtëpi. Planifikohen investime të reja.[14]

Siguria e ushqimit dhe të ushqyerit

Gratë në zonat rurale e bëjnë përpunimin e ushqimit në shtëpi, çka siguron një dietë të larmishme,

minimizon humbjet dhe ofron produkte që mund të shiten. Gratë zakonisht shpenzojnë të ardhurat e tyre në ushqim dhe për nevoja të fëmijëve; hulumtimi ka treguar se gjasat e fëmijës për të mbijetuar rriten deri në 20% kur nëna e kontrollon buxhetin e familjes.[15] Prandaj, gratë luajnë rol vendimtar në sigurinë e ushqimit, në larminë dietale dhe në shëndetin e fëmijës. Qasja e grave në arsim është po ashtu faktor përcaktues për nivelet e të ushqyerit dhe shëndetit të fëmijës.[16] Kosova e përmbush nivelin e jodit; gratë shtatzëna dhe fëmijët kanë qasje në jod përmes shkollave dhe spitaleve. Megjithatë, Kosova ka një konsum të ulët të hekurit në dietë, gjë që shkakton anemi tek fëmijët (15.7%) dhe gratë shtatzëna 23%.[17]

Transporti dhe infrastruktura

Ndërtimi i rrugëve është planifikuar për autostradat R7 dhe R6, të cilat do të krijojnë më shumë vende pune për burrat se sa për gratë, përveç nëse kontestohen rolet stereotipike të gjinive. Ministria për Mjedisin dhe ABGJ-ja janë duke krijuar një doracak për barazi gjinore në planifikimin hapësinor.[18] Shërbimet e transportit fillimisht mund të duken se janë në të mirë të të gjithëve në mënyrë të barabartë, por burrat dhe gratë nga grupet e ndryshme sociale mund të kenë nevoja dhe prioritete të ndryshme sa i përket asaj se si planifikohen dhe zbatohen këto shërbime. Këto dallime nganjëherë nuk vërehen në fillim. Kur të identifikohen nevojat dhe prioritetet e ndryshme, ato mund të integrohen në mënyrë sistematike në planifikimin dhe menaxhimin e shërbimeve të transportit.[19] Personat me aftësi të kufizuara përballen me sfida shtesë pasi që transporti publik rrallë i merr parasysh nevojat e tyre, dhe qasja e tyre është e mundshme vetëm në një numër të vogël objektesh publike. Mungesa e rampave dhe ashensorëve në ndërtesat shumëkatëshe po ashtu e pengon qasjen për personat e moshuar që lëvizin me vështirësi dhe për nënat me karrocë fëmijësh. Projektet e infrastrukturës po ashtu duhet të marrin parasysh nevojat për sigurinë e grave, përfshirë edhe qasjen në sistemet e ujit, rrugët e ndriçuara mirë dhe transportin e sigurt.[20]

Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit (TIK)

TIK është konsideruar me rëndësi për rritjen e përfshirjes së të gjithë personave, njerëzve me aftësi të kufizuara, dhe grupeve të pakicave etnike.[21] Krahasimi me bizneset që nuk kanë të bëjnë me TIK tregojnë se sektori i TIK-së ofron potencial për absorbimin e investimeve të jashtme, për eksport, për zhvillim të produkteve të reja, për inovacion që krijon produkte dhe shërbime me vlerë më të lartë, për balancë më të mirë gjinor, për përfshirjen e të rinjve, veçanërisht në nivelet drejtuese, për më shumë praktikë, dhe për përfshirje sistematike në avokimin për ndryshimin e politikave.[22] Struktura gjinore në sektorin e TIK-së është 80% meshkuj dhe 20% femra, që është i njëjti përpjesëtim sikur në sektorin jo-TIK-së.[23] Në nivele drejtuese, kompanitë e TIK-së kanë një strukturë pak më të balancuar gjinore: 20% gra në kompanitë e TIK-së krahasuar me 8% në kompanitë që nuk kanë të bëjnë me TIK-në.[24]

Energjia

Kosova vazhdon të ketë reduktime të energjisë elektrike, edhe pse gjendja është përmirësuar. Korporata Energjetike e Kosovës nuk mban të dhëna të ndara sipas gjinive për konsumatorët e vet, kush bën pagesat ose kush ankohet. Vëzhgimi i konsumatorëve sugjeron se meshkujt zakonisht i paguajnë faturat e energjisë më shumë se sa gratë, veçanërisht në zonat rurale.[25] Kjo mund t'i atribuohet faktit se pronat janë të regjistruara kryesisht në emra të burrave dhe se faturat janë dukshëm më të larta se sa ato të ujit (të cilat i paguajnë gratë). Vëzhgimet sugjerojnë se në Prishtinë zakonisht janë gratë e reja ato që i paguajnë faturat e tyre përmes internetit ose përmes transferimit automatik, edhe pse për këtë nevojitet një hulumtim i mëtejshëm.

Stubbs, Paul and Danijel Nestić. Institute of Economics, Zagreb, Croatia. *Child Poverty in Kosovo: Policy Options Paper & Synthesis Report.* UNICEF, 2010. At: http://www.unicef.org/kosovoprogramme/Child_Poverty_ENG(2).pdf.
Gjeçovi, Shtjefën, with an introduction by Leonard Fox, *Kanuni i Leke Dukagjinit* [The Code of Leke Dukagjini]. New York: Gjonlekaj Publishing Company, 1989.
Trnavci, Genc. "The Interaction of Customary Law with the Modern Rule of Law in Albania and Kosova" in Sellers, Mortimer and Tomaszewski, Tadeusz, *Rule of Law in Comparative Perspective*. Springer, 2010.
United Nations General Assembly. *Basic Principles and Guidelines on the Right to a Remedy and Reparation for Victims of Gross Violations of International Human Rights Law and Serious Violations of International Humanitarian Law*. A/RES/ 60/147. 2006.
United Nations Security Council Resolution 1325. S/RES/1325. 2000. At: http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N00/720/18/PDF/N0072018.pdf?OpenElement.
UNDP. *Raporti i zhvillimit njerëzor në Kosovë 2012: Sektori privat dhe punësimi.* Prishtinë: UNDP, 2012.
_____. *Raport për pulsin publik VI.* Prishtinë: UNDP, gusht 2013. Në: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Procurement/PPR6_Anglisht.pdf.
_____. *UNDP 2012 Progresi sipas qëllimit.*
UNICEF. *Puna e fëmijëve në Kosovë: Studim për fëmijët që punojnë.* Prishtinë: UNICEF, 2004. Në: http://www.unicef.org/kosovoprogramme/kosovo_media_pub_prot.008.04.pdf.
_____. *Drejtësi për fëmijët: Krimet e të miturve dhe praktika e drejtësisë për të miturit në Kosovë.* UNICEF, 2008. Në: http://www.unicef.org/kosovoprogramme/Justice_for_children_Anglisht.pdf.
_____. *Hulumtim për dhunën kundër fëmijëve në shkollat e Kosovës.* Prishtinë: UNICEF, 2005. Në: http://www.unicef.org/kosovoprogramme/kosovo_media_prot_011.08.pdf. UNFPA. *Kosove (RKSKB 1244): Martesa e fëmijëve*. Prishtinë: UNFPA, 2012. Në: http://unfpa.org/webdav/site/eeca/shared/documents/publications/KOSOVO%20-%20English.pdf.
_____. *Dhuna në bazë gjinore në Kosovë. Studim i rastit.* Prishtinë: UNFPA, 2005. Në: https://www.unfpa.org/women/docs/gbv_kosovo.pdf.
UNIDO dhe Gratë e OKB-së. *Energji e qëndrueshme për të gjithë: Dimensionet gjinore*. 2013.
UNFPA, *Kosova (RKSKB 1244): Martesa e fëmijës,* Prishtinë: UNFPA, 2012.
USAID. *Kosovë: Strategjia e Bashkëpunimit për Zhvillimin e Vendit 2014-2018*. Prishtinë: USAID, 2013. Në:

http://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/CDCS_Kosovo.pdf.
_____. *Raporti për Kosovën 2012.*
United States Department of State, Bureau of Democracy, Human Rights and Labor. *2009 Human Rights Report: Kosovo*, 2010. At: http://www.state.gov/documents/organization/160196.pdf.
_____. *Country Reports on Human Rights Practices for 2011*. At: http://www.state.gov/documents/organization/186578.pdf.
_____U.S. Department of State, *2012 Investment Climate Statement on Kosovo*, 2012, at http://www.state.gov/e/eb/rls/othr/ics/2012/191177.htm.
Grupi i Grave Deputete. *Strategjia e Veprimit të Grupit të Grave Deputet (GGD)*. Prishtinë: GGD, 2012[?].
Banka Botërore. *Gjinia në një vështrim*. 2013.
_____. *Dallimet gjinore në arsim, shëndetësi dhe mundësi ekonomike*. 2012.
_____ President i Grupit Jim Yong Kim. Komunikatë për shtyp. 20 shkurt 2014.
_____. *Vlerësimi i varfërisë në Kosovë*. Prishtinë: Banka Botërore, 2005.
_____. *Anketa e Fuqisë Punëtore*. Prishtinë: Banka Botërore, 2012.
_____ Njësia për Menaxhimin Ekonomik dhe Uljen e Varfërisë në Rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore dhe Sektori i Standardit Jetësor i Departamentit për Statistika Sociale të Agjencisë së Statistikave të Kosovës. *Varfëria në konsum në republikën e Kosovës në vitin 2011.* Prishtinë: Banka Botërore dhe ASK, 2013.
OBSH, UNICEF, dhe UNFPA, *Përdorimi i substancave psikoaktive në Kosovë: Vlerësim dhe reagim i shpejtë me të rinjtë, përdoruesit e drogave të injektuara dhe të burgosurit,* Prishtinë: OBSH, UNICEF dhe UNFPA, 2009. Në: http://www.unicef.org/kosovoprogramme/RAR_psychoactive_substance_use_eng_09(1).pdf.
Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR) dhe Qendra për Zhvillimin të Grupeve Shoqërore. *Liria dhe Mbrojtja për Lesbiket, Homoseksualët, Biseksualët dhe Transgjinorët në Kosovë.* Prishtinë: YIHR, 2013. Në: http://ks.yihr.org/public/fck_files/ksfile/LGBT%20report/Freedom%20and%20Protection%20for%20LGBT%20in%20Kosovo.pdf.

Shënime në fund

[1] Neni 7.2, thekson se "Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore."
[2] Kushtetuta e Kosovës, Neni 22.
[3] Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin Nr. KI 41/12 parashtruesve Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
[4] Është duke ju nënshtruar korrigjimeve, të cilat përfshijnë një nen të ri të propozuar lidhur me buxhetin që u përgjigjet gjinive.
[5] Shih Mbrojtësit e të Drejtave Civile, *Të Drejtat e Njeriut në Kosovë*, 2012.
[6] Shih, Komisioni Evropian, *Raporti i Progresit për Kosovën 2013*.
[7] Shih, për shembull, faqen e internetit të Ministrisë së Administratës Publike (MAP) për rregulloret dhe udhëzimet administrative kryesore për zbatimin e ligjeve për shërbyesit civilë, për të emëruarit polikë, etj. Shih Rregulloren e MAP-së 06/2011 për pushimin e shërbyesve civilë, 2011; dhe UA 02/2013 të Ministrisë së Shëndetësisë për Procedurat e Trajtimit të Autorëve të Dhunës në Familje për Zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje.
[8] Grupet e fokusuara me OSHC-të, donatorët dhe organizatat ndërkombëtare, shkurt 2014.
[9] Grupi i fokusuar me donatorët dhe organizatat ndërkombëtare, shkurt 2014.
[10] Po aty dhe intervistat, shkurt 2014.
[11] Miratuar me Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 7/17, më 24 prill 2008.
[12] Miratuar me Vendim të Qeverisë së Kosovës me 25 gusht 2011.
[13] Shih faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme për Strategjinë në: http://www.mpb-ks.org/repository/docs/TQNJAnglisht.pdf.
[14] Shih Zyra e Koordinatorëve Nacionalë kundër Dhunës në Familje, "Raport për aktivitetet kundër dhunës në familje: Raporti vjetor i progresit," Maj 2013.
[15] Intervistë me Zëvendësministrin dhe Koordinatorin Nacional kundër Dhunës në Familje, shkurt 2014.
[16] Miratuar me vendimin Nr. 09/168, 29 janar 2014. Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të

Bashkuara, 2000.
[17] Shih: Igballe Rogova dhe Nicole Farnsworth për Rrjetin i Grupit të Grave të Kosovës (RRGGK), "Kosova", në Zyrën Ndërlidhëse Evropian për Ndërtimin e Paqes (ZNEP), *RKSKB 1325 në Evropë: 20 raste studimore të zbatimit*, ZNEP, 2013, f. 39-41; Odanović, Gorana dhe Sonja Stojanović Gajić (ed.), *Gratë, Paqja dhe Siguria në Ballkanin Perëndimor*, Beograd: Qendra për Politika të Sigurisë në Beograd, 2013; Fjolla Raifi për Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), *Raporti i vlerësimit: Zbatimi i PKV/PV-së 1325 në Ballkanin Perëndimor: Kosova*, Prishtinë: QKSS, 2013; Nicole Farnsworth (ed.) për RRGGK, *Fakte dhe Fabula për Rezolutën 1325: Përmbledhje e rrëfimeve për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në Kosovës*, Prishtinë: RRGGK, 2011; RRGGK, *Monitorimi i Zbatimit të Rezolutës 1325 së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Botim i dytë*, Prishtinë: RRGGK, 2009; dhe RRGGK, *Monitorimi i Zbatimit të Rezolutës 1325 së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë*, Prishtinë: RRGGK, 2007.
[18] Shih për shembull, KIPRED, *Fuqizimi i Qytetarisë së Gruas në Kontekstin e Shtetndërtimit: Sektori i Sigurisë në Kosovë dhe Decentralizimi*, 2010.
[19] Plani i Veprimit për Partneritet Evropian.
[20] Po aty, f. 52-53.
[21] Rrjeti ka analizuar Strategjinë për Integrimin e Komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptiane në Republikën e Kosovës, 2009-2015, Strategjinë e Kosovës për Rininë (2013-2017), Strategjinë dhe Planin Kombëtar të Veprimit për të Drejtat e Njeriut, 2009-2013, dhe Strategjinë Kombëtare për Integrim Evropian "Kosova 2020" 2014-2020 përmes thjerrëzave gjinore (Gratë e OKB-së, komentet për draftin *Profili Gjinor i Kosovës*, 2014).
[22] Për shembull, Misioni për Sundimin e Ligjit EULEX ka pasur një ose dy takime vjetore me OJQ-të e grave pa ndonjë hap pasues konkret për rekomandimet e paraqitura gjatë diskutimeve.
[23] Shih Nicole Farnsworth dhe Elmaze Gashi për RRGGK dhe Alter Habitus, *Ku janë paratë për të drejtat e grave: Studimi i rastit të Kosovës*, Prishtinë: RRGGK, 2013.
[24] Po aty.
[25] KE, *Studimi i Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asocimit në mes të Kosovës dhe BE-së*, 2012, p. 7.
[26] Grupi i fokusuar, shkurt 2014. Shih po ashtu Qendrën Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), *Auditimi Gjinor i Projekteve të Bashkimit Evropian në Kosovë*, Prishtinë: QKSGJ, 2010.
[27] Shih USAID, *Kosova 2014-2018: Strategjia e Bashkëpunimit për Zhvillimin e Vendit*, 2013.
[28] Ulf Färnsveden dhe Nicole Farnsworth për Orgut Consulting for Sida. *Studimi Gjinor në Kosovë: Shqyrtimi i zbatimit të Ligjit dhe Programit për Barazi Gjinore në Kosovë*. Prishtinë: Sida, dhjetor 2012.

Akterët kyç
[1] Ligji Nr. 2004/2 për Barazinë Gjinore në Kosovë.
[2] Presidentja e Republikës së Kosovës në nëntor 2012 organizoi samitin ndërkombëtar për fuqizimin e grave në Prishtinë, i cili rezultoi me "Parimet e Prishtinës". Këto parime rikujtuan të gjitha konventat ndërkombëtare, e konfirmonin gjendjen e gruas dhe identifikonin mundësitë për përfshirjen e tyre. Rekomandimet theksonin se duhet të merren masa në të gjithë sektorët; rëndësinë e fuqizimit ekonomik të grave; sigurinë e grave dhe qasjen në drejtësi; dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë.
[3] Në shkurt 2014, ABGJ kishte një staf prej 17 personave. Ajo kishte kërkuar më shumë staf në vitet e mëhershme, por ato kërkesa nuk ishin pranuar.
[4] Në vitin 2014, ABGJ mori 185,770 euro në formë të granteve qeveritare (nuk është raportuar ndonjë e ardhur tjetër), përfshirë 92,770 euro për paga dhe mëditje, 60,000 për programe, 3,000 euro për shërbime komunale, dhe 30,000 euro për subvencione dhe transfere. Ajo është ndër institucionet më së paku të financuara. Si krahasim, Zyra për Komunitete me staf prej vetëm shtatë vetash ka marrë 1,284,287 euro me 1,200,000 euro në subvencione dhe transfere (*Buxheti i Kosovës 2014*, p. 2).
[5] Si në nivel të ministrive ashtu edhe në nivel të komunave ekzistojnë Njësi për të Drejtat e Njeriut me zyrtarët përgjegjës për avancimin e të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e grave. Në disa raste zyrtarët kanë shërbyer edhe si Zyrtarë për të Drejtat e Njeriut.
[6] Momentalisht nuk ka propozime për reformë drejt aktivizimit të institucioneve jo-gjyqësore për të drejtat e njeriut në Kosovë. Drafti i ri i LBGJ-së mund të adresojë këto çështje (Komenti i Zyrës së BE-së për draftin e *Profilit Gjinor të Kosovës*).
[7] Grupi i fokusuar me ZBGJ-të, shkurt 2014.
[8] Qasja ka qenë që zyrtarët gjinorë të vendosen shpesh pa kushte të referencës në seksionet e burimeve njerëzore (grupi i fokusuar me ZBGJ-të, shkurt 2014). Kjo është mbështetur nga projekti FRIDOM i DFID-së.
[9] Shih Shqyrtimi funksional i të drejtave të njeriut dhe sistemi i barazisë gjinore, 2010, Raporti i FRIDOM.
[10] Ristrukturimi i kohëve të fundit në shumicën e ZBGJ-ve duke u vendosur në departamentet e burimeve

njerëzore në kuadër të ministrive, ka dëmtuar mundësinë e tyre për të kontribuar në vendimmarrje. Po ashtu edhe shumica e ZKBGJ-ve vendosur në zyrat e të drejtave të njeriut.

[11] Makineria gjinore është kritikuar se ka qenë pa ndikim dhe jo e përgjegjshme pasi që rrallë kishte monitoruar ligjet dhe politikat nga perspektiva gjinore (Cathy Cozzarelli për USAID, *Vlerësimi Gjinor në Vend për USAID/Kosovë, Versioni për audiencat e jashtme*, Prishtinë: USAID, 2012).

[12] Përmbledhje bazuar në raportin e RRGGK-së *Fakte dhe Fabula për Rezolutën 1325*, f. 66-67 dhe konfirmuar gjatë intervistave, shkurt 2014.

[13] Intervistë me Kryetarin e Gjilanit, shkurt 2014.

[14] Komunikim me email me ZKBGJ-të dhe intervistat, shkurt 2014. Në përgjithësi, ZKBGJ-të kishin ndikim minimal (Shih USAID, *Vlerësimi gjinor i vendit për USAID/Kosovë*).

[15] Intervistë, shkurt 2014.

[16] ABGJ e ka mandatin që të zbatojë dhe monitorojë LBGJ-në, të hartojë politika për barazi gjinore dhe të propozojë ndryshime të ligjeve nga perspektiva gjinore (LBGJ, Seksioni 5). Mandati i ZKQM-së rrjedh nga një Rregullore e vjetër e UNMIK-ut (2001/19) për Degët Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë. Ajo po ashtu duhet të hartojë politikat nga perspektiva gjinore, të mbikëqyrë ministritë në punën e tyre, përfshirë edhe barazinë gjinore, dhe të shqyrtojë draftet e legjislacionit nga perspektiva gjinore (Shtojca C).

[17] BE ka ndarë 700,000 euro përmes EIDHR që të mbështes ketë dhe përpjekjet e tjera.

[18] Lobi Rajonal i Grave, i cili i bashkon gratë e politikës dhe shoqërisë civile nga i tërë rajoni, ka organizuar takime ndërmjet grave nga Serbia dhe Kosova (korrespondenca përmes emailit me zëvendëskryeministren Edita Tahiri, e cila e udhëheq Lobin, mars, 2014). Për më shumë informata, shih www.rwlsee.org.

[19] Shih RRGGK, *Fakte dhe Fabula për Rezolutën 1325* dhe http://www.womensnetwork.org/?FaqeID=1&n=144.

[20] Shih Nicole Farnsworth, Ariana Qosaj-Mustafa, Milva Ekonomi, Ada Shima dhe Dua Dauti-Kadriu për RRGGK, *Me çfarë çmimi? Alokimet buxhetore për Zbatimin e Kornizës Ligjore kundër Dhunës në Familje në Kosovë*, Prishtinë: RRGGK, 2012.

[21] Transparenca e buxhetit dhe shqyrtimi demokratik në përgjithësi mbetet problem (intervistat, shkurt 2014).

[22] Disa donatorë e kanë ofruar ketë trajnim (shih listën më poshtë).

[23] *Grupi i Grave Deputete, Strategjia e Veprimit të Grupit të Grave Deputete (GGD)*, Prishtinë: GGD, 2012[?]. Periudha kohore dhe financimi i parashikuar për zbatimin e strategjisë janë të paqarta. Grupi ka avokuar me sukses për përdorimin e një gjuhe më të ndjeshme gjinore në parlament, mes nismave të tjera.

[24] Intervistat, shkurt 2014.

[25] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Zhdukur dhe Peticione, *Raporti Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore nr. 2004/2 në Republikën e Kosovës*, Prishtinë: korrik 2013. Kjo është bërë bazuar në rekomandimin e Komisionit Evropian të bërë në Raportin e Progresit për Kosovën 2011. Kohëve të fundit ky u bë njëri ndër komisionet e para që e bën mbikëqyrjen financiare të qeverisë, përfshirë edhe ministritë dhe agjencitë (Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Raport për Monitorimin e Punës së Kuvendit të Kosovës*, Prishtinë: OSBE, korrik 2013, p. 7).

[26] Megjithatë, MPMS sapo ka filluar një iniciativë në bashkëpunim me GIZ dhe RRGGK për buxhetimin që i përgjigjet gjinive, e cila ka për qëllim të fus një perspektive më të mirë gjinore në buxhetin, qëllimin dhe aktivitete e saj.

[27] Ato mbajnë një bazë të të dhënave për punëkërkuesit aktivë dhe ndihmojnë në identifikimin e mundësive për punësim. Ato punojnë në tandem, duke ofruar mundësi për rikualifikim. Nevojitet analizë e mëtejshme gjinore e punës së tyre.

[28] Ligji për Familjen dhe Shërbimet Sociale, Neni 4.

[29] QKSGJ publikoi *Auditimi Gjinor i Projekteve të Bashkimit Evropian në Kosovë* më 2010. Megjithatë, Ministria e Integrimit Evropian dhe BE si donator mund të sigurojnë përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha vlerësimet e nevojave, planifikimet, buxhetimet dhe vlerësimet e ndikimit. Në mars të vitit 2014, BE filloi të ofrojë trajnime për ministritë për përfshirjen e një perspektive më të mirë gjinore në propozimet e tyre për IPA.

[30] Kjo përfshinë një pako prej pesë ligjesh: Ligjin për Kontrollimin e Duhanit i cili kontribuon në mënyrë të veçantë në shëndetin e grave shtatzëna në hapësirat publike; Ligjin për Shëndetësinë, Ligjin për Produkte dhe Pajisje Mjekësore; Ligjin për Sigurimin Shëndetësor; dhe Programin kombëtar për kancerin e qafës së mitrës, gjirit dhe zorrës së trashë i cili përfshinë programet e skenimit (kanceri i prostatës nuk është përfshirë pasi që për momentin nuk shihet si kërcënim serioz). Sipas Ministrit, ZBGJ-ja ka qenë e përfshirë në përgatitjen e dokumenteve strategjike, përfshirë edhe Strategjinë e Sektorit të Shëndetësisë për 2014-2020 (që duhet të publikohet në mars 2014). MSH ka bashkë-financuar një iniciativë të Grupit të Grave Deputete për blerjen e një

njësie mobile të mamografisë, duke ndarë 36,000 mijë euro nga 270,000 sa janë nevojitur. Ajo do të fillojë duke ofruar shërbime në Mitrovicë ku gratë kanë qasje të kufizuar në kujdes shëndetësor. MSH po ashtu do të marrë investime në vlerë prej 25.6 milionë dollarësh nga Banka Botërore për një periudhë prej pesë vitesh, 8 milionë franga zvicerane nga qeveria e Zvicrës dhe 6 milionë euro nga Luksemburgu. Ajo po ashtu është duke punuar në partneritet me UNFPA, UNICEF, dhe OBSH-në në një iniciativë për planifikimin e familjes e mbështetur nga Qeveria e Luksemburgut. MSH beson së Fondi për Sigurimin Shëndetësor do të të sjellë 80 milionë euro në sistemin e kujdesit shëndetësor deri më 2015, ndërsa në vitin 2014 buxheti i shtetit ishte 114 milionë euro.

Kategori të veçanta të personave (p.sh., të moshuarit, personat që marrin ndihma sociale) kanë qasje në kujdes shëndetësor pa pagesë, derisa të tjerët paguajnë sipas çmimores. MSH e ka listën se cilat shërbime janë në dispozicion në cilin lokacion të Kosovës. Sa i përket ankesave, ata nuk kanë mbajtur të dhëna të ndara sipas gjinive dhe disa meshkuj duket se raportojnë në emër të grave të tyre. Ndonëse, disa shërbime janë pa pagesë, njerëzit kanë raportuar se spitalet jo gjithmonë ofrojnë shërbime ose ilaçe. Të gjitha shërbimet e emergjencës janë pa pagesë. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik është përgjegjës për mbajtjen e statistikave lidhur me trajtimet e ofruara, por informatat nuk ndahen sipas sëmundjeve ose gjinisë (intervistë dhe korrespondencë, prill 2014).

[31] She-Era, *Analizë e Buxheti Gjinor dhe Ndikimi i Politikave Fiskale në Nivelin e Varfërisë së Grave në Bujqësi: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural*, Prishtinë: She-Era, 2007. Ministria tani ka ndarë fonde shtesë për gratë në bujqësi (shih seksionin 7).

[32] Po aty.

[33] Kjo është e vetmja strehimore shtetërore. Shih po ashtu seksionin për dhunën në bazë gjinore.

[34] Prej 121 prokurorëve, 43 janë gra. Për më shumë informata, shih Shtojcën 1. Statistikat, Akterët kyç, Prokuroria.

[35] Konkluzioni i ekipit hulumtues, bazuar në intervista (Shkurt 2014).

[36] Ky më herët ka qenë Divizioni për Avokim dhe Ndihmë Viktimave. Përderisa ka pasur shqetësime lidhur me ligjshmërinë e transferimit të kësaj kompetence pa një bazë më të qartë ligjore, prokurorët theksojnë se është në mandatin e tyre që të ndihmojnë viktimat e të gjitha krimeve. Ata u japin prioritet rasteve të vrasjeve dhe trafikimit. Bazuar në një Udhëzim Administrativ të 2013 të Kryeprokurorit ata i kanë unifikuar dhe standardizuar procedurat standarde, përfshirë edhe Procedurat Standarde të Operacionit. Kjo ka rezultuar në paga më të mira, të ofruara përmes Këshillit Prokurorial. Ata kanë marrë pjesë në disa trajnime. Si shërbyes publikë, ata kanë të njëjtën politikë kundër ngacmimit. Për tri vite nuk është raportuar asnjë rast.

[37] Prokurorët dhe gjykatat tani mund të dërgojnë disa raste për ndërmjetësim. Shih Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim (2008). Ekipi hulumtues nuk ka pasur kohë të mjaftueshme për të kërkuar të dhëna lidhur me atë se kush i ka shfrytëzuar shërbimet e ndërmjetësimit deri më sot, për çfarë qëllimi dhe si mund të jetë përfshirja e gjinive.

[38] Oda e Avokatëve të Kosovës synon të avancojë sundimin e ligjit, qasjen në drejtësi dhe të mbështesë reformat ligjore.

[39] FSK ka 183 femra (8.1%), një rritje prej 2% krahasuar me para pesë vitesh, dhe 0% sa ka pasur në armatën jugosllave (intervistë me ministrin Çeku të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës).

[40] Pozita është e përbashkët me atë të zyrtarit për të drejtat e njeriut. Detyrat përfshijnë sigurimin që të gjitha politikat të jenë në harmoni me ligjet ndërkombëtare dhe vendore; promovimin e barazisë gjinore brenda policisë; dhe studimin e praktikave të mira në vendet e tjera të cilat mund të përdoreshin në polici. Policia ka politikë kundër ngacmimit seksual, por janë raportuar shumë pak raste. Ato po ashtu kanë Procedura standarde të operacionit për t'iu përgjigjur raportimeve të krimeve kundër personave LGBT. Trajnimi themelor i policisë i trajton çështjet që kanë të bëjnë me LGBT. Megjithatë, sa i respekton dhe zbaton policia ligjet varet nga policët individualë (intervistë me policinë, shkurt 2014).

[41] RRGGK, *Fakte dhe Fabula për Rezolutën 1325, f.* 71.

[42] Megjithatë, policia nuk i ndan statistikat e krimeve sipas moshës ose marrëdhënies ndërmjet viktimës dhe autorit të krimit, edhe pse njësia për dhunën në familje e gjurmon ketë informatë për marrëdhënien në familje.

[43] Policia po ashtu mban dy herë në vit trajnime dyditore për policët, të cilin së fundmi kanë kërkuar ta zgjasin në katër herë në vit (Gratë e OKB-së, koment për draftin e *Profilit Gjinor të Kosovës*, 2014). Gratë e OKB-së kanë mbështetur zhvillimin e këtyre moduleve dhe trajnimin e trajnuesve prej 2006 deri më 2011.

[44] Është zvogëluar numri pasi që gratë në vitin 2011 përbënin 14.7% ndërsa 20.6% në vitin 1999 (Policia e Kosovës, shkurt 2014). Për më shumë informata lidhur me lokacionin e tyre gjeografik dhe pozitën në kuadër të forcës policore, ju lutem shikoni Shtojcën 1. Statistikat, akterët kyç, policia. Sipas Strategjisë tashmë të vjetruar për Integrimin e Komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptiane në Republikën e Kosovës (2009-2015), vetëm një femër rome dhe një egjiptiane punojnë në forcën policore.

[45] Për më shumë informata, shih Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë. *Raporti për pozitën e gruas në Policinë e Kosovës.* Shih po ashtu, RRGGK, *Fakte dhe*

Fabula për Rezolutën 1325, f. 71.
[46] Kjo ka frymëzuar gratë që punojnë në qendrat korrektuese që edhe ato të formojnë shoqatë.
[47] Disa stacione tani kanë dhomë private për intervistimin e grave dhe fëmijëve.
[48] Intervistë me policinë, shkurt 2014.
[49] Përkrahja lidhur me statistikat e ndara sipas gjinisë kryesisht ka ardhur nga Ambasada e Suedisë.
[50] Intervistë. Për statistika të ndara sipas gjinisë dhe për trajnime, ju lutem shih Shtojcën 1. Statistikat, Akterët kyç, Banka Qendrore e Kosovës.
[51] Grupi i fokusuar, shkurt 2014. Mungesa e stafit pjesërisht është rezultat i ndryshimeve të kohëve të fundit në Rektorat. Universiteti ka hapur së fundi pesë qendra rajonale me numër të kufizuar drejtimesh në Pejë (turizëm dhe menaxhim të hoteleve), Prizren, Gjilan (menaxhim të informatave dhe informatikë), Ferizaj, Gjakovë, dhe Mitrovicë.
[52] Kjo përfshinë studimet gjinore në sociologji, studimet gjinore në antropologji, sociologjinë e feminizmit në sociologji, gjininë në sociologji, gjininë në pedagogji dhe arsim, dhe gratë në letërsinë angleze. Ata shpresojnë të krijojnë nivelin e magjistraturës në sociologji, të quajtur 'gjinia, arsimi dhe pushteti në shoqëri'; si dhe një program studimi gjinor. Lëndët e tjera përmbajnë informata për barazinë gjinore, zakonisht në bazë të vullnetit të profesorit, përfshirë edhe studimet urbane; pushtetin dhe familjen; të drejtat e njeriut dhe shumë-kulturalizmi në departamentin ligjor; statistikat shëndetësore; demografinë; gjuhën frënge dhe punën sociale. Departamenti ekonomik nuk duket se ka ndonjë lëndë që përfshinë perspektivën gjinore.
[53] E themeluar në vitin 2013, qendra do të finalizojë strategjinë e saj në vitin 2014 në konsultim me palët e ndryshme të interesit. Ajo po ashtu është duke e bërë një identifikim gjinor të Universitetit të Prishtinës 2014, i cili do të përfshijë vlerësimin e programeve mësimore nga perspektiva gjinore.
[54] Statistikat e universitetit për vitin shkollor 2013-2014, mars 2014. Përderisa disa profesorë përfaqësimin e dobët të grave në universitet ia atribuojnë pamundësisë së grave që të plotësojnë standardet e kërkuara për tu kualifikuar si profesoresha, të tjerët argumentojnë se pabarazia sistematike sociale (përfshirë qasjen e pabarabartë të vajzave dhe djemve në arsim; dhe tendenca e profesorëve të mentorojnë studentët më shumë se sa studentet) i ka kontribuar pabarazisë aktuale. Një faktor tjetër ndoshta është se gratë e arsimuara në vitet 1970-ta dhe 1980-ta zakonisht kanë shkuar në sektorët e shëndetësisë dhe drejtësisë, e jo në shkencat shoqërore, duke kontribuar kështu në mungesën e profesoreshave në shkencat shoqërore. Disa profesoresha të sotme në shkencat shoqërore theksuan se ato kishin arritur në ato pozita përmes studimeve jashtë Kosovës e jo përmes sistemit universitar këtu. Përkundër përpjekjeve të profesorëve të ri, është e qartë se ka pasur hezitim të profesoreshave sezonale për avokimin për barazinë gjinore brenda universitetit. "Ata nuk deshën asnjë favor," tha një profesor. "Gjeneratat më të vjetra janë të prira të mendojnë: 'Ka qenë vështirë për mua, duhet të jetë edhe për ty'" (Grupi i fokusuar, shkurt 2014). Prapëseprapë ka pasur një marrëveshje se duhet të merren hapa për adresimin e diskriminimit në bazë gjinore brenda universitetit.
[55] Një grup joformal i profesorëve i ka paraqitur komentet për statutin e universitetit dhe për kodin e etikës, për t'i bërë ato më të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore dhe në harmoni me ligjet e Kosovës, por këto komente të tyre nuk janë përfshirë. Po ashtu qasja e personave me nevoja speciale në Universiteti në masë të madhe është e pamundur dhe është raportuar për diskriminim kundër personave me aftësi të kufizuara nga disa profesorë. Ekziston një kuotë për pjesëmarrjen e studentëve romë, ashkali dhe egjiptianë, të cilët pranohen në mënyrë automatike në universitet, por zakonisht janë djem. Nuk ka kuota për vajzat, dhe vetëm të mbijetuarit e luftës (një profesor me ironi thotë se kjo kategori duhet të përfshijë pjesën dërrmuese të popullsisë së Kosovës, por nuk i përfshinë) dhe personat me notë të lartë mesatare, marrin bursa. Barazia gjinore nuk duket se është prioritet i Shoqatës së Studentëve, edhe pse ata janë marrë me çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e personave LGBT. Në universitet nuk ka shërbime këshillimore psikologjike, edhe pse disa profesorë nga departamenti i psikologjisë ofrojnë shërbime të tilla përmes një qendre jashtë universitetit.
[56] Ngacmimi seksual ligjërisht është vepër penale, por duket se nuk është ndjekur penalisht. "Problemi ka qenë se nuk ka pasur dëshmi të mjaftueshme," tha një profesor. "Thjeshtë, ishte fjala e saj kundër fjalës së tij" (grupi i fokusuar, shkurt 2014).
[57] Grupi i fokusuar në universitet, shkurt 2014.
[58] Kjo ishte rezultat i *Parimeve të Prishtinës*, që u paraqitën në një konferencë të organizuar nga Presidentja e Kosovës më 2012.
[59] Për shembull, shih RRGGK dhe Alter Habitus, *Ku janë paratë për të drejtat e grave*, Prishtinë: RRGGK, 2013.
[60] Për shembull, Instituti i Kosovës për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED) zhvilloi një hulumtim për gratë dhe zhvillimin dhe është përfshirë në avokimin për kuotën e përfaqësimit të grave dhe burrave në vendimmarrje (mes tjerash edhe në fushatën Reforma 2004). *Ec më ndryshe* bashkëpunon me Handikosin, si dhe me organizatat e grave në Prizren, për të siguruar qasje më të mirë në hapësira publike në planifikimin hapësinor,

veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara. Caritas Kosova ka bashkëpunuar me strehimoret dhe akterët ndërkombëtarë në përpjekjet kundër trafikimit. Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave në Kosovë (ECMI) është duke punuar në adresimin e dhunës në baza gjinore brenda komuniteteve pakicë. Katër organizata LGBT veprojnë në Kosovë dhe Iniciativa Rinore për të Drejtat e Njeriut (YIHR) ka bërë një hulumtim për të drejtat e personave LGBT.

[61] Një shqyrtim i shpejtë i publikimeve të forumeve, përfshirë edhe ato të Iniciativës Kosovare për Stabilitet (IKS), Institutit Riinvest, Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe Institutit GAP, tregon se ato rrallë e përfshijnë perspektivën gjinore në raportet e tyre.

[62] Sipas alfabetit: Artpolis, Care International, Dora Dorës, Laboratori i Inovacionit, QKSGJ, QKRMT, RRGGK, Medica Kosova, Dera e Hapur, *Partia e Fortë*, Rrjeti i edukatorëve moshatarë, Ruka Ruci, Gratë e OKB-së, UNDP, UNICEF, UNFPA, dhe strehimoret.

[63] Ai ka 10 komisione që merren me çështjet që përfshijnë shërbimet publike, shëndetin dhe mirëqenien sociale dhe integrimin evropian. Shih faqen e internetit të Asociacionit të Komunave të Kosovës http://komunat-ks.net/kolegjiumet/?lang=en.

[64] Grupet Avokuese për Barazi Gjinore (GABGJ) ekzistojnë në komunat e Prizrenit, Gjilanit, Fushë Kosovës, Gjakovës, Novobërdës, Mamushës, Dragashit, Podujevës, Mitrovicës Jugore dhe Gllogocit. Në përgjithësi, GABGJ-të deri më sot kanë përfshirë rreth 250 gra të ndryshme dhe gjashtë burra, përfshirë persona nga politika, shoqëria civile, grupet etnike të pakicave (goranë, turq, serb, boshnjakë, romë dhe ashkali), personat me nevoja të veçanta, nga zonat rural/urbane, dhe rininë.

[65] Grupi i fokusuar me Grupin e Grave Deputete, shkurt 2014.

[66] Grupi i fokusuar me Grupin e Grave Deputete, shkurt 2014.

[67] Intervistë me një përfaqësues partie, shkurt 2014. Për statistika lidhur me shkallën në të cilën partia i përfshinë gratë dhe burrat, ju lutem shikoni tabelën në Seksionin 4.

[68] Ambienti i përgjithshëm i sigurisë në Kosovë, duke qenë i fokusuar në negociata, stabilitet politik, dhe në veriun e Kosovës, nënkupton se çështjet e tjera mbulohen shumë pak (intervistë, shkurt 2014). Nuk kuptohet sa duhet se gjinitë mund të përfshihen në diskutimet për këto çështje. Në transmetuesin publik Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) 221 punonjës nga 653 sa ka gjithsejtë janë femra (34%). Tetë nga 13 redaktorët e lajmeve janë femra. Këtu përfshihen redaktoret serbe, boshnjake, turke. Dhjetë nga 14 gazetarë janë femra, përfshirë katër që momentalisht janë në pushim të lehonisë (intervistë, shkurt 2014).

[69] Aktivistet për të drejtat e grave shprehin shqetësimin për rritjen e fundamentalizmit islamik, i cili ka kontribuar që gratë të jenë më të izoluara në shtëpi dhe ka mundësi të ketë ndikuar në qasjen e vajzave të reja në arsim. Ato po ashtu kanë shprehur shqetësimin për ngacmimin publik dhe dhunën që është ushtruar kundër aktivisteve të zëshme për të drejtat e grave nga ekstremistët islamik në vitin 2013 (intervistë, shkurt 2014). Shih po ashtu: RRGGK, "RRGGK dënon sulmin kundër aktivistes për të drejtat e njeriut Nazlie Bala", 28 mars 2013.

[70] Duke marrë parasysh se ka mund të jetë shkruar dhe është shkruar një raport i tërë për punën e tyre, ky paragraf përmbledh në një fjali punën e tyre *aktuale*. Nismat e mëhershme nuk janë paraqitur këtu. Për më shumë informata, shih edhe Alter Habitus, *Ku janë paratë për të drejtat e grave*.

[71] Intervistë, shkurt 2014. Shih po ashtu QKSGJ, *Auditimi Gjinor i Projekteve të Bashkimit Evropian në Kosovë.*

[72] Ata "drejtojnë dhe mbikëqyrin mekanizmat në Mision për monitorimin, zbatimin dhe vlerësimin e instrumenteve të rëndësishme ndërkombëtare," përfshirë RKSKB 1325 (EULEX, komentet për draftin e *Profilit Gjinor të Kosovës*, 2014).

[73] RRGGK, *Fakte dhe Fabula për Rezolutën 1325*, f. 33. KFOR nuk jep informata lidhur me numrin e grave dhe burrave (korrespondencë përmes emailit, mars 2014).

[74] Një zyrtar dhe një komision për përfshirjen gjinore i shqyrton të gjitha propozimet nga perspektiva gjinore. UNKT po ashtu ka pasur programe specifike të fokusuara në barazinë gjinore, përfshirë Iniciativën e UNDP-së për Sigurinë e Grave, programi i UNKT-së për Dhunën në Bazë Gjinore (2012-mars 2015) përfshinë UNDP, Gratë e OKB-së, UNFPA dhe UNICEF në përmirësimin e reagimit të tri komunave të përfshira kundër dhunës në bazë gjinore (Gjilanit, Gjakovës dhe Dragashit). Këtu, Gratë e OKB-së kanë ndihmuar në zhvillimin e grupeve koordinuese komunale për adresimin e dhunës në bazë gjinore, i kanë trajnuar ato për ketë qëllim dhe do të trajnojnë edhe deputetet e ndoshta edhe komunat për dhunën në bazë gjinore.

[75] Sipas OSBE-së, "Ndonëse të gjitha projektet e OSBE-së përmbajnë një komponent të fuqishëm të përfshirjes gjinore, aktivitetet e fokusuara të Misionit të OSBE-së në Kosovë në promovimin e barazisë gjinore përfshijnë një varg projektesh për kultivimin e pjesëmarrjes së femrave në vendimmarrjen publike, programet për mbështetjen e luftës kundër dhunës në familje, aktivitetet për luftimin e braktisjes së hershme të shkollës nga vajzat, mbështetjen për komunat në tërë Kosovën në zbatimin efektiv të proceseve buxhetore që u përgjigjen gjinive, ose projektet për promovimin specifik të të drejtave pronësore të grave në Kosovë, sa për t'i përmendur disa prej tyre" (koment për draftin *Profili Gjinor i Kosovës*, 2014).

[76] Shih RRGGK, *Fakte dhe Fabula për Rezolutën 1325*, f. 34-36.
[77] Banka Botërore, komente për draftin *Profili Gjinor i Kosovës,* 2014. Ata më tej theksuan, "Banka Botërore e ka udhëhequr punën analitike në çështjen gjinore përmes një diagnostifikimi gjinor, vlerësimi të tregut të punës me thjerrëza gjinore dhe një studimi cilësor mbi pengesat në punësim. Më tej, me mbështetjen financiare të SDC-së, jemi duke punuar në një program për promovimin e qasjes së grave në mundësitë ekonomike në Kosovë. Aktivitetet në kuadër të kësaj pune përfshijnë, për shembull, kërkesën dhe bërjen e vlerësimit të kujdesit për fëmijët dhe të moshuarit, për të kuptuar pengesat potenciale në punësimin e grave."
[78] Programet që synojnë të adresojnë pabarazitë gjinore do të fokusohen në të drejta pronësore dhe të trashëgimisë, arsim, të drejta të LGBT dhe në fuqizimin e grave (USAID, *Kosovë: Strategjia e Bashkëpunimit për Zhvillimin e Vendit 2014-2018*, Prishtinë, USAID, 2013). USAID mbështet Programin Hope Fellowship të Këshillit Kombëtar Shqiptaro-Amerikan i cili u ofron grave mundësi të zhvillojnë kapacitetet e tyre udhëheqëse përmes vizitave në SHBA. USAID po ashtu përkrah mbështetjen e Institutin Demokratik Kombëtar për zhvillimin e kapaciteteve të grave parlamentare, veçanërisht të Grupit të Grave Deputete. Ajo po ashtu mbështet Samitin e Grave të Presidentes.
[79] Lukas Fischer, komente për draftin *Profili Gjinor i Kosovës,* 2014. Projekti i tij i vitit 2014 për Reformën e Financave Publike, për shembull, teston dhunën në baza gjinore në nivelet lokale dhe qendrore (në bashkëpunim me RRGGK).
[80] Programi pasues (2014-2018), në fazën e vet fillestare do të vazhdojë punën për dhunën në bazë gjinore. Ata po ashtu bënë një anketë për identifikimin e nevojave të grave në arsim, shëndetësi dhe bujqësi (informacion i komunikuar në diskutimin e GIZ-së për dhunën në bazë gjinore, shkurt 2014).
[81] Për më shumë informata, shih RRGGK dhe Alter Habitus, *Ku janë paratë për të drejtat e grave.*
[82] Për më shumë informata, ju lutem shikoni Platformën për Menaxhimin e Ndihmës dhe RRGGK dhe Alter Habitus, *Ku janë paratë për të drejtat e grave.* Në vitin 2013, Care International filloi një nismë të fokusuar në maskulinitet. Organizata Daneze për Refugjatë (Danish Refugee Council) mbështet kurset e shkrim-leximit për gratë dhe të rinjtë romë, ashkali dhe egjiptianë si pjesë e programit të saj për kthim të qëndrueshëm.
[83] Instituti Riinvest. *Të paguash apo të mos paguash: Informaliteti nga Këndvështrimi i Bizneseve në Kosovë.* Instituti Riinvest, 2013, f. 23.
[84] Kjo mund të vërehet kur bëhet krahasimi i raporteve të mëhershme të monitorimit të barazisë gjinore me gjendjen e sotme, si dhe krahasimi i deklaratave të bëra nga politikanët dhe nëpunësit civilë (shih për shembull, raportet e RRGGK për zbatimin e rezolutës RKSKB 1325 përgjatë kohës).
[85] Analiza e ekipit hulumtues, bazuar në intervista (shkurt 2014).
[86] Për rekomandimet specifike, shih Ulf Färnsveden dhe Nicole Farnsworth për Orgut Consulting për Sida, *Studim Gjinor në Kosovë: Shqyrtimi i zbatimit të Ligjit dhe Programit për Barazi Gjinore në Kosovë*, Prishtinë: Sida, dhjetor 2012.
[87] Kjo, për shembull, mund të përfshijë paraqitjen në media të meshkujve duke u kujdesur për fëmijët, duke përgatitur ushqimin dhe hekurosur, dhe gratë në aktivitete ndërtimore ose në punë jashtë shtëpisë.

Sundimi i ligjit, drejtësia dhe të drejtat e njeriut
[1] Zyra e Kadastrës së Kosovës, 2014.
[2] Pjesëmarrja e grave në këto institucione është përfshirë në seksionin e akterëve kyç.
[3] Marrë nga të dhënat e policisë për 2006-2007 (UNICEF, *Drejtësi për fëmijët: Krimet e të miturve dhe praktika e drejtësisë për të miturit në Kosovë*, UNICEF, 2008).
[4] Raport i Kadastrës së Kosovë për pronësinë mbi pronat në Kosovë, komunikimi përmes emailit, mars 2014.
[5] Shih për shembull, Entin Statistikor të Kosovës, *Gratë dhe burrat në Kosovë*, 2010 dhe USAID, *Vlerësimi gjinor në vend për USAID/Kosovë*, Versioni për audienca e jashtme, 2012.
[6] ABGJ, e përkrahur financiarisht nga GIZ, është duke bërë një hulumtim sasior dhe cilësor socio-ekonomik mbi të drejtat e grave në pronë dhe trashëgimi. Hulumtimi përbëhet nga një analizë në zyrë e legjislacionit në fuqi dhe intervistimi i 2,200 personave.
[7] Shoqata e Juristëve Norma, *Hulumtimi dhe Monitorimi i Zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore në Kosovë*, Prishtinë: Norma, 2011, f. 25.
[8] Grupi i fokusuar me OJQ-të dhe intervista me Kryetarin e Gjykatës Themelore në Gjilan, shkurt 2014.
[9] Intervistë me Kryetarin e Gjykatës Themelore në Gjilan, shkurt 2014.
[10] Shih Kodin Penal të Kosovës, neni 335, neni 398: dënohet me burgim deri në tri vjet. Për zyrtarët e përfshirë, burgimi parashihet më i lartë.
[11] Norma, 2011, f. 25.
[12] Ligji Nr. 03/L-010 për Noterët në Kosovë, neni 30.
[13] Departamenti i Shtetit i SHBA-së, *Deklarata për Klimën e Investimeve në Kosovë 2012*, 2012.
[14] Fillimisht kod i pashkruar, më vonë u përpilua nga Shtjefën Gjeçovi kah fundi i shekullit XIX me rregulla që

rregullonin në mënyrë të rreptë sjelljen shoqërore të shqiptarëve në Shqipërinë Veriore dhe Kosovë. Këto rregulla ishin formë e rezistencës ndaj kombeve të shumta që qeverisnin Kosovën. Kodi përfshinte rregullat e martesës dhe ndarjes së pronës. Shih Genc Ternavci, "Ndërveprimi i të drejtës zakonore me sundimin modern të ligjit në Shqipëri dhe Kosovë" në Sellers, Mortimer dhe Tadeusz Tomaszewski, *Sundimi i Ligjit në Perspektivën Krahasuese*, Springer, 2010, fq. 201-215.

[15] Shih Kodin §88, përkatësisht Kodin §91. Shtjefën Gjeçovi, i përkthyer në gjuhën angleze me një parathënie nga Leonard Fox, *Kanuni i Leke Dukagjinit*, Nju Jork: Kompania Botuese Gjonlekaj, 1989.

[16] Ligji i Punës në Kosovë, 2010.

[17] Grupi i fokusuar me gratë afariste; dhe Riinvest, 2013, f. 23-4.

[18] Ligji i Punës në Kosovë, 2010, Neni 50.

[19] Rregullorja nr. 02/2011 në fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive.

[19] Ministria për Komunitete dhe Kthim e ka mandatin ligjor që të zhvillojë politika, të promovojë dhe zbatojë legjislacionin për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, përfshirë të drejtën për kthim, në pajtim me Kushtetutën (Shtojca Nr. 15 për mandatin e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim).

[20] Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme kjo përfshinte 4,103 meshkuj dhe 1,095 femra (cituar në raportin e Verena Knaus, *Pa një vend që të quhet shtëpi – Riatdhesimi nga Gjermania në Kosovë i parë dhe i përjetuar nga fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë*, UNICEF Kosovë dhe Komiteti Gjerman për UNICEF-in, 2011, *f.* 16).

[21] Knaus, *Pa një vend që të quhet shtëpi [No Place to Call Home], f.* 31.

[22] Verena Knaus, Peter Widmann, *Integrimi varet nga kushtet – Raport për gjendjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës në Gjermani dhe pas riatdhesimit të tyre në Kosovë*, UNICEF Kosovë dhe Komiteti Gjerman për UNICEF-in, 2010, f. 73.

[23] Intervista me grupet e fokusuara me OSHC-të, shkurt 2014. Përfaqësues të lartë qeveritarë sugjerojnë se kjo është prioritet drejt stabilitetit (korrespondencë përmes emailit, mars 2014). Gjysma e komisionit dhjetë anëtarësh janë serbë.

[24] Grupet e fokusuara me OSHC-të në Prishtinë dhe Prizren, shkurt 2014.

[25] Shih Rrjeti i Organizatave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane në Kosovë (RROGRAEK). *Raport i monitorimit për Zbatimin e Perspektivës Gjinore në kuadër të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Integrimin e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane në Republikën e Kosovës (2009-2015)*. Prishtinë: RROGRAEK, nëntor 2012. Raportit i mungojnë citimet për studimet dhe hulumtimet të cilave u referohet dhe statistikat e cekura janë të vjetra.

[26] Fokus grupi me OSHC-të, shkurt 2014.

[27] Qeveria i ka disa projekte për ndërtimin e banesave për largimin e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve nga kampet. Megjithatë, këto projekte shpesh gjenden larg nga qendrat e qytetit dhe të izoluara nga grupet e tjera etnike, nuk i kanë parashikuar strategjitë për integrim ose mundësitë për punësim që do tu mundësonin familjeve të mbijetojnë pas vendosjes aty (intervistë, shkurt 2014).

[28] Shih: Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara, Byroja për Demokraci, të Drejta të Njeriut dhe Punë, *Raportet e vendeve për praktikat e të drejtave të njeriut për vitin 2011*, f. 24-25.

[29] Grup i fokusuar me OSHC-të, shkurt 2014.

[30] Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut me Qendrën për Zhvillimin e Grupit Shoqëror, Raport i Kosovës, *Liria dhe Mbrojtja për Lesbiket, Homoseksualët, Biseksualët dhe Transgjinorët në Kosovë*, Prishtinë: YIHR, 2013.

[31] Po aty.

[32] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 24.

[33] Ligji rrjedh nga dy direktiva evropiane: Direktiva e Këshillit 2000/43/EC e qershorit 2000 për Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të personave pavarësisht racës ose prejardhjes etnike, dhe Direktiva e Këshillit 2000/78/EC e nëntorit 2000, e cila përcakton kornizën e përgjithshme për trajtimin e barabartë në punësim, parandalon diskriminimin në bazë të fesë, aftësisë së kufizuar, moshës ose orientimit seksual. Shih YIHR për analizë të mëtejshme të kornizës ligjore.

[34] Po aty.

[35] Po aty.

Situata Politike

[1] Numri është marrë nga Ministria e Punëve të Jashtme, "Misionet Diplomatike të Kosovës," në: http://www.mfa-ks.net/?page=1,49, shikuar me 9 prill 2014.

[2] Ministria e Administratës Publike, shkurt 2014.

[3] Komunikim përmes emailit me stafin hulumtues të KIPRED, shkurt 2014.

[4] Departamenti i Administratës së Shërbimit Civile (DSHAC), shkurt 2014.

[5] Intervistat, shkurt 2014.
[6] Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSS), *Si votojnë gratë në Kosovë? II*, Prishtinë: QKSS, 2013. Fatkeqësisht kjo anketë e ekonomive familjare i ka përfshirë vetëm gratë, kështu që mbetet e paqartë se çka mendojnë burrat për pjesëmarrjen e grave në politikë. Disa pyetje kanë përmbajtur edhe paragjykime gjinore, siç është fokusimi në atë se sa ka punuar Presidentja e Kosovës për gratë, pa pyetur se sa ka punuar Kryeministri për to.
[7] Njëzet ulëse janë të garantuara për grupet e pakicave, përfshirë 10 për serbët, një për romët, një për ashkalitë, një për egjiptianët, një për "komunitetin" romë, shkali, egjiptianë që merr më së shumti vota, tri për boshnjakët, dy për turqit dhe një për goranët (Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, 2008, Neni 111.1b).
[8] Shpresa Agushi, Drejtoreshë e RROGRAEK dhe Snezhana Karadzic, Drejtoreshë e Komitetit të Grave për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, intervistat, cituar në RRGGK, *Fakte dhe fabula të Rezolutës 1325*, p. 60-61.
[9] Qytetarët kanë të drejtë të shqyrtojnë dhe japin komente për legjislacionin e ri, edhe pse afati kohor për konsultime është shpesh i shkurtër dhe mekanizmat janë të paqartë (intervista, shkurt 2014).
[10] QKSGJ, *Si votojnë gratë në Kosovë? II*, f. 18 dhe 21.
[11] QKSGJ, 2013, f. 36.
[12] Intervistat, shkurt 2014.
